

SULEJMAN KRASNIQI

BIBLIOTEKA  
854-31  
295

# PRËFIMET e MAJORIT

*roman*

811-31  
K95

SULEJMAN KRASNIQI

# RRËFIMET E MAJORIT

— Roman —



SHTËPIA BOTUESE «URTIA»

Tiranë, 1993

## AVENTURA NË HOTELIN «UNION»

*Shpeshherë shorti na detyron të sulemi drejt rreziqeve që nuk na sjellin asnjë përfitim...*

**M**gjarja më e mënxyrshme e jetës sime zuri fill një ditë gushti me vapë zagushitëse dhe me rrëmet mizash.

Me dy shokët e mi të luftës ia kishim shtruar me pije e meze në verandën e pijetores «Tre qengjat e pjekur» buzë Bistricës. Shokët pinin në heshtje. Më vidhnin me vështrime dhe bisedonin me pëshpërime. Druheshin mos më kërcenin xhindët. Nuk kishin faj. Isha me disponim tepër të rëndë. Kisha pirë shumë. Në të tilla raste kthehesha në tigër të ndërkyer. Pastaj isha aq i fuqishëm, sa, po të më kërcenin dreqërit, jo ata të dy, por edhe një togë gladiatorësh nuk mund të më bënte zap. Mbrëmjen e shkuar, sa vura kokën në përkrese me mbresat e këqija të ditës, përmes dritares së hapur, dikush hodhi një qese me minj të porsalindur, të gjallë. Lexova pusullën: «Më mirë të ushqehesh me këto gjallesa, se sa të jetosh me lëmoshën e dashnoreve, grave të shokëve të tu, që u vënë brirë burrave të tyre...» Brofa. Zgjata kokën në dritare. Nuk pashë njeri. U mbështeta mbi krevat

duke iu ckërmitur shpifjes. Por pas pak, dy gurë njëri pas tjetrit m'i bënë xhamat trosh. Një pusullë tjetër e mbështjetur në njërin prej gurëve: «O luftëtar i dështuar! O mendjemadh i kuturitur! O pusht! O kurvar i hazdisur!...» Nuk futa gjumë në sy. Pa zbardhur drita, piva një kafë te baca Kolë, pastaj drejt e në pijetoren «Tre qengjat e pjekur», ku më prisnin, si çdo ditë, shokët e dertëve. Tashiti kushedi të satën kupë e kisha ngritur me fund. Pija dhe vështroja poshtë në lumë. Tufa rosash shllapaviteshin në tallazitje me guak-guaket e bezdisshme. Bënte aq shumë vapë, sa edhe ajri që thithnim sikur na i përcëllonte hojëzat. Gomerët, që kishin sjellë barrë të rënda drithi nga fshatrat malore për të bluar në mullinjtë e shumë të vërgoheshin përgjatë Bistricës, lëkundnin veshët dhe tundnin bishtin për të trembur mizat thumbprehta e zuzulluese. Herë pas here lëshonin të pallura të gjata e shurdhuese. Shpendë të shumë: trumcakë, gala, kumri, pëllumba, zbrisnin fluturimthi në oborret e mullinjve, çukitnin kokrra drithi duke mbushur hapësirën me pingërima. Pemëshitësit dhe bostanxhinjtë ishinin djersën me mëngë dhe lëvdonin me zëra të ngjirur mallrat e tyre. Rrugës, mu nën verandën e pijetores, kaluan dhjetë milicë. Ata kishin vënë përpara katër plisbardhë. Duke i shpuar me majat e bajonetave dhe duke i goditur me shkelma, hyjnë në rrugën e burgut të UDB-ës. Padashur, kisha shtrënguar aq fort gotën, sa ajo u shkërmoq. Sakaq te pragu i hyrjes së pijetores bëri ballë Marë hirmadhja, e bija e propares, ku kisha banuar ca muaj më parë dhe isha larguar kusarisht andej. Ajo ngriti dorën e druajtur dhe e turpëruar. Më doli një rënkim. Jo, ishte një lloj hungërimi që paralajmëronte vajzën të mos afrohej. U ngrit Kasapi (shoku im i luftës) me kokën që i epohej jo aq nga pesha, sa nga pija. Iu avit Marës. Ç'i tha, nuk mora vesh. Por vëreja mirë lotët që braktisën sytë e bukur të vajzës dhe i rodhën faqeve të lëmuara e të brydhëta. Vuri të dyja duart mbi gjoks sikur të kërkonte të nginjej me ajër. Njeriu nganjëherë u sillka keq e tukeq edhe me më të dashurit e vet; kërkon t'i largojë, se nuk e ndjen veten të denjë për ta. Mara iku fort e tronditur. Kasapi u kthye pranë tavolinës. Nuk më tha gjë. Por nga mavijosja e hundës rrumbullake e të tultë, e mora me mend se ishte prekur e zemëruar. Dhe, ngaqë i ishte ngritur damari i

inatit, shfryu duke pirë dy gota njerën pas tjetrës me fund. Pastaj filloi të thithte hundët me një zhurmë të padurueshme. Sa herë nxehej, i shpifej ai ves. Shoku tjetër, Këpucari, si përherë, në gjendje të tendosur, rrotulloi sytë e mëdhenj në fytyrën thatime, me kokën si fener katërkëndësh. Me fjali mungesore zuri ngojet katër kapuçbardhët që i shpuri milicia në burg:

— I patë ata katër malësorët... Luftuam. U gjakosëm... Ata paguajnë haraçin e lirisë që ua sollëm...

— Mos gri pallavra dhe mos m'i zgurdullo ata sy me dritë të ftohtë si hëna! — ia pati Kasapi duke rrufitur hundët.

— Pa punë, po. Të fyer, po. Të lënduar si askush tjetër... Populli na mba. Ai ende jeton me hijën e famës sonë luftarake... Mbjellje me korrje të dështuara. Nami i trimërive jeton aq kohë sa i pihet deri në fund lëngu dështakut... foli Këpucari me timbër zemrak dhe përnjëherë ndërpreu ligjërimin, ngaqë dy binjakët e tij të vegjël kishin vënë doçkat mbi dritaret e verandës, me hundët të shtypura mbi xham, vështronin drejt tavolinës sonë.

Gruaja e kishte braktisur Këpucararin dhe tashti me të dy bijtë jetonte te prindërit e vet. Sikur m'u këput diçka në kafaz dhe ndjeva se zjarrmia ma kaploi trupin. Këpucari u ngrit. Sa bëri të çapitej, fëmijët ikën me vrap. Babai i gjorë u ul sërisht si i këputur. Kasapi mbuloi sytë me duart leshtorë, pastaj, si i porsazgjuar nga ndonjë ëndërr e keqe, tha:

— Keni dëgjuar për ndonjë kafshë që kryen vetëvrasje! Unë nuk di genie tjetër, veç njeriut, që kryen një makabritet kundërjetësor. Ka edhe të tjera. Kafshët femra një herë në vit e ndiejnë nevojën të flenë me mashkullin. Kurse njerëzit duan çdo natë. Mos u mërzit, vëlla, — i tha ai Këpucarit, — edhe mua para teje më braktisi gruaja dhe ja, jetojmë...

— Por as e imja, as e jotja nuk kërkojnë të flejnë me ndonjë tjetër, — ia ktheu Këpucari me një zë të lëngshëm. — Ato kërkojnë të na mbledhin në shtëpi. Të mos përqyrrimi mbi gotën e rakisë për luftën e dështuar...

— Në shtëpinë e të varurit nuk përmendet litari, — tha Kasapi dhe, pasi fërkoï hundën rrumbullake e të tultë, u kthye nga unë: — Major Bumja, ma këputën shpirtin fjalët e Marë Gjinadardës. Ajo kërkon të dijë përse u

largove nga shtëpia e tyre. Kur nuk kishe ndër mend të martoheshë, përse ia ushqeve shpresat?!

— Ia hodha një vështrim të mllëfosur.

— Të paktën ta kishe përcjellë Marën me një buzëqeshje, — tha Kasapi.

— Ku ta gjej buzëqeshjen — ia ktheva si i ndërkryer, ngaqë nuk isha mësuar të më qortonin dy ish-adjutantët e mitë luftës. — Një burrë që nuk është i zoti të mbrojë unin e vet, si mund të dashurojë dhe të ushqejë të tjerët me shpersa të rreme. — Kaq thashë dhe iu ktheva vetvetes.

— Major Bumja, të mirën e të keqen përherë e kemi ndarë bashkë. Ne t'i themi të gjitha. Ti ripërtyp zemërimin në vetvete. Na thuaj, të paktën, përse u largove nga shtëpia e Gjinadardëve? — më pyeti Kasapi.

Unë nuk iu përgjigja pyetjes, por fola për ato që më torturonin:

— Përpara një muaji, kur u ktheva në banesë pas mesnate, në derë më kishin ngjitur një letër sa një çarçafë. Atje shkruhej: «I madh e i vogël nga krahina iu përgjigjëm thirrjes tënde në Luftën Nacionalçlirimtare. Na premtove shumë. Nuk na dhe asgjë. Ti, që theve burgje, nxore bijtë e Kosovës andej. Ti, që sulmove kuesturë e gestapo. Ti, që mposhte ordi armiqsh, së fundi, në vend të çlirimit na solle zezimin, ç'bën tashti?! U vetëzhgradove. Ç'fitove me këtë?! Të mbajmë si përdëllimtar. Të ushqejmë për mëshirë. Nuk të vret sadopak ndëgjegjija?! Zemra e luanit të është shndërruar në të kukumjackës, që nuk ia bën bam; të vritesh për ta ruajtur të paprekur emrin që ke pasur si mburrja jonë e dikurshme...»

— Cili do ta ketë shkruar këtë letër? — pyeti Kasapi duke thithur hundët.

— Edhe minjtë e porsalindur, që t'i kanë hedhur natën në dhomë, edhe këto provokime shkavobizantine kanë për fabrikë klanin e Spakoviçit, të «nderuarit» komisar që na e sollën me komandim nga lart në batalion. E mbajte, e nderove, tashti priti dhuratat e tij, — ma pat Këpucari, — njeriu me ç'ka, t'i kthen borxhet... Edhe Spakoviçi, tash kolonel i UDB-ës t'i ofron toptan të gjitha... — dhe si mbërtheu gotën, vijoi me zë të thekshëm: — Të pimë. Populli paguan. Kësaj i thonë lëmoshë për dështakët...

Atë çast na u afrua Babushi, pronari i pijetores, na

vuri përpara një kiloshe raki dhe tri pjata përplot me veshka zgare. I turbulluar nga fjalët e Këpucarit, shtyva me kurrriz të dorës tabakanë. Sa u mata t'i thosha Babushit t'i kthente mbrapsht ato që solli; tjetri, që na donte dhe që çdo mëngjes, kur hynim në pijetore na thoshte: «Sot lagjet e katolikëve, e Bazhdërhanës, ose e Kalasë; e Marashit, apo Ndërkatundsja, apo e Kujunxhive ka derdhur për ju kaq e aq para...» Bëri një nojmë duke treguar një tavolinë në gjysmerrësirën e pijetores dhe tha:

— Ju qerasin ata dy zotërinjtë...

U hodha një vështrim hajnisht dhe të turbullt. Fytyra të njohura. Emrat s'më kujtoheshin.

— Luaje macë kryet e buallit! — bërbëli Këpucari hermetik.

— Nuk po i njeh? — ma pat Kasapi me sy të skuqur nga pija dhe duke rruftitur hundët, — Janë Kolë Dishpali dhe Dakë Lejthia... — dhe, duket lexoi në sytë e mi zemërimin e harresës e shtoi: — Hë, bre Major, ata që i kapi brigada serbe tek na sillnin ushqimet për batalionin. Kur i kishin vënë përpara skuadrës së pushkatimit, shkuam ne dhe i shpëtuan...

Ndërhyri Këpucari:

— Janë ata dy partizanët që kryenin edhe punën e intensendencës. Kola dhe Daka, or Major. Ngaqë i kishin torturuar ata të brigadës serbe, kur po niseshim kundër autokolonës në Grykën e Ernave, të thanë: «Major Bumja, të duam sa veten, të respektojmë si askush. Serbokuqtë na e kanë me të pabesë. Ne nuk luftojmë më për një kauzë të gënjeshtërt!» Dhe u ndanë nga batalioni. Ne i quajtëm dezertorë...

Unë, ndonëse e jetoja tradhtinë e serbokuqve me tërë peshën e rëndë, nuk shkëputesha dot nga qëndrimi i prerë kundrejt dezertorëve, i cili më ishte kthyer në një lloj atavizmi qysh gjatë luftës. I vështrova me urrejtje njerëzit që na qerasnin. Këpucari, sikur të donte të ma trazonte edhe më tej inatin, foli duke rrotulluar sytë e mëdhenj në fytyrën thatime me kokën si fener katërkëndësh:

— Tashti na qerasin e na thonë: Mbyteni brengën e zhgënjimit me raki, o çlirimtarët e botës, o fakira të truaillit shqiptar!

— Pusho, ti, thumbac, që si mole bren vetveten dhe ata që ke pranë! — i thirri Kasapi me timbër kanosës.

Unë pak nga ngjarjet trullosëse të ditës, më tepër nën shtypjen e alkoolit që po vepronte me forcë në tru, pyeta si somnambul:

— Ç'i shtyn Kolën e Dakën të na qerasin?!

— Çoje viranen! — ma pati Kasapi me pamje të mjegulluar, — se rakija, nga kushdo që të jepet, mbytet molepsjen...

— Përse të na qerasin! — pyeta sërish.

— Qenkan liruar prej burgu, — tha Këpucari.

— Duan të tregojnë mirënjohje që nuk i arrestuam atëherë kur folën çaprazçe për nacionalçlirimtaren, — tha Kasapi.

— Do të kenë vuajtur burgun, — vëreja unë, — mirë që nuk i paskan zhdukur si shumë të tjerë.

— Të parruar qenkan. O nga burgu, o nga mali paskan zbritur të na i ngacmojnë dregëzat e plagëve të shumta që i morëm për hiqmosgjë... — tha Këpucari.

Ndërkaq Kolë Dishpali dhe Dakë Lejthia na bënë me dorë dhe ikën nga dalja e fshehtë. Pronar Babushi na e shkeli syrin, pastaj fshiu duart e tulta mbi përparëse, sikur të thoshte se u çlirua nga ankthi meqë u larguan komitet nga pijetorja e tij.

Ndërkohë në pijetore bëri ballë një njeri që më dhembnin sytë kur e shikoja. Vetëquhej Gjyzelmerak. Të gjithë e thërrisnin ashtu. Shiste kikirikë, leblebia, fara të pjekura, topa misri pufkë të sheqerosura. Myshterinjtë më tepër i aviteshin për të dëgjuar lajme të pangjashme, e me kurreshtje qaramane, blenin prej tij kaushe me çikërima.

Gjyzelmeraku zuri vend pranë një tavoline prapa derës së pijetores. Kërkoi një kafe prej Babushit dhe filloi të llomotiste:

— Isha në kafe-hotel «Unioni». Nuk denjuan të më jepnin kafe. Atje ishte kolonël Spakoviçi. E kishte dehur Tol Lakun. E shtrëngoi të hipte mbi një tavolinë. Pastaj të rrëfente kur ka qenë borizan i batalionit «Hakmarrja» të major Bumjes. Toli fliste duke u zgërdhirë dhe duke qarë nga të dehurit. Kolonël Spakoviçi e pyeti ish borizan Tolin:

— Dihet që major Bumja mësoi italishten dhe gjermanishten, sepse kreu shkollën ushtarake jashtë. Edhe anglishten e frengjishten i mësoi si shërbëtori gjuhën e padronëve. Por të më përgjigjesh ti, Tol borizani, ç'iu desh Bumjes që mësoi persishten, arabishten dhe turqishten?!



Borizan Toli, anipse i dehur, u përgjigj: Ta kishte mësuar edhe serbishten, major Bumja nuk do të kishte mbetur trokë. Zotëria e jote do t'ia hidhte ndonjë kockë. . . . Spakoviçi ia ktheu: Jo, këtu nuk qëllove. Bumja s'ka nevojë për kocka. E mbajnë me thela mishi gratë e ish partizanëve të tij, të cilët major Bumja i çoi drejt pusive dhe i hoqi qafe. Bumja është dashnor damaz. Zaten se i doli boja për ato punë, shkëlmoi gradat e majorit. Gjuhët orientale i ka mësuar se ëndërron të bëhet fundamentalist.... Toli ia ktheu: Këta sanhalëpirës që të dëgjojnë, mund të të besojnë edhe në se thua se Rankoviçi ka mbetur me barrë gjatë flirteve me çietnikët. Por habitem si guxon të shpifësh e ta përgojosh Bumjen, kur e di se ai të derdhë plumb në gojë ty dhe udbashëve tu. . .

Mua ma rruan, tha Spakoviçi, pastaj e mbërtheu për fyti Tolin. Të tjerët i hynë me shkelma dhe e dërguan në burg. . . .

Mua m'u drodh trupi nga ato shpifje. M'u kujtua kthesa. . . .

*Me batalionin tim gjendesha tutje Rashkës në ndjekje të çetnikëve. Erdhën dy djem të luftëtarëve të mi. Kuaft e tyre shkumëzonin. Ata lakuan baballarët e tyre, u thanë diçka me përpushje. Këta të fundit mua:*

— Komandant Bumja, fshatin na e paskan djegur, gratë dhe fëmijët po na i therin. . .

— Kush e dogji fshatin?! — pyeta unë.

— Partizanët serbë me yll në ballë, — gjegji njëri prej djemve të porsaardhur.

— Ata partizanë që na thoshit se i kemi vëllezër. — shtoi i dyti, — thonë se do ta djegin Kosovën, poqese banorët nuk marrin arratinë drejt jugut. . .

Thirra korierin e batalionit dhe e urdhërova të gjente komisar Spakoviçin, mbasi e pashë të arsyeshme të dëgjonte me veshët e vet se ç'po ndodhte në Kosovën e «çliruar». Por në vend të korierit m'u përgjigj adjutanti im. Kasapi: «Komisar Spakoviçi me të dhjetë komunistët serbë qysh mbrëmë vajtën në Prishtinë, thanë se i thërriste Këshilli Krahinor. . .».

— S'ia thatë emrin atifarë komisari? — pyeti njëri prej djemve të luftëtarëve të mi. . . .

— Spakoviç, — thashë unë.

trallisur. Këpucari e Kasapi pas meje. Zbrita në oborrin e mullirit më të afërm. Hoqa këmishën e bardhë, e mbështolla si çallmë rreth kokës. Zgjidha kërpeshin e një gomari dhe i hipa.

Të dehurit herë të sjell në qejf, herë të bën të nxjerrësh rropullitë, herë të kthen në llapaqen, herë të zymton, herë të shtyn të qashë apo të qeshësh si i marrë; herë-herë të shndërron në përbindësh. Ngandonjëherë të blaton frymëzim të përcudnuar. Këtë të fundit e jetova atë pasdite gushti me vapë mbytëse e më miza të neveritshme.

I grahja kafshës drejt qendrës së qytetit. Dy shokët e mi vinin pas me hap ushtarak, sikur të përcillnin ndonjë graduat të lartë në ndonjë ceremoni parakaluese. Ç'nuk sajoka truri i mbërthyer nga avujt e alkoolit! Fillova të këndoja. Këngë i thëncin! Nxirrja rrokje e fjalë që nuk i përkisnin asnjë gjuhe. Veçse mbaj mend, melodia ishte e përzier arabishte-indishte. Dy shokët e mi më mbanin iso me tinguj, apo fjalë që rimonin me ato që nxirrja unë prej goje:

Arrambambum — fillova unë.

Dum, dum, dum, dum, — Këpucari e Kasapi.

Kabamarri — unë.

Iriq i zi — ata.

Derrmebeter — unë.

Gjarpër me vrerë — ata.

Me të tilla arritëm deri te porta e kafe-hotelit «Union». Vura re se para ngrehinës gjendej automobil xhipsi i kolonel Spakoviçit. Dy shokët hapën portën dykanatëshe të kafenesë. Unë hyra, kaluar mbi gomar midis tavolinave përplot me udbashë dhe funksionarë partiakë. Shamata dhe gajasjet u ndërpre në. Tërë sytë lëviznin sa nga unë, pastaj te tavolina e Spakoviçit dhe përfundonin vështrimet në dritaret dhe portën e «Unionit». Dy shokët, megjithëse të dehur, qëndronin në të dy krahët e mi dhe mbanin duart në brez sikur të kishin armë. Hama dreq, as edhe biçak nuk kishim nëpër xhepa!

— Kamerier! — thirra unë dhe u habita me zërin tim aq gërvallës e kumbues, — katër deci raki!

Kolonel Spakoviçi kishte mbështetur faqen mbi tavolinë dhe me të dyja duart kishte mbuluar kokën.

Kamerieri solli tabakanë me katër deci raki. Ia bëra

me kokë t'ua ofronte së pari shoqëve të mi. Si i çuara me fund tri decit, zgjata dorën, e kapa të katërtën. U thashë Këpucarit dhe Kaşapit:

— Hapjani gojën gomarit!

Ata, njëri në të majtë, tjetri në të djathtë, sa nuk ia shqyen gojën kafshës së gjorë. Unë ia futa lëfytin e decit në gurmaz, ia derdha rakinë drejt e në stomak. Gomarit në fillim iu drodh trupi, pastaj fërgëlloi, tundi kokën me veshë të gjatë e pas pak, çaraveshi buzët dhe ia dha një të pallme të gjatë e shurdhuese. Udbashë e partiakë u shtrinë barkas nën tavolina. Sakaq u hapën dritaret me rropamë. I pari fluturoi kolonel Spakoviçi, të tjerët pas tij.

Zbrita prej gomarit, mësyva derën, me qëllim që të kapja Spakoviçin. Në qytet u dha alarmi. Nga larg pashë tek ngarendnin drejt hotelit ushtarakë me armët gati për zjarr. Kërceva në ungjësen e xhipsit. E ndeza dhe shkela gazin gjer në fund. Kur u gjenda në skajet e qytetit, u dëgjuan breshëri, armësh që kërcisnin gjithandej nëpër rrugë. Isha larg. Nuk mund të më kapnin. Por, as ku do të shkoja, nuk dija. M'u shkrep ta hidhja makinën në ndonjë kanal. Të merrja në sy Pashtrikun. Mirëpo dy shokët kishin mbetur në mëshirën e fatit. Pa ditur ç'mund të bëja për ta; i graha makinës kuturu, i dëshpëruar, i dehur dhe i çakardisur. Duke i rënë borisë pa pushim vazhdova rrugetimin në xhadenë Prizren-Gjakovë, pa ndonjë cak të synuar. Kur u gjenda mbi kodrat e Landavicës, ku merrte teposhten udhë gjithë bërryla, mu buzë një stomi, me pamje të vagëlluar vështrova përmendoren e Borës dhe të Ramizit. «Edhe gjakun e derdhur na e kthyen në plaçkë spekullimesh politike! — thashë me vete. Jo, nuk thashë, por sokëlliva. U xhindoşa edhe më keq. Nën trysninë e një stresi dridhërues, mu sipër humnerës, kërceva prej xhipsit. Makina u gremis tatëpjetës. Vrapova si i marrë lirishtes ndanë xhadesë. Më tutje më zuri syri një mullar me bar. Sa mbërrita, hapa një vrimë dhe u fsheha në zemër të mullarit .Pas pak më kapiti një gjumë i rëndë. Tërë pasditen dhe gjithë natën fjeta. Të nesërmen më zgjoi një vërritje dhije. E kisha humbur konceptin e kohës. As më shkonte nëpër mend se atje kisha kaluar 15-16 orë. Një njeri i madh ka thënë se kur dehen gratë, bëhen të neveritshme, kurse burrat, grindavecë e të bezdisshëm. Të dehurit vërtet është i shëmtuar, por më tronditës është zgjimi, kur të çahet ko-

ka nga dhimbja dhe nga përpjekja për të marrë në analizë vetveten. Gjithçka më dukej e mbrapshtë dhe e përbindshme. Ndjenjës së turpit dhe të pendimit ia zuri vendin etja, Më ngjitej goja e më përvëlonte stomaku për një pikë ujë. Shpushpurita midis barit gjysmë të tharë. Aroma e tërfojës më kujtoi vesën. Lëpiva buzët e thara me gjuhë. Më ra ndër mend se diku, atypari, gjendej një përrua. Por isha i shushatur. Nuk dija nëse ajo përmendje ishte përhitje, apo e vërtetë. Dhe kur nxora kokën nga mullari, sa nuk m'u verbuan sytë nga drita lëbyrëse e diellit. Mbylla sytë dhe u zvarirta këmba-doras. Diku nëpër bar preka një enë poçerie. Hundët m'u mbushën me erë dhalle. Të jem në ëndërr! Fërkova sytë. Pastaj përmes gishtave gjysmë të hapur vëreja një vegsh. Ia hoqa napën me të cilën ishte mbështjellë gryka. Dhallë. Vetëm mbasi e ngrita përgjysmë, u kujtova të pyesja e kujt ishte ena me dhallë. Por etja më shtyu ta çoja gjer në fund. Rrëzë një hendeku tutje më zuri syri një vajzë që tërhiqte dhinë për kapistre. Megjithëse me rrezik për kokën, brofa. Vajza ngriti krahun e hajthëm dhe e tundi nga lart poshtë. Sikur të më thoshte: futu atje ku ishe. Meqë e pa se nuk po e kuptoja; hipi majë hendekut, përmbloodhi me një vështrim tërë pllajën. Bëri siku i fliste dhisë:

— Futu nën hije, moj virane! Në drekë do të të sjellë bukë, djathë e kos!

Unë u ula. Pastaj praptazi, si akrepi, u ktheva në zemër të mullarit. Cila është ajo vogëlushe? Kush më ka parë, apo e ka marrë vesh se jam fshehur në mullarin e barit? Do ta kenë gjetur xhipsin e shkërmoqur në fund të rrëpirës? Këpuçari dhe Kasapi ku do jenë? Mos i kanë vrarë? Me këto pyetje e të tjera si këto më zuri sërish gjumi. Ëndrra! Ëndrra! Ëndrra të përçudnuara, tërë ankth e të lemerishme.

Aty nga mesdita më zgjuan trokitje ritmike të gurëve. Isha i përpirë. Jetoja në kapërcyellin midis ëndrrave të këqija dhe asaj të trokiture si të amviseve që praktikojnë ritin për mbledhjen e bletës kur roit.

— Zgjuhu! — dëgjova zërin e brishtë të vajzës së vogël, — Të kam sjellë drekën. E ke nga çika e hallës sime, Mara Gjinadarda. Ajo nuk mundi të vinte se është ngritur peshë milicia dhe ushtria. Të kërkojnë gjithandej...

— Po makinën e kanë gjetur? — pyeta unë nga thellësi e mullarit.

— Makina u dogj, u bë shkrumb. Katundarët i hodhën mbeturinat në Dri për të humbur gjurmët. — tha vajza, pastaj shtoi: — Unë po shkoj që të mos ngjall ndonjë dyshim. Në mbrëmje do të vij prapë.

Dola si urithi nga vrima. Rrëmbeva bohçën, e shpalo-  
sa. Dy shishe më ujë, petulla, kofsha pule të skuqura me  
miell, një brokë kos dhe dy franxholla. Vetëm suxhukët,  
që më pëlqenin pa masë, mungonin. «Mara e ëmbël dhe e  
dhemshur nuk më ka dërguar suxhukë, mbasi e di se ata  
ma shtojnë etjen... ose ma provokojnë shijen për raki...  
— mendova me vete.» Tek fillova të përtypesha, m'u zu  
kafshata në grykë nga një ngashërim i beftë, pikëllues e  
mallëngjyes. Duhet të jesh vrastar i pashoq t'ia thyesh ze-  
mrën një vajze si Mara... — më kaploi trurin ky mendim  
dhe për herë të parë provova shijen e kripur të lotëve.  
Rashë përmbys dhe qava për tërë vitet e zemërgurësisë dhe  
të zyrtësisë sime prej sedërmadhi e burri që kishte urreyer  
buzëvajat. Të dënesurat shpërthyese dhe rënkimmëdha më  
përmendën se isha ilegal në truallin tim. Me vullnet të squ-  
llur e mbloodha vetën. Kurrë ndonjëherë nuk kisha ndjerë  
si atë çast urrejtje të përzier me neveri ndaj cilësive të ka-  
rakterit tim. Vetëm fërkamë të murrme dhe bishore shiko-  
ja në tërë udhën e jetës. Mara njëzet vjeç, thashë me vete,  
unë tridhjetë e dy. Epo të kem dalë edhe nga barku i në-  
ntëqintë dreqërve, nuk duhej të sillesha kësisoj me të. Po  
Këpucari e Kasapi ku janë? I tradhtove, major Bumja. Të  
paktën kjo poshtërsi nuk gjallonte më parë në karakterin  
tënd! Asgjë lehtësuese për ta shfajësuar vetveten ato ças-  
te nuk ma paqtonte shpirtin e trazuar dhe vetëdijen e  
zgërlaqur. Zatën thoshte profesori i psikologjisë në aka-  
deminë ushtarake:,, Njeriu që ka forcë fizike të papërba-  
llueshme, njeriu me energji të mëdha muskulore, shpesh  
herë e përfytyron veten si div. Askënd nuk përfill, veç  
tekave të veta. Te njerëzit kolos jo rrallë jetojnë në armi-  
qësi arsyet me pasionet... Gjendja e tendosur nervore më  
bëri që ta quaja veten shakull me shpirtëra të këqinj. Ç'ki-  
sha bërë, dhe s'kisha bërë pak, për të mirën e njerëzimit,  
të shoqërisë dhe të truallit, u shpërbënë. Mendja më pu-  
nonte përtej kufijve skajor, të mugët, pa shpresë ndreqje-

je. Të gjitha kujtimet, gjer atëherë të shtrenjta, m'u dukën të kota, si eshtrat e një kafshe fare pa rëndësi hedhur në humbëtirë. Mbi të gjitha fajet me të cilat ngarkoja veten atë moment, ishte se ia kisha punuar Marës me të pabesë. Ajo edhe brenda dhëmbëve kanosës të rrezikut më kishte ardhur mbrapa deri në birën e dreqit. Ushqimet që kisha përpara vërtetonin sa lart qëndronte Mara në krahasim me mua. Gjithçka brerëse dhe e tytmë hidhte farë në trurin tim, mbinte e shumëzohej me shpejtësinë e njëqelizorëve: M'u shpif një thënie që e kisha dëgjuar, apo lexuar diku: Vdekja gjithmonë barabitet me dimrin dhe vetminë, por jo rrallë u jep fund mjerimeve. Ma ideoi edhe më keq zemërimin ajo shprehje. Fola me zë: Fatzî nuk është njeriu që ka dështuar në qëllimet fisnike, por ai që i humb shpresat për të rimarrë në dorë timonin e jetës. Iu gëzova këtij mendimi. Fillova të micëroj në bohçen me ushqime të Marës. Çdo kafshatë ma sillte të gjallë shembëlltyrën e saj.

Në shtëpinë e Gjinadardëve kisha zënë një dhomë me qira jo pse nuk mund të gjeja një banesë tjetër. Të gjitha dyert e prizrenasve ishin të hapura për mua. Zaten ky respekt e ajo dashamirësi më bënte fatkeq, mbasi nuk kisha asnjë mundësi t'ua shpërbleja në hallet e mëdha që jetonin pas çlirimit, apo zezimit, siç shprehej Këpucari. Pyetja e kthyer në enigmë që më torturonte dhe më kishte kredhur pranë kupës së rakisë, ishte: Po ta kishim kuptuar qysh në fillim tradhtinë e aleatëve të të ashtuquajturit «vëllazërim-bashkim», a do të kishim mundur t'i siguronim popullit një fat më të mirë? Pikërisht se pësimi u kthye në mësim mbasi e mori ferra uratën, kur provuam kafshimet e atyre që na hiqeshin shkuar vëllezërve, e kuptuam se na damllosi zhgënjimi. Prandaj begenisa një dhomë në shtëpinë e Gjinadardëve, sepse gjendej në krye të qytetit, larg zallahisë. Gjer atë kohë më kishin arrestuar rrumbullak pesë herë dhe kishin qenë të detyruar të më lironin sepse ish partizanët e batalionit tim, populli, që i kisha ndihmuar në ditët e zeza të pushtimit fashist, ishte derdhur në rrugë, dhe kishte kanosur pushtetmbajtësit me kryengritje, nëse më mbanin edhe njëzet e katër orë brenda.

Ditët i kaloja me dy shokët e mi në pijetore, por nata, që është e pabesë, duhej të më gjente në një strehë sa më

afër malit. Nëna e Marës, Lajdja, ishte grua e ve, dyzet vjeç. Burri tregtar i ishte vrrarë nga një bombardim tek po kihehej nga Dalmacia. Lajdja, edhe pse kishte dy herë moshën e së bijës, anise i kishte rënë zotshpillëku në krye dhe qeveriste pasuri të madhe, dukej e brishtë. E freskët dhe fort e bukur. Kur desha t'ia paguaja qeranë në fund të muajit të parë, ajo ma shtyu dorën me një miklim të tillë, sa më la të kuptoja që, përveç bujarisë e respektit, ushqente edhe diçka tjetër për mua. Më tha me zërin e ëmbël e melodios (cilësi e veçantë për femrat e Prizrenit): «Më lejoni t'ju thërres me emrin e vërtetë, zotni Emrush Vushtrija. Unë duhet t'ju paguaj që ma nderuat konakun. Në këto kohë të turbullta, një shtëpie me dy femra të reja, i duhet një burrë si mburojë». Pa asnjë fjalë filluan flirtet e mia me Lajden. Vajza jo vetëm që nuk dinte, por as nuk mund t'i shkonte nëpër mend një gjë e tillë, mbasi e ëma e saj u kishte bërë ballë shumë vardisjeve e elozheve të disa zotërinjve më me emër në Prizren dhe, duke qëndruar larg çdo tundimi, përmendej si shembull ndershmerie. Mara as sot, as mot kurrë nuk mund të besojë në atë ngatresë dashurie, jo vetëm pse e ëma e saj është 8-9 vjet më e madhe se unë, porse vajza edhe mua më pandeh si simbol të ndershmerisë. Gjatë dy moteve sa qëndrova në shtëpinë e Gjinadardëve, Marës i mësova gjermanishten dhe anglishten. Ajo në fillim u mahnit me dijet e mia prej poliglotti. Ndonëse e vëreja se i shkaktonte një lloj pezmi kujdesi dhe sjellja ime prej prindi, e thellova atë takt nga frika prej vetvetes. «Zotëri Emrush, — më tha një ditëzaj, — mos ndonjë rast do të më ofroni edhe biberonin?! Mos keni harruar se unë kapërceva të njëzetat?!» Unë qesha me të madhe dhe bëra sikur nuk kuptoja ku rrihte çekani i Marës. Ndonëse më ngriheshin mornica vetëm nga mendimi se mund të bija viktimë e ndonjë tundimi të fuqishëm dhe djallëzor, shpirti më elektrizohej sa herë gjendej pranë meje ajo krijesë që, siç thonë pijanecët, sikur e kishte krijuar perëndia me sqimë për vetveten. Dy shkaqe të normës morale më frenonin: së pari, flirtoja me nënën e saj; së dyti, Mara në shijen time intelektuale zinte një vend të rrallë qoftë për nga ndershmeria, pastërtia, edukata, zgjuarësia dhe për nga bukuria deri në përsosmëri. Nga ana tjetër, i bëja pyetje vetes: Mund ta bëja të lumtur unë, që kisha lindur në gërmadhat e Lullës së Parë. Botërore dhe

e kisha jetuar në kurriz të Dytën me tërë peshën e rëndë e zhgënjyese?! Mbi të gjitha, ndryshe nga moshatarët e mi, asnjë herë nuk e kisha shkuar nëpër mend martesën. Kurrë nuk i kisha premtuar as ushqyer shpresat asnjë femre se do ta merrja për grua. Pa e zënë ngojet kohën që jetonim, çdo mjedis dhe gjithçka më dukej si pazar intrigantësh, lukuni spekulatorësh politikë e moral, ordi inkuizitorësh të pashpirtë e racistë, zemërgurë e vrasarë. Një natë, tek po shfletoja një libër të Volterit, gjeta një letër. Mara kishte shkruar: «Ta trajtosh një vajzë si të mitur, duhet të të mungojë respekti. Të moskuptuarit e ndjenjave të saj, i quaj miopi, ndoshta edhe më keq...» Megjithëse ato fjalë më turbulluan, vërejtjen e parë u përpoqa ta ndreq, kurse të dytës ia thellova hendekun. Letrat vazhduan. I lexoja, i palosja ashtu siç i gjeja dhe i vendosja me kujdes po në ato faqe libri ku m'i linte Mara. Për ca kohë qëndroi e mbyllur në vetvete, madje, siç më dukej mua, hiqej me të madhe, si dinjitoze që nuk lejoi t'i nëpërkëmbën mendimet dhe ndjenjat. Unë vuaja për vete. Ia kisha drojën ndonjë çasti të paparashikuar, kur squllet vullneti, fiton pasioni dhe hidhesh në krahët e së lakmueshmes së ndaluar.

Tërë ditën e kaloja duke pirë me Këpucararin dhe Kasapin në pijetoren «Tre qingjat e pjekur». Një mesnatë u ktheva fort i dehur në banesë. Zonja e shtëpisë kishte vajtur tek e motra në Ferizaj. Sa u mbështeta në krevat, u hap dera. Hyri Mara. Ajo foli me një pezmë të frenuar: «Zotni Emrush, mos më thoni se nuk i keni lexuar letrat e mia që ua kam lënë vijimisht në faqet e librave të filozofit tuaj të zemrës. Edhe të mohoni, nuk ju besoj. Dua të mësoni një gjë: Asnjë djalë nuk më ka hyrë në sy gjer më sot. Mallkoj ditën që erdhët në shtëpinë tonë! Unë ju dua dhe nuk besoj se mund t'ju fatëzojë ndonjë tjetër sa unë. E ndiej se edhe ju më çmoni. Por dashuria e ndrydhur dhe e pashprehur fishket si sythi pa arritur të hapë petalet. Prandaj mora këtë hap të pashembullt për vajzat e qytetit tonë. Dua të ma thoni copë: Më doni, apo nuk më doni? — dhe shpërtheu në të dënësura. I trallisur jo aq nga rakia sa nga ajo krijesë e brishtë që po derdhte lotë, e mbërtheva për dore dhe e ula në anë të krevatit. Buzët tona u ngjitën si dy plagë të përvëlura.

Të nesërmen më pllakosi një zemërim kundër vetvetes



deri në marrëzi, ika kusarisht nga shtëpia e Gjinadardëve.

Tek po i kujtoja këto i strukur në mullarin e barit, prishi qetësinë zhurma e një autokolone në xhade. U struka edhe më thellë në barkun e mullarit. Armë nuk kisha, por isha i vendosur ta shpaguaja veten në çdo të papritur. Shumë njerëz në çastet më të rrezikshme për kokën, mbërthehen nga një shpresë e kushtëzuar «nëse rri urtë, mund të shpëtoj kryet». Unë nuk vuaja nga ky kompleks. Zhurma e makinave kaloi. Në pllajë sërish zotëruan çurlikimet e lareshave, zhurmërima e karkalecave, zukama e bletëve. Vendosa, sa të errej, të nisesha për në qytet. Nëse ishin vrarë Këpucari dhe Kasapi, do ta hidhja në erë ngrehinën e UDB-ës.

Ishte natë me hënë. Udhëtova fushës. Ju afrova shtëpive të bahçevanëve të Prizrenit. Duke pyetur njerëz të thjeshtë, të cilët më kishin strehuar gjatë luftës, mësova se Këpucari dhe Kasapi ishin arrestuar dhe gjendeshin në birucat e tmerrshme nën ngrehinën e UDB-ës. Bëra shumë plane me mend. Njërin e zgjodha si më të mirin. Do t'i shkoj befaz kolonel Spakoviçit në banesë. Do ta detyroj të lëshojë një urdhër me shkrim për lirim të Këpucarit dhe të Kasapit. Bashkë me ta do të dal në mal. Nuk e dija se çdo rrugë e rrugicë përgjohej në fshehtësi. Nuk më breu asnjë dyshim deri sa arrita tek Ura e Gurit mbi Bistricë. Tek po kaloja matanë, sikur të kishin mbirë nga gurët e kalldrëmit, m'u hodhën mbi kurriz një rrëmet milicësh, udbashësh e spiunësh. Për fat kishin urdhër të më bënin zap, të më lidhnin. Dashuria dhe respekti i popullit ndaj meje, përfshirë këtu edhe ata pak raja serbë, nuk besoj ta kishin vënë ndonjëherë në një dilemë të tillë qeverinë deri në Beograd. Ndryshe Spakoviçi do të kishte urdhëruar të më vrisnin në vend. Dy udbashë si gladiatorë që më sulmuan përballë, i hodha nga ura në Bistricë. Edhe dy-tre të tjerë që m'u kacavarën në shpinë, i përplasa mbi kalldrëmin e urës, pastaj i fërfëllova një nga një poshtë në ujë. Por batërdia e ndjekësve s'kishte të sosur. Luftoja si i marrë. Këmbësorët u zmbrapsën lebetitshëm. Por të dyja anët e urës u bllokuan nga suvaria milicore. Hodhën litarët. Më mbështollën dhe më tërhoqën zvarr në sheshin e Shtatërvanit. Atje më lidhën këmbë e duar. Kurrë nuk e kisha ndier veten aq ngushtë.

Për çudi, në vend të më shpinin në burg, më dërguan

në spital. Në vend të më merrnin në pyetje hetuesit, më vizitoi një lukuni «psikiatresh» të ardhur enkas nga Beogradi. Kur zbardhi dita, i sollën në spital edhe Këpucarin me Kasapin. Njëri prej atyrefarë psikiatrive e pyeti Kasapin:

— Si të quajnë?

— Lon Brisku, — gjegji tjetri.

— Vuan nga deliri i harrimit të vetvetes, — u tha psikiatri kolegëve dhe disa qytetarëve që i kishin sjellë atje. Pastaj kryepsikiatri buzëqeshi siç bëjnë mjekët e atij specialiteti me të çmendurit dhe vijoi: — Sindrom i njohur, Ky farë Lon Brisku, apo Kasapi është i bindur se është shquar në luftë. Ma ha mendja se edhe ky tjetri ka të njëjtën diagnozë, — dhe e pyeti Këpucarin: — si të quajnë?

— Lah Daka, — gjegji tjetri duke parë nga unë me sytë e mëdhenj e të mavijosur rreth e qark nga dackat që i kishin dhënë në UDB-e.

— Edhe ti njihesh në qytet me pseudonimin e luftës «Këpucari»?

— Po,

— Pseudonim luftime, ëëëë? — përqeshi me qesëndi kryepsikiatri.

— Po.

Kryepsikiatri hapi krahët sikur të thoshte «gjithçka e qartë». Pastaj urdhëroi njërin prej grupit të «psikiatërve»:

— Shkruaj për të parin: I çmendur me delirin e mbinjeriut, të harresës dhe me prirje agresiviteti të paparë. I pashërueshëm dhe tepër i rrezikshëm. Për të tre: Paraqesin rrezikshmëri shoqërore. Izolim dhe kurim në çmendinën e Nishit.

Mbasi u plotësuan dokumentët përkatës, u firmosën nga pesë psikiatër. Na hipën në një autoambulancë blu me sirenë shurdhuese. Tek po kalonim përmidis qytetit, na shpuan me ca gjilpëra të gjata. Kasapi dhe Këpucari lëshuan klithma nga dhembja e padurueshme. U hapën të dyja dyert e autoambulancës. Vura re plot sehirxhinj. Këpucari dhe Kasapi vazhdonin të klithnin nga shpimet përcëlluese të gjilpërave veterinerë. «Gjindja do të pandehin se me të vërtetë jemi të çmendur, — thashë me vete.

Sa dolëm nga qyteti, Këpucari dhe Kasapi u krodhën në një gjumë të thellë. Mua më bëhej se përbrenda kafkës shllapavitej një lëng i trashë e i vakët. Ilaçi që na kishin futur në damarë, po vepronte edhe tek unë...

## NË ÇMENDINËN E NISHIT

*Mposhtja ose asqjësimi i kundërshtarëve politikë mund të arrihet në shumë mënyra. Lufta më e përsosur kundër tyre, paçka se e pandershme dhe kundër çdo norme njerëzore, është t'i nivollosësh moralisht, ose të bësh çmos t'i shpallësh të çmendur e të papërgjegjshëm.*

**S**a u shëndëm brenda dverve të hekurta të çmendisë. U fola me këto frëngjisht, italisht, latinisht, anglisht. Ata tundnin kokën duke buzëqeshur shpirtitshëm. Kisha dëgjuar se drejtori i asaj çmendine të madhe ishte çifut. Për atë arsye nuk i fola gjermanisht. Por kur u shenda nënpara çëndrimit të tij të shurdhër, memec e nërcmues, u thashë të gjithëve gjermanisht: «Zotëri, ne të treve na kanë sjellë gabimisht këtu. Shkaktarët duhej t'i vërvitnin në këtë azil të pamendësh, sepse ata vuainë nga sindroma më e shëmtuar njerëzore, nga shqiptarofobia...» Drejtori çifut u tha të tjerëve rusisht:

— Nguleni mirë në mend! Shenja e parë e të sëmurëve

psikikë është të mohuarit e sëmundjes. E dyta, përpiqen të flasin me fjalë të mëdha, ose në gjuhë të huaj si ky djaloshi trupkolos.

Rusishten kisha filluar ta mësoja nga fundi i luftës. Megjithëse nuk e zotëroja aq mirë, e kuptova fjalë për fjalë drejtorin e spitalit. Dhe, për habi, nuk u zemërova që orvatja ime u vlerësua në të kundërtën e vet, por më fyeu fjala «djaloshi trupkolos». Në të, përveç ironisë cinike, kishte dhe zhvleftësim të personit. Unë isha tridhjetë e dy vjeç, qysh gjashtëmbëdhjetë vjeç isha përpjekur ta mbaja veten për burrë, madje nga ata të shquarit, jo vetëm se kisha lëshuar shtat dhe barabitesha me më të gjatët e fshatit, porse edukata e odave ku isha rritur, ma kishte ngulitur thellë atë dëshirë.

Na ndanë. Mua, si më «i rrezikshmi» më përplasën në një kafaz me katrorë të kryqëzuar hekuri. Atje gjendej një i çmendur me një këmbë. Më tepër ngjante me një terrorist, se sa me të sëmurë. I parruar, hundëkërrabë, mollzëgungë e me sy të atillë sa mendova: «Nëse do të qajë ky farë njerithi, në vend të lotëve, nga sytë duhet t'i rrjedhë gjak». Aq me damarë të kuq i kishte të bardhët e syve! Sa bëra ballë në atëfarë kafazi të tejdukshëm dhe u mbyll dera nga jashtë, i çmenduri me një këmbë u zgërdhi neveritshëm, ngriti putrën, m'i drejtoi gishtin drejtues dhe të mesmin si bigaç, duke u përjargur, ma bëri: «kikirikiki!» dhe m'i nguli të dy gishtat në sy. E merrja me mend se shumë sy përgjonin nga skutat. Mbulova me të dy parakrahët fytyrën. Gjuante e gjuante «mikpritësi» me një këmbë. Grushtat e tij kishin forcë tronditëse. Pas disa minutash, kur psikohetuesit ishin lodhur së gajasuri dhe kishin vajtur në klinikat e tyre, zbulova fytyrën. I çmenduri u mat të m'i rrate dy gishtat si bigaçe në sy me atë «kikirikun» hingërizës, i dhashë një grusht në nofull ashtu siç dija unë. Ai u rrekëllye mbi dysheme. E vetmja këmbë i tkurrej dhe i shtriqej si e qenit kur jep shpirt. E ktheva për së mbari. Ia mbërtheva krahët, ia lëviza për frymëmarrje artificiale. Tjetri u çtrullos. Ia futa edhe dy shqelma prapanicave. I çmenduri me një këmbë u zvarrit barkas në qoshen e kafazit pa guxuar as të pipëtinte. «Thuaj pastaj se i çmenduri nuk e njeh frikën!» mendova me vete, po koha do ta tregojë se çfarë i çmenduri do të jetë ky. Mund të ketë marrë barrë të rëndë për të shlyer ndonjë faj... Mund të

jetë ndonjë oficer i sigurimit ushtarak, për mungesë të një-rës këmbë, kryen të tilla shërbime për një pagë të majmë. Çfarë nuk shpikëkan disa aparate politike-shtetërore! Edhe të çmendurit e kundërshtarëve politikë.

Të nesërmen, ende pa zbardhur mirë dita, i çmenduri me një këmbë filloi të këlhiste thekshëm. I thashë të pushonte, ai filloi të lihte. E qëllova me grusht në stomak. Pastaj i dhashë edhe disa dacka me synimin, cilido që të ishte, ta mbante mirë parasysh me kë kishte të bënte. Kur filloi vizita mjekësore e paraditës, ai u ankua se kisha dashur ta tridhja dhe kërkoi ta shpinin për mjekim në ambulancën e kirurgjisë. E morën dy sanitarë që ngjasonin me boksierë, zatën tërë sanitarët e atij pavioni të tillë ishin. Kurrë më nuk ma zuri syri të çmendurin me një këmbë. Në kafazin tim sollën një tjetër. Ai vërtet ishte i çmendur. Nuk më linte të shtija gjumë në sy. Ia qava hallin një mjekeje, e cila mbante qëndrim disi ndryshe nga të tjerët. Ajo ngriti supet dhe vajti diku. Pas pak erdhi vetë drejtori i përgjithshëm, çifuti. Vetëm atë njeri nuk e kuptoja ç'vlerësim kishte për «sëmundjen» time. Më foli me një frëngjishte të kulluar:

— Mjekja më tha se nuk e ndjen veten mirë me bashkë-pacientin e dhomës... I thashë se ishte tepër agresiv, se, nëse më kishin sjellë për të më çmendur, e harxhonin kohën kot, mbasi unë isha i zoti t'i dilja në mbrojtje vetvetes. Iu luta në mënyrë të njerëzishme të ma hiqnin nga dhoma atë të sëmurë të mbrapësht e shamataxhi. Drejtori më shikoi në dritë të syrit, pastaj bëri një pyetje që m'u duk provokuese:

— Invalidin me një këmbë e të çmendur e solle në vete, përse nuk vepron edhe me këtë tjetrin asisoji?

— Ai ishte terrorist, ky është i çmendur, — ia pata unë.

— Ashtu...

M'u kujtua parimi gjenial i Hipokratit dhe ia thashë latinisht drejtorit:

— Edhe me presion nuk do të lejoj të shfrytëzohet dija ime mjekësore kundër humanizmit.

Drejtorit iu zvogëluan, pastaj iu zmadhuan bebet e syve. Unë sulmova me një thënie të Platonit, këtë herë italisht:

— Më mirë është të vdesin të sëmurët pa shpresë shë-

rimi, sesa t'u zgjatet jeta në dëm të ekonomisë së shtetit.

— E konsideroni të pashpresë shërimin e pacientit të dhomës? — pyeti drejtori italisht.

— Atë mund ta dini më së miri ju, — ia ktheva dhe shtova: — Për mendimin tim, është më mirë t'ua fshikullosh cenet njerëzve, se sa t'i vrasësh bashkë me veset.

— Ty duhet të të vizitoj seriozisht, — tha drejtori dhe më mori në zyrën e vet. Për çudi nuk më veshën këmi-shën pa mëngë e të gjatë që ngjante me një thes të ngushtë deri nën gjunj e që e përdornin sa herë i nxirrnin nga kafazi të çmendurit. Në zyrë zhvilluam biseda për shumë fusha të shkencave, si filozofisë, politikës e lingistikës. U binda se psikiatri me origjinë çifute ishte erudit me peshe dhe rrallë më kishte takuar të piqesha me një intelektual me të tillë horizont dijesh. Dyshimi m'u kthye në enigmë dhe pyeta veten si ka mundësi që ai njeri me cilësi gjeniu të kish pranuar të bëhej drejtor i një spitali të madh të vendit ku silleshin njerëz me rekomandimin e organeve të diktaturës së zezë, siç kishin bërë me mua dhe dy shokët e mi? Drejtori sikur t'm'i kishte lexuar mendimet, tha:

— Pavioni ku jeni shtruar ju nuk varet prej meje. Është repart i polisindromave. Ka specialistët dhe drejtorin e vet. Unë jam drejtor i përgjithshëm. Ki durim. Do ta diskutoj çashtjen tënde. Mund të të kalojmë në pavionin ku janë vendosur shokët e tu.

— Ata nuk vuakan nga polisindromat?! — pyeta me ironi.

— Specialistët e Prizrenit vetëm në fletëpërcjelljen tënde kanë shënuar atë diagnozë, — tha drejtori.

— Së pari, — thashë unë, — edhe macet e Prizrenit i njoh, jo më njerëzit. Pra, për specialistët që thoni ju, nuk janë nga qyteti ynë. Së dyti, pyes: për shokët e mi ç'është shkruar nga atafarë specialistë?

— Thjeshtë të sëmurë psikikë, — gjegji drejtori dhe ndoshta pse iu duk se foli si shumë pa doreza, iu squll zelli për të vazhduar më tej bisedën. Thirri mjeken së cilës i isha ankuar dhe i tha të më shpinte në kafaz.

— Ç'gjuhë të huaj zotëroni? — e pyeta doktoreshën rusisht.

— Italishten, — gjegji ajo buzagaz, — babain e kam kroat dalmatinë, kurse mamanë italiane.

— Ç'ju paska sjellë kaq larg? — e pyeta italisht.

— Babai shërben në këtë qytet si oficer madhor, — tha ajo, pastaj vijoi: — Thonë se ju dini shumë gjuhë, mos nga ngarkesa e stërmadhe jeni sëmurë?

— Të gjithë, më të dashurit e mi vuafshin nga sëmurdja ime, por kurrë mos paçin fatin tim t'i sjellin në çmendinë pa qenë të sëmurë, — ia ktheva unë.

Doktoresha u ndal. Më vështroi në sy. Kishte një vëzhgim të thellë e tepër të ëmbël. Ma kapi dorën, duke më shtrënguar tri herë lehtas e me miklim, pyeti:

— A denjoni të pini një limonadë kur të dilni nga spitali?

«Dreq o punë, — thashë me vete. — Ta kishte dëgjuar Kasapi këtë propozim, do ta fërkonte atë hundën rrumbullake e të tultë, do tundte kokën e madhe e do thoshte: Nëse do të ketë një viktimë femrash, ti do ta pësosh, sepse të ngjiten si mizat në mjaltë dhe ti nuk mund të dallos cila ta ka me hilë dhe cila të do... Megjithëse nuk dija si do të më vinte halli, për mirësjellje, i pohova doktoreshës:

— Do ta quaja kënaqësi dhe nder të veçantë të pinim bashkë një limonadë, por kushedi kur do t'u mbushet mendja këtyre psikohetuesve të më lirojnë...»

Tek po hyja në kafazin e thurur me shufra hekuri, doktoresha u ngjatjetua me një përzemërsi të pafshehur. I çmenduri ishte kredhur në marrëzinë e vet. I ishte tekur të numëronte qimet e këmbëve të veta që i kishte leshtore si të majmunit.

Me gjithë premtimet e drejtorit dhe hamendjet e mia se punët do të venin mirë, në mbrëmje u prish atmosfera. Në kafazin tim erdhi kryepari i pavionit, apo drejtori special i polisindromës. Shëmtoi surratin tek më pa. U mat të më pështynte, por kur vuri re që shtrëngovë grushtin, gëlltiti pështymën e vet. Përplasi derën dhe iku duke sharë. Pas gjysmë ore sollën një boksier katana në kafaz. Shoku im i dhomës e nisi sherrin i pari. Ai filloi t'ia ndukte qimet e kokës boksierit, i cili me një breshëri grushtash e shembi përdhe. Unë ruajta terezinë e asnjansit. Por boksieri më qëlloi me gishtin tregues në hundë, pastaj zhveshi pantallonat dhe m'i ktheu prapanicat, unë pështyva nga neveria dhe u largova në qoshin e kafazit. Boksieri mbërtheu pantallonat, si u hingriz, tha:

— Nuk dashke... Atëherë unë dua... Jam edhe aktiv, edhe pasiv... Qysh këtë minutë unë jam kral, ju të dy mantednutat e mia...

— Kur na e kërkon misioni human dhe fisnik i shërujesit edhe atë mund ta bëj, — tha Jadranka duke ia kthyer shpinën. Pastaj dëgjova hapat e saj të ngutshëm e ritmikë përgjatë koridorit që shpinte në zyrën e drejtorit të përgjithshëm.

Atë ditë nuk më ofruan as ushqimin e drekës. Pasdite vonë erdhën bokserosanitarët, më zgjidhën. Dikur vonë u dukën dy infermiere fort të kolme. Duke parë numrat e kafazeve, njëra u ndal përpara timit dhe i tha tjetrës: «Ja 339-ta». Unë dallova një tufë të bardhë flokësh midis leshrash gështenjë.

— Edhe të mos kishte kafazi numër, do ta kishim gjetur nga përshkrimi që i bëri doktoreshë Jadranka, — tha infermierja e dytë.

E para, balashja, më vështroi më sy të perënduar dhe, duke kakarisur i tha shoqes:

— Tashti nuk më habit interesimi aq i madh i doktoreshës, ky qenka mall për Kalemegdan...

Hapën çantën dhe më zgjatën përmes katrorit të hekurave tri pako çokollatë. Infermierja e parë tha:

— I ke nga psikoterapistja Jadrankë.

— Në darkë do të vijë të të vizitojë, — tha e dyta.

— Edhe në mesnatë nuk do të përtoja t'i bëja një vizitë këtij mashkulli div, — i tha infermierja e parë së dytës.

Pastaj të dyja u larguan duke hedhur e pritur rromuze.

I sëmuri i kafazit tim, ose ndukësi i qimeve, u shkri në gaz gjatë gjithë kohës sa qëndruan aty infermieret. Kur u larguan, ai filloi të qajë me dënësë. Dy pakot e çokollatave i hëngra si i babëzitur. Të dënësurat e shokut të dhomës ma këputën shpirtin. I zgjata 3-4 katrorë çokollate. Ai u mori erë. Filloi të përtypej dhe mbasi i bëri pelte, filloi t'i lyente këmbët. Duket i digjnin vendet ku tërë ditën kishte shkukur qimet. Tashti, si puna e të marrit, brumin e lëngëzuar të çokollatës e përdorte për mehlem. Kushedi!

Atë natë nuk erdhi njeri në kafazin tim. Të nesërmen turmat e mjekëve brodhën korridoreve, mërmëritën, zhurmuan, vizituan të sëmurët. Tek ne nuk erdhi kurrkush. Mendja më punonte furishëm. Ortaku i dhomës, duket kishte mbaruar me ndukjen e qimeve, numëronte dhe rinumëronte katrorët e hekurta të kafazit dhe grindej me veten: «Jo po janë kaq; jo po ishin aq...» Në mëngjes nuk na



sollën asgjë për të ngrënë. Në drekë na hodhën si qenve nga një copë bukë thekre me nga një fetë djathi që qelbej nga duhma ku lëvrinin shtrebat ngjyrë qelbi.

Erdhi mbrëmja, askush në kafazin tonë. Gjatë tërë natës syrit tim nuk i shpëtuan ecejaket e ca njerëzve me mantela të bardhë që më zhbironin me vështrime vjedhacake. Pyesja veten dhe nuk e gjeja përse doktoreshë Jadranka nuk u duk fare. Aty nga ora 11 e natës erdhi njëra nga infermierët që më kishin sjellë çokollatën një natë më parë. Ishte flokëgështenja me tufën e qimeve të bardha, të cilën qysh kur e pashë përsëpari e quajta me vete Balashe. Ajo u ndal përpara kafazit dhe më kumtoi:

— Doktoreshë Jadranka më porositi t'ju kërkoja falje në emër të saj, mbasi nuk iu bë puna të vinte t'ju vizitonte mbrëmë. Mori një telegram dhe ngutësisht u nis për në Pulë. I është aksidentuar i vëllai. Mund të vijë t'ju sjellë qetësues kolegia ime, Zdravka. Ajo do të punojë edhe në ndërresën e tretë, mbasi zëvendëson doktoreshën. Fitoj nga rasti të përshëndetem, meqë nesër filloj lejën. Do ta kaloj në plazhin e Ulqinit. Dhëntë fati, gjej ndonjë burrë, se lufta që kaloi, na i kositi meshkujt... — dhe pas një ngërdheshjeje sikur të tallej me vetveten, e zhbiroi shokun e kafazit tim, mbasandaj me një vështrim dedektivësh përmblodhi dy anët e koridorit, ma bëri me gisht t'i afrohesha sa më pranë. Pëshpëriti: — Ju s'keni nevojë për qetësues. Mos pranoni asnjë lloj injektimi...

— Megjithëse nuk njihemi, ju jam mirënjohës për këshillën dhe kujdesin! — i thashë disi i hutuar.

Balashja vuri dy gishtat mbi buzët e veta të tulta, përbiroi dorën përmes katrorit të kafazit, preku buzët e mija.

«Grackë laviresh!» — mendova me vete dhe m'u squll zelli t'ia zgjatja. Tjetra ma nguli vështrimin sikur të lexonte ndonjë libër të rrallë e të çuditshëm. Tha me një fije zëri:

— Kolegia ime, Zdravka, dyshoj se është oficere e policisë sekrete. Shoqet e mija, thonë se ajo ka zbuluar plot disidentë të regjimit, të cilët situata i ka shtyrë të shtiren si të çmendur. Sot ata gjenden në kampin-ferr të Goli Otokut.

— Por unë ndryshoj prej të tillëve sepse ngul këmbë se nuk jam i sëmurë, ç'kërkojnë të zbulojnë prej meje?! — ia ktheva,

— Doktoreshë Jadränkën e kam bijë tezeje. Ajo më ngarkoi t'jua tërhiqja vëmendjen. Edhe një gjë: Në kartelën tënde thuhet se je qejfli i kuturitur femrash dhe çapëkën i papërmbajtur. Zdravka si voluptioze të ka fort për zemër. Megjithatë... Ta dish, nëse përgojon bisedën time, do të ma shuash qiriun e jetës; edhe për vete nuk përfiton hiçkurr gjë! — përfundoi Balashja dhe iku duke më përcjellë një nojmë puthjeje me gishtin tregues.

M'u krijua pandehma se truri im punonte me ndërresa. Ai ishte ndarë në zona që vepronin secila kokëmëvete. Në një qoshe të trurit u shfaq një gjykim: «Disa, përveç fytyrës që ua ka dhuruar natyra, krijojnë një fytyrë të dytë si maskë...» Kjo thënie u çeli grykëderdhjen mendimeve që më përmbysten me një rrëmet kundërshtish. U shtriva në atëfarë shilteje gozhduar në dysheme. Me duart të lidhura prapa kokës, prisja e përcillja pyetje të llojllojshme, të cilat vërshonin me aq trysni, sa nuk më lenin kohë të gjeja ndonjë përgjigje, apo të arrija në ndonjë përfundim. Në atë rrëmujë mendimesh të pacak e kufi dhe ndijmësh të brengosura, erdhi njëri prej atyre sanitaroboksierëve, ma zgjati këmishën e ngushtë e pa mëngë. U mat të ma vishte, por e godita me bërryl nën mjekërr dhe, ndonëse ishte kataka, u përplas aq keq mbi hekurat e kafazit, sa u plandos mbi dysheme. Për herë të parë i çmenduri i dhomës time, «qimendukësi» shprehu një shqetësim logjik: «E mbyte mëkatarin! I ziu ti! Do të të vrasin të sëmurët me mantella vampirësh!» — tha ai, pastaj filloi të grindej me vetveten, sepse i ngatërroheshin llogaritë në numërimin e katrorëve të kryqëzuara të kafazit. Sakaq, sikur të kishin mbirë nga dyshemeja e betontë, m'u vërsulën lukunia e sanitaroboksierëve. As nuk vura re nga erdhën. Mbjaj mend se u gjenda i qerthulluar. Disa më goditën me shkopinj gome, ndonjëri me shufër hekuri. Këto ishin regjistrimet e para në tru, për aq kohë sa ua ktheva kundërgoditjet me një dëshirë të marrë për të qenë vërtet i çmendur. Pastaj m'u err pamja, humba vetëdijen. Nuk di sa kohë kalova në atë gjendje të fikti. Më kujtohet si nëpër tym kur hapa sytë, vura re se gjendesha në një zyrë si kthinë burgu, i mbërthyer në këmishën frymëzënëse e të gjakosur. Më goditnin me pëllëmbë plumb të rënda dhe si jehonë të largët dëgjoja një zë femre që u thoshte torturuesve:

— Mjaft më! Nëse nuk largoheni këtë minutë, o të tre-

dhur, do të hap zjarr mbi ju!.. — pastaj më kapi veshi tringëllimën e metaliktë të revolës kur u fut fisheku në folenë e tytës.

Hapa me mundim qepallat që më ishin ënjtur e rënduar nga të goditurat. Përmes një vagëllimi të tymnajtë sytë m'u mbushën me fytyrën e Zdravkës. Maja e hundës së saj e kthyer sapak përpjetë m'u duk si sqep. Dhëmbët e rregulltë, të zverdhur në pjesën e parë nga tymi i duhanit m'u dukën si squfur, ndezur në laborator. Sytë me bishta lëshonin një feksje lozanjare dhe qesendisëse. Në vesh m'u përftua jehona e zërit të Balashes: «... Kolegia ime, Zdravka, dyshoj se është oficere e policisë sekrete e tebdilosur si ndihmës mjeke...» Bëra të ngrihem. Por më kishin lidhur për krevati. Këmisha e mallkuar, pa mëngë, ma ngushtonte frymëmarrjen. Zdravka, si bërbeliti nëpër dhëmbë një sharje, mbylli derën nga brenda. Lëshoi revolen midis shishkave të ilaçeve mbi tavolinë. Mua sërish më tingëlluan fjalët e Balashes: «Ju s'keni nevojë për qetësues. Mos pranoi asnjë lloj injksioni!!» I dhashë trupit me vërtik. Tërë gjymtyrët më therën si dhëmballë të prishura. Fillova të ulërij më një zë të çoroditur. Pastaj nisa të shkelmoj me pjesët e këmbëve që ishin të lira nga këmisha e ngushtë e pa mëngë. Zdravka u ul puqur me trupin tim, m'i mbështeti gjinjntë e fryrë mbi gjoks, bërbeliti: «Barbarët e pacipë... Qetësohu! — më tha dhe m'i ngjiti buzët përvëluese mbi të mijat. Qëndroi në një mëdyshje të shkurtër, pastaj filloi të ma hiqte këmishën si thes. Ndonëse i sflitur e me dhembje të lemerishme trupore, e mora me mend brendinë e atij prologu. Për çudi, sikur të mos vuaja nga tërë ai makrabilitet që ishte derdhur mbi trupin tim, më breu një shqetësim: «Kjo Zdravka mos më meleps me ndonjë sëmundje veneriane...» I hodha një vështrim tërë ankth. Fytyra e ndihmës mjekes ishte kthyer në all. Mollëzat e faqeve i ishin zbehur. Sytë i ishin turbulluar. Flegrat i hapeshin e i mbylleshin me një aritmi të çuditshme. Pasi më zhveshi dhe më puthi në të gjitha pjesët e trupit, mori një shukë pamuku, e ngjeu në acid borik, m'i pastroi plagët nga gjaku i mpiksur. Unë qëndroja si i hipnotizuar. Ndonëse isha i zgjidhur dhe i çliruar nga këmisha e ngushtë e pa mëngë, asnjë gjymtyrë nuk e lëvizja dot. Zdravka, pasi lëshoi perdet e trasha mbi dritare, si kontrolloi edhe një herë çelësin në bravën e portës, filloi të zhvishej. U mata të

këfthitja. Por më ishte shuar zëri. Ajo me trupin si të derdhur në allçi u shtri puq trupit tim. Filloi të më miklonte në atë mënyrë sa m'u mbush mendja se edhe të vdekurin mund ta ngjallte. Pa dashjen time, madje edhe nën peshën e nja makthi troshitës e ndjeva veten burrë. Nuk kishia provuar kurrë një femër të tillë me veçori aq të ndezura e çmendurore. Ajo u krodh në afshin e vet turbullues, unë bërbëlitja një refren: «Si do të më vejë halli mua të mjerrit!» Më vonë nuk mbaj mend asgjë. Nga ora dhjetë e ditës së nesërme më doli gjumi. Bëra të ngrihem, më kërcitën kokallat prej dhembjeve. E ndieja veten të dërrmuar. Zdravka më kishte veshur një palë bizhama fanellate. Gjunjët dhe bërrylat m'i kishte mbështjellë me fasho. Të më falje jetën e më fatlumit në botë, nuk mund të përcaktoja nëse ajo natë e llahtarshme kishte qenë një ëndërr apo një zhgjendërr. Dyshova mos vërtet isha i çmendur. Koka më dhimbte, por e ndjeja fare bosh. Edhe kur u përpoqa të rikujtoj ç'më kishte ndodhur brenda atij njëmbëdhjetë orëshi, asnjë fresk s'ma kthjellonte mendjen. Një amështi, si nëpër tym, pa u prekur ose zemëruar, ndieja një lloj fyerjeje të dinjitetit, njëfarë lëmshi të lëndimit moral. Bëra çmos t'i ofroja vetes çastet më të lumtura të jetës për t'u gëzuar; por, sakaq, edhe ata shkëndija të mefshta që premtinin ngazëllim u shuan. Instinktivisht më shpërtheu një thirrje nga gjoksi: «O hidhërimi im, përse nuk jam i madh sa ti!» Dhe më pllakosi një dyshim i frikshëm mos vërtet isha i çmendur. Pas kësaj ndjeva pickime në tërë pjesët e ndieshme që përceptojnë ngacmime. Gjaku më vërshoi ndër deje, sërisht thirra pa dashje: «Ç'burrë dreqi je ti, o Emrush Vushtrija, i famshmi i luftës Major Bumja, që të përdhunojnë gratë?!» Dy fjalët e fundit, shqiptuar nga goja ime, duket ngacmuan atë pjesë të kores së trurit që ruante ende lidhje me logjikën njerëzore, u këthyen në gjykatës të rreptë. Dhe nxori krye gjykimi patriarkal: «Ti, Emrush Vushtrija, i ashtuquajturi i famshmi major Bumja, a e quake dhunim një mendjeshkrepje femre, në kohën kur në këtë vend s'ka burra?! Edhe ata meshkuj që rravgojnë, të trullosur nga ajo që prisnin prej lufte dhe gjetën një gjë tjetër, ngajjnë me femra qyrramane! Ndien fyerje nga veprimi i një femre epshore, kur kushedi sa herë në orët e kotësisë së beqarllëkut tënd ke ëndërruar një mundësi të tillë, bile fort të dëshiruar...»

afër malit. Nëna e Marës, Lajdja, ishte grua e ve, dyzet vjeç. Burri tregtar i ishte vrarë nga një bombardim tek po kthehej nga Dalmacia. Lajdja, edhe pse kishte dy herë moshën e së bijës, anise i kishte rënë zotshpillëku në krye dhe qeveriste pasuri të madhe, dukej e brishtë. E freskët dhe fort e bukur. Kur desha t'ia paguaja qeranë në fund të muajit të parë, ajo ma shtyu dorën me një miklim të tillë, sa më la të kuptoja që, përveç bujarisë e respektit, ushqente edhe diçka tjetër për mua. Më tha me zërin e ëmbël e melodios (cilësi e veçantë për femrat e Prizrenit): «Më lejoni t'ju thërres me emrin e vërtetë, zotni Emrush Vushtrija. Unë duhet t'ju paguaj që ma nderuat konakun. Në këto kohë të turbullta, një shtëpie me dy femra të reja, i duhet një burrë si mburojë». Pa asnjë fjalë filluan flirtet e mia me Lajden. Vajza jo vetëm që nuk dinte, por as nuk mund t'i shkonte nëpër mend një gjë e tillë, mbasi e ëma e saj u kishte bërë ballë shumë vërdisjeve e elozheve të disa zotërinjve më me emër në Prizren dhe, duke qëndruar larg çdo tundimi, përmendej si shembull ndershmërie. Mara as sot, as mot kurrë nuk mund të besojë në atë ngatrrësë dashurie, jo vetëm pse e ëma e saj është 8-9 vjet më e madhe se unë, porse vajza edhe mua më pandeh si simbol të ndershmërisë. Gjatë dy moteve sa qëndrova në shtëpinë e Gjinadardëve, Marës i mësova gjermanishten dhe anglishten. Ajo në fillim u mahnit me dijet e mia prej poliglotti. Ndonëse e vëreja se i shkaktonte një lloj pezmi kujdesi dhe sjellja ime prej prindi, e thellova atë takt nga frika prej vetvetes. «Zotëri Emrush, — më tha një ditëzaj, — mos ndonjë rast do të më ofroni edhe biberonin?! Mos keni harruar se unë kapërceva të njëzetat?!» Unë qesha me të madhe dhe bëra sikur nuk kuptoja ku rrihte çekani i Marës. Ndonëse më ngriheshin mornica vetëm nga mendimi se mund të bija viktimë e ndonjë tundimi të fuqishëm dhe djallëzor, shpirti më elektrizohej sa herë gjendej pranë meje ajo krijesë që, siç thonë pijanecët, sikur e kishte krijuar perëndia me sqimë për vetveten. Dy shkaqe të normës morale më frenonin: së pari, flirtoja me nënën e saj; së dyti, Mara në shijen time intelektuale zinte një vend të rrallë qoftë për nga ndershmëria, pastërtia, edukata, zgjuarësia dhe për nga bukuria deri në përsosmëri. Nga ana tjetër, i bëja pyetje vetes: Mund ta bëja të lumtur unë, që kisha lindur në gërmadhat e Luftës së Parë Botërore dhe

e kisha jetuar në kurriz të Dytën me tërë peshën e rëndë e zhgënjyese?! Mbi të gjitha, ndryshe nga moshatarët e mi, asnjë herë nuk e kisha shkuar nëpër mend martesën. Kurrë nuk i kisha premtuar as ushqyer shpresat asnjë femre se do ta merrja për grua. Pa e zënë ngojet kohën që jetonim, çdo mjedis dhe gjithçka më dukej si pazar intrigantësh, lukuni spekulatorësh politikë e moral, ordi inkuizitorësh të pashpirtë e racistë, zemërgurë e vrastarë. Një natë, tek po shfletoja një libër të Volterit, gjeta një letër. Mara kishte shkruar: «Ta trajtosh një vajzë si të mitur, duhet të të mungojë respekti. Të moskuptuarit e ndjenjave të saj, i quaj miopi, ndoshta edhe më keq...» Megjithëse ato fjalë më turbulluan, vërejtjen e parë u përpoqa ta ndreq, kurse të dytës ia thellova hendekun. Letrat vazhduan. I lexoja, i palosja ashtu siç i gjeja dhe i vendosja me kujdes po në ato faqe libri ku m'i linte Mara. Për ca kohë qëndroi e mbyllur në vetvete, madje, siç më dukej mua, hiqej me të madhe, si dinjitoze që nuk lejon t'i nëpërkëmbën mendimet dhe ndjenjat. Unë vuaja për vete. Ia kisha drojën ndonjë çasti të paparashikuar, kur squullet vullneti, fiton pasioni dhe hidhesh në krahët e së lakmueshmes së ndaluar.

Tërë ditën e kaloja duke pirë me Këpucarën dhe Kasapin në pijetoren «Tre qingjat e pjekur». Një mesnatë u ktheva fort i dehur në banesë. Zonja e shtëpisë kishte vajtur tek e motra në Ferizaj. Sa u mbështeta në krevat, u hap dera. Hyri Mara. Ajo foli me një pezmë të frenuar: «Zotni Emrush, mos më thoni se nuk i keni lexuar letrat e mia që ua kam lënë vijimisht në faqet e librave të filozofit tuaj të zemrës. Edhe të mohoni, nuk ju besoj. Dua të mësoni një gjë: Asnjë djalë nuk më ka hyrë në sy gjer më sot. Mallkoj ditën që erdhët në shtëpinë tonë! Unë ju dua dhe nuk besoj se mund t'ju fatëzojë ndonjë tjetër sa unë. E ndiej se edhe ju më çmoni. Por dashuria e ndrydhur dhe e pashprehur fishket si sythi pa arritur të hapë petalet. Prandaj mora këtë hap të pashembullt për vajzat e qytetit tonë. Dua të ma thoni copë: Më doni, apo nuk më doni? — dhe shpërtheu në të dënesura. I trallisur jo aq nga rakia sa nga ajo krijesë e brishtë që po derdhte lotë, e mbërtheva për dore dhe e ula në anë të krevatit. Buzët tona u ngjitën si dy plagë të përvëluara.

Të nesërmen më pllakosi një zemërim kundër vetvetes

deri në marrëzi, ika kusarisht nga shtëpia e Gjinadarëve.

Tek po i kujtoja këto i strukur në mullarin e barit, prishti qetësinë zhurma e një autokolone në xhadë. U struka edhe më thellë në barkun e mullarit. Armë nuk kisha, por isha i vendosur ta shpaguaja veten në çdo të papritur. Shumë njerëz në çastet më të rrezikshme për kokën, mbërthehen nga një shpresë e kushtëzuar «nëse rri urtë, mund të shpëtoj kryet». Unë nuk vuaja nga ky kompleks. Zhurma e makinave kaloi. Në pllajë sërish zotëruan çurlikimet e laureshave, zhurmërima e karkalecave, zukama e blëteve. Vendosa, sa të errej, të nisësja për në qytet. Nëse ishin vrarë Këpucari dhe Kasapi, do ta hidhja në erë ngrehinën e UDB-ës.

Ishte natë me hënë. Udhëtova fushës. Ju afrova shtëpive të bahçevanëve të Prizrenit. Duke pyetur njerëz të thjeshtë, të cilët më kishin strehuar gjatë luftës, mësova se Këpucari dhe Kasapi ishin arrestuar dhe gjendeshin në birucat e tmerrshme nën ngrehinën e UDB-ës. Bëra shumë plane me mend. Njërin e zgjodha si më të mirin. Do t'i shkoj befaz kolonel Spakoviçit në banesë. Do ta detyroj të lëshojë një urdhër me shkrim për lirim të Këpucarit dhe të Kasapit. Bashkë me ta do të dal në mal. Nuk e dija se çdo rrugë e rrugicë përgjohëj në fshehtësi. Nuk më breu asnjë dyshim deri sa arrita tek Ura e Gurit mbi Bistricë. Tek po kaloja matanë, sikur të kishin mbirë nga gurët e kalldrëmit, m'u hodhën mbi kurriz një rrëmet milicësh, udbashësh e spiunësh. Për fat kishin urdhër të më bënin zap, të më lidhnin. Dashuria dhe respekti i popullit ndaj meje, përfshirë këtu edhe ata pak raja serbë, nuk besoj ta kishin vënë ndonjëherë në një dilemë të tillë qeverinë deri në Beograd. Ndryshe Spakoviçi do të kishte urdhëruar të më vrisnin në vend. Dy udbashë si gladiatorë që më sulmuan përballë, i hodha nga ura në Bistricë. Edhe dy-tre të tjerë që m'u kacavarën në shpinë, i përplasa mbi kalldrëmin e urës, pastaj i fërfëllova një nga një poshtë në ujë. Por batërdia e ndjekësve s'kishte të sosur. Luftoja si i marrë. Këmbësorët u zbrapsën lebetitshëm. Por të dyja anët e urës u bllokuan nga suvaria milicore. Hodhën litarët. Më mbështollën dhe më tërhoqën zvarr në sheshin e Shtatërvanit. Atje më lidhën këmbë e duar. Kurrë nuk e kisha ndier veten aq ngushtë.

Për çudi, në vend të më shpinin në burg, më dërguan

Fytyra e Zdravkës u mavijos. Sytë e saj, që përpara pak sekondave derdhnin ëmbëlsi, u hapën vertikalisht, dorë që më përkëdhelte në gjoks u mbërthye nga një ngjergërvishtës. Shpërtheu duke dënesur:

— Ti, në krahët e mi dhe mendon për një çupërlinë që nuk merr vesh nga seksi sa një gomare nga abetarja?! Ti! Ti! — Ajo u mbërthye nga një nervozizëm tërbues. Zatën në çdo veprim ajo notonte mbi maja ekstremesh. Më qëllonte me grushta dhe jargavitej. Nga buzët e çaraveshura shante si e shkalluar.

Në kohën që Zdravka zhgërryhej puq meje dhe më qëllonte, u hap porta, hyri Meleviçi i shoqëruar prej disa sanitaroboksierëve.

— Dashke edhe të na i përdhunosh vajzat, ti, psikopat, horr, i çmendur dhe i degjeneruar!

Zdravka brofi duke mbështjellë çarçafin mbi trupin e lakuriqtë. Kur po prisja të shpërthente në klithje anku-ese, mbeta pa mend, sepse Zdravka më mori në mbrojtje:

— Druzhe Meleviç, — i tha atij larë profesori, — mos e ngarkoni me faj të sëmurin. Me dëshirën time iu futa në krevat. Për qëllime humane ia ofrova ndihmën, kur bishat e këtij pavioni synonin ta mbytnin, ose ta tridhnin...

Një grusht i fuqishëm e hodhi përdhe Zdravkën. Meleviçi i bëri një gjilpërë në të ndenjura.

U mblodha kutullaq në krevat, me synim të vdisja duke u mbrojtur. Por sanitaroboksierët e hodhën Zdravkën e alivanosur mbi një barelë, e mbuluan me çarçaf dhe e shtynë përpara. Dolën të gjithë duke e mbyllur portën me bravë pas vetes.



## MË ÇOJNË NË BIRUCËN E IZOLIMIT

*Nganjëherë natyra tregohet dorëlëshuar, kur u dhuron aq poshtërsi disave, sa nuk dijnë si ta harxhojnë atë...*

**S**e si më kishin vënë në gjumë as atëherë, as më vonë nuk e mora vesh. Ndoshta më kanë lëshuar gaz gjumëdhënës përmes vrimës së çelësit. Kushedi! As nuk kisha kohë ta vrisja mendjen për atë punë, mbasi e ndieja veten të dërrmuar, sa habitesha si merrja frymë dhe si gjalloja. Rrotulloja sytë, nuk mund të përcaktoja ku ndodhesha. Mbi komodinën në anën e djathtë të krevatit kishte shumë shishe ilaçesh. Ndrëimi ishte i mugët; ajri i dhomës zagushitës me një kutërbim ndotës. Kthinë e trishtueshme si në morg. Në fillim cra e ilaçeve e përzier me një lloj kundërmimi coftine ma çoi krupën, zatën ajo ma ngushtoi frymëmarrjen dhe më zgjoi nga ai farë gjumi letragjik. Ndërsa me sy të shqyer shikoja rreth e qark, më mbërtheu një kromë lëkurëndezëse e përcëlluese sa më nxorën lotë të vala sytë. U rrotullova një herë, u rrotullova përsëdyti, ndjeva se qindra insekte më lëviznin në tërë trupin. Futa të dyja duart, u krova. Mollëzat e gishtave m'u njomën

me njëlloj lëngu. Kur u mora erë duarve, kutërbimi më ndolli një krupë të lëmërishme, sa më erdhi për të vjellë. Por ç'të nxirrja, kushedi sa ditë më kishin lënë pa ngrënë. U mbërtheva për të dy anët e krevatit dhe kur bëra të ngrihesha çdo gjymtyrë më theri, e trupi më ngjau me një plagë të madhe. Duke u kruar, arrita të gjeja çelësin elektrik. U hodha një vështrim mureve, mizëri insektesh, si ushtri jeniçerësh lëviznin varravinga. Ishin tartabiqë. Ca, të fryrë me gjak, lëvrinin me përtaci dhe pikonin mbi dyshe-me. Të tjerët, petashuq e të uritur suleshin drejt shtratit tim. Drita i tërboi. Por në errësirë përveç se ma kishin thithur gjakun dhe përcëlluar lëkurën, e kishin mbushur dhomën me atë kundërmim ndotës e të pështirosur. Hoqa pizhamat. me të cilat më kishin veshur, i shkunda. Por atë çast u detyrova të vishesha me ngut, sepse më sulmuan lakuriqët e natës. Ku i kishin gjetur tërë ato krijesa të errësirës, që, veç cerrcerreve gërryese, suleshin për të kafshuar me dhëmbët e tyre të prehtë. Mbasi u mbështolla edhe me batanijen e leshtë, u skutullova në qoshen e birucës. Lakuriqët ndonëse të verbër, të ngacmuar nga drita elektrike, brodhën sa brodhën tollovitshëm, pastaj u kacavarën njëri mbi tjetrin nëpër trekëndëshat e tavanit duke krijuar toptha të mëdhenj e të murrmë. Në atë shushatje të betershme, m'u kujtuan mësimet mbi mjetet e luftës bakterologjike që kishim bërë në akademinë ushtarake. Në një pasazh të atij leksioni thuhej; «... Edhe lakuriqët e natës janë kafshëza që preken si edhe qentë edhe ujqit nga tërbimi. Kjo sëmundje tepër e rrezikshme mund të injektohet te lakuriqët, për t'i përdorur këta të fundit kundër armiqve që strehohen nëpër shpella. Ata (lakuriqët) janë mjeti më i efektshëm kundër njësive guërrilase armike që strukën ditën nëpër mjedise të errëta dhe yeprojnë natën... »

Ç'dreqin m'u kujtua ai kapitull i luftës bakterologjike! Veç kromës së mënxyrshme nga tartabiqët më pllakosi edhe ankthi i kafshimit të atyre kafshëzave fluturuese, por që ngjasonin me minjtë e fëlliqur. U rimbështolla me batanije pa lënë asnjë vrimëz nga mund të më futej në trup ndonjë lakuriq i molepsur me mikrobin e tërbimit. Nga frika nuk më zinte gjumi, as guxoja të kruhesha. Më zihej fryma nga dühma aq pështirësese që kishin përhapur tartabiqët, por duroja. Kaloi shumë kohë në atë gjendje. U përpoqa të kujtoja diçka që të zbutja atë pezmatim ner-

vor, por edhe kujtimet m'u bë se binin erë të qelbur. Nuk dija nëse ishte ditë, apo natë, kur u dëgjua zhurmë e hapave matanë atij ferri ku gjendesha dhe u hap porta me rropamë. Hynë hordhi sanitaroboksierësh me maska në fytyrë, me dorashka në duar. Ma veshën këmbëshën e gjatë pa mëngë. Më përplasën në një barrelë, pasi më mbuluan me një mushama gri si të vdekurit. Pas pak u gjenda në një banjë me vaskë me ujë të vakët. Më lanë shpejt e shpejt, më veshën me pizhama të reja dhe më dërguan në një dhomë të ndritshme, ku gjithçka, edhe muret, edhe tavolina, edhe krevati me mbulesë ishin të bardha si bora. Deri në atë çast as gishtin e vogël nuk e kisha lëvizur për të kundërshtuar. Kur më vendosën në krevat dhe u matën të më jepnin një gjilpërë; i vështrova ata njerëz me maska, të cilat nuk i kishin hequr gjatë tërë veprimeve që përmenda; u xhindosa në atë farë feje, sa dyshova mos isha molepsur nga tërbimi. Infermierin që po ma zhvishte vendin e të ndenjurrave e që e kishte kokën sa një shinik, e përplasa katërlëmsh te dera. Të tjerët uà dhanë të klithurave. Dikush: murtaja! Disa: kolera, të tretët: tifoja! E ngri-tën infermierin kokëshinik ashtu të përgjakur në hundë. Turravrap u larguan nga dhoma. Në veshët e mi mbeti je-hona e klithmave. «Të më kenë molepsur tartabiqët me mi-krobin e murtajës? — pyeta veten. E dija se kishte murtajë bletësh, por të kishte edhe tartabiqësh nuk kisha lexuar gjë-kundi. Fërgëllova. «Murtaja shfaqet me zjarrmi, këputje gjymtyrësh, me dhimbje koke, — thashë me zë. Kurse ko-lera me qelbëzim zorrësh, me heqje të forta barku. Tifoja shfaqet me njolla të kuqe në trup. Pra asnjërën nga she-njat e këtyre sëmundjeve nuk e kam. Po përse bërtisinin ashtu sanitaroboksierët me maska dhe u larguan zallahi-shëm tamam siç iket prej murtaje?!» Sa herë më pllakoste ndonjë turbullirë shpirtërore apo brengë, kisha gjetur aq vullnet te vetja, sa t'ua mbyllja dritaret mendimeve të kë-qija dhe në aso rastesh ndillja gjumin me përdhunë. Edhe atë çast, mbi atë krevat që binte erë pastërti, u përpoqa të sillja nëpër mend rastet më të këndëshme të jetës, sepse kujtimet i çmoja si visarin më të shtrenjtë. Kujtova fshat-in dhe fëmijërinë e shkujdesur, m'u rënduan qerpikët në një dehje të lehtë dhe të ëmbël. «Meleviçët e kanë mbu-shur birucën me insekte dhe kafshëza të molepsura! Pran-daj sanitaroboksierët ishin të sigurt se unë tashmë isha in-

fektuar... Prandaj erdhën me maska dhe dorashka... «Ky mendim më hyri si zukamë në tru. Kaq u desh. Gjumi mori arratinë i tromaksur. Filluan të më parakalonin të gjitha fytyrat duke u nisur nga çasti që kisha mbërritur në atë psikiatri. Fytyrat herë shpërbëheshin, herë bymeleshin më përmasa përbindshi. Herë shfaqeshin me rrëmet me sy të bashkuar, me gojë të përziera, me poret e fytyrave si mazgalla. Të gjithë flisnin njëherësh. Pastaj pikaste zëri i Meleviçit: «Ky zdap, psikopat, i çmendur i degjeneruar duhet të metamorfózohet, ose... ose të tridhet!...» Fill pas tij zëri i infermiere Balashes «Ke mendjen, profesor Meleviç! Emrush Vushtrija, alias major Bumja ka miq në Marshallatë...» Zura veshët me pëllëmbë. Zhurmat, u kthyen në një ngacmim të papërbalueshëm, sa dyshova se do të më pëlciste rrashta. «U çmenda! — thashë me vete.

Ndërkohë u dëgjua shklokkitja e çelësit në bravë. Dera u hap. Në dhomë u fut një duzinë njerëzish me mantela të bardhë. Midis tyre dallova psikiatren Jadrankë. Ajo, i pëshpëriste diçka një burri të gjatë me tëmtha të thinjura. Ai filloi të nuhaste duke thithur hundën piciruke. I bëri shenj një tjetri. Ky i fundit shetiti nëpër hapësirën e dhomës monometrin. E mora me mend se ai provonte mos ishte i helmatisur ajri i hapësirës ku gjendesha. Për çudi, të gjithë telat e shpirtit m'u ndehen nga një lloj këndellje e shpresës, sepse midis mantelbardhëve gjendej edhe Jadranka. Së pari u gëzova se ajo nuk kishte pësuar aksident në udhëtimin sipas telegramit të gënjeshtërt, siç pati thënë ndihmës mjeke Zdravka. Së dyti, paçka se nuk kisha asnjë lloj argumenti për t'i besuar, ushqeja një bindje fikse se ajo ishte shpirt njeriu dhe se mua më kishte për zemër.

Ndërsa monometristi shëtiste aparatën në çdo qoshe të dhomës, Meleviçi zgërdhihej me cinizëm dhe në mënyrë të hapur shpotitëse. Unë thirra i nervozuar:

— Provojeni birucën ku më kishin vërvitur kohë më parë!

Mirëpo këlthitja ime aq e vrazhdët në atë qetësi klinike u mor si shenj anormaliteti mendor dhe Meleviçi nuk e la t'i shpëtonte rasti nga dora, tha:

— Megjithëse përmirësimet janë të dukshme, tek-tuk i shfaqen simptomat e lëngatës...

U zemërova edhe më keq, ia ktheva pa u përmbajtur:

— Çfarë simptomash, mor lugat! A nuk më krodhët në birucën plot tartabiqë e lakuriqë nate.

Shumica e mantelebardhëve vunë duart mbi buzë për të penguar të qeshurën. Meleviçi me një përzemërsi që nuk i shkonte për shtati natyrës së tij prej prepotenti, më tha:

— Po ku gjenden biruca të tilla mikrozoologjike në spitalin tonë, mor i dashur?! — pastaj iu kthye njeriut të gjatë me tëmtha të thinjura: — Druzhe Gurgureviç, mos ia shihni për të madhe pacientit, ende jeton nën presionin e psiko polisindromës. Një element prezent në këtë sëmundje është edhe halucinacioni i shoqëruar me ndijime dhe përfytyrime të rreme...

Ndërhyri një fytyrëgjërë me faqe si brumë i ardhur, i ngjashëm me Meleviçin sikur të ishin binjakë:

— Ne i vizituam të gjitha mjediset e pavionit, nuk pamë asnjë kthinë, jo më birucë me kafshëza të përrallave! — më tha mua, pastaj ngriti supet duke hapur duart përballë burrit të gjatë me tëmtha të thinjura, vijoi si me vete:

Na shqetësuan deri në Beograd. Erdhëm të merakosur, kurse ky na përrallis pafajësisht, sepse është i sëmurë si të gjithë ata që vuajnë këtë sëmundje... Mbasandaj i hodhi një vështrim dashakeqës dhe përbuzës doktorëshë Jadranskës.

Më vinte ta haja veten me dhëmbë, mbasi me nxehtjen time i dhashë pandehmën komisionit mjekësor (për të tillë e mora atë grigjë mantelebardhësh) se vërtet isha i çmendur. Atë moment burri i gjatë me tëmtha të thinjura u shkëput prej të tjerëve. Ndonëse Meleviçi dhe burri fytyrëgjërë me faqe si brumë i ardhur deshën ta pengonin duke mërmëritur për mua «agresor i rrezikshëm»; Gurgureviçi m'u afrua dhe ma zgjati dorën:

— Si je Major Bumja? Nuk po më njuh?!  
E vështrova ngultas dhe mendova: «Pallavra udbashësh...»

Ndërhyri psikoterapiste Jadranka:

— Thirri kujtesës, Emrush, me shokun Gurgureviç ju lidh një ngjarje që nuk harrohet kurrë!

E vështrova përsëdyti, vura re një nishan në qosh të ballit një gropëz sa një gjysmë lajthie me ngjyrë vishnje. Vërtet në jetën partizane unë me njësitin tim special për aksione të jashtëzakonshme kisha ndërhyrë në shumë raste kur jetën e ndante një fije peri nga vdekja, por ai i Gurgureviçit më kishte mbetur si gozhdë në tru. Vetëm se ishte puthur me një shoqe të luftës, gjyqi i brigadës partizane

serbe e kishte dënuar me pushkatim. Vajza erdhi e më njoftoi duke dënesur: «Megjithëse u betova se Gurgureviçin e putha unë, ata e akuzojnë për përdhunim! A e merrni me mend shkakun? Komandanti i brigadës më do për vete...» Pa marrë ndonjë urdhër dhe pa pyetur njeri, u vërsula me batalionin tim. Rrethuam skuadrën e ekzekutimit. Kur i çarmatosëm, komandanti i brigadës shtiu me pestoletë dhe e plagosi Gurgureviçin. Tek gjendesha i përhumbur në ato kujtime, Gurgureviçi më tha:

— Gjatë luftës mendoja: Nëse kishte një dekorim të lartë për pamposhtësi, i pari do ta meritoje ti, Emrush Vushtrija. Nuk e besoja se mund të katandiseshe në këtë gjendje.

— Nganjëherë natyra u treguaka aq dorëlëshuar, kur u dhuron kaq shumë poshtërsi disave, sa nuk ditkan si ta harxhojnë atë... — thashë unë.

— Nuk po ju kuptoj, — tha Gurgureviçi.

— Mos ju dënoftë shorti si mua, se atëherë do ta kuptoni, por do të jetë vonë. Mbasi edhe kur ia hapni zemrën një shoku apo miku, si në rastin tim, ai do të t'ju marrë për të lajthitur.

— Prapë s'po ju kuptoj, — tha Gurgureviçi.

— Ju mund të mos e kuptoni as major Brankon, atë që jua la nishanin e përjetshëm në qoshkun e ballit... Kam dëgjuar se mban gradën e gjeneralit dhe është martuar me Sllavicën, për sebebin e së cilës deshën të të pushkatonin. — thashë. Gurgureviçi u nxi në fytyrë, unë e pyeta: — Ku punonin tashti, druzhe Gurgureviç?

— Në Kabinetin e Mareshalit, — gjegji ai dhe përnjëherësh u kthye nga të tjerët: — Na lini vetëm, ju lutem.

— Kurrsesi! — ia pati profesor Meleviçi, — ne jemi përgjegjës për jetën tuaj. Mos u gënjeni nga fjalët e të sëmurit. Ai ka raste kur kthjellohet, por pas pak minutash i hipin të vetat dhe kthehet në përbindësh. Shumë veta nga personeli im lëngojnë ende nga rrahjet që u ka bërë i sëmuri 339/1. Ju lutem, më ndjeni, por unë si profesor i kësaj klinike, qeveris me autoritet absolut këtu.

— Ju thashë të dilni të gjithë jashtë! — tha Gurgureviçi.

— Pa autorizim të posaçëm nuk lëviz këmbën këndeje, — tha Meleviçi.

Gurgureviçi nxori dokumentin, ia zgjati tjetrit duke i thënë:

— Do autorizim nga organe më të larta se marshalata?!

— Të më falni, por unë varem nga Ministria e Brendshme e Republikës së Sërbisë, — tha Meleviçi.

— Çfarë, çfarë?! — ia bëri Gurgureviçi.

Unë brofa nga shtrati dhe thirra si i çartur:

— Përjashta! Të gjithë, përveç Gurgureviçit dhe doktorëshë Jadrankës, përjashta!

Se isha mbërthyer nga një zjarr i brendshëm, e ndieja, se isha gati të kacafytesha me çdo lukuni keqbërësisë, e kuptoja nga tendosja e muskujve dhe rrahja e tëmthave. Por nuk merrja vesh nga më erdhi tërë ajo forcë kur më kishin lënë pa ngrënë kushedi sa ditë. Nuk mund ta merrja me mend gjithashtu ç'efekt bëri tek mantelbardhët shpërthimi im vrundullues. Fytyrëgjëri me faqe si brumë i ardhur kishte futur dorën midis shalëve sikur mezi mbante ujët e hollë. Profesor Meleviçi, i strukur mbrapa dy sanitaroboksierëve, i shtynte ata drejt meje. Ca të tjerë zmbropseshin drejt portës. Doktorëshë Jadrankës, paçka se e zevrdhur, sytë i qeshnin, doemos nga strukja aq qesharake e Meleviçit. Gurgureviçi sikur të ishte ngurosor, pipthi në këmbë, njëren dorë e mbante në xhep, dorën tjetër e kishte shtrirë drejt derës, sikur t'i urdhëronte të tjerët të dilnin përjashta sa më me ngut.

Dy sanitaroboksierët, të cilët i ndukte nga mbrapa shpinës Meleviçi, u çapitën drejt meje. Mbërtheva komodinën metalike, e ngrita pezull duke sokëllirë shqip:

— Përjashta, rezila! Përjashta sahanlëpirës!

Të dy sanitaroboksierët u kthyen mbrapësht me vërtik dhe, duke marrë nëpër këmbë profesor Meleviçin, përburuan midis të tjerëve, dolën në koridor vrapthi. Pas tyre Meleviçi i gërmuqur dhe gjithë të tjerët, ikën në rrëmujë. Doktorëshë Jadranka desh të mbyllte derën.

— Jo, — i tha Gurgureviçi, — duhet të thërresim drejtorin e përgjithshëm të spitalit, profesor Abrahamin. Në praninë e tij ta sqarojmë çështjen...

— Shkoj e thërres unë, — tha doktorëshë Jadranka.

— Jo, më mirë shkoj vetë, — tha Gurgureviçi dhe doli nga dhoma.

Doktorëshë, në mëdyshje ta mbyllte, apo ta linte hapakrah portën, më foli me buzëqeshje të frenuar:

— Lëshoje përdhe atë komodinë! Mos ke ndër mend të më godasësh edhe mua?!

Unë mbeta si gdhë me komodinën e ngritur mbi kokë. Sakaq, asaj ia përshkoi fytyrën një hije trishtimi. E mora me mend: në e pastë pasur edhe një grimë bindje se mua më kanë fërfëlluar në spital pa qenë i sëmurë, tashti humbte shpresat; E lëshova mengadalë komodinën në vendin e vet, duke mërmëritur disi i turpëruar;

— Më ndjeni zonjushë, më kanë nëpërkëmbur, ma kanë kallur tmerrin...

— Qysh kur iu paska shkrepur kandidatit për hero të luftës partizane ta quajë një bijë luftëtari zonjushë?! — pyeti doktoresha dhe zbehja në faqe iu kthye në all.

— Qysh atëherë kur të ashtuquajturit shokë sillen si inkuizitorë, — gjegja unë duke mbledhur mendjen të mos i krijoja pandehma të tjera, përveç atij që isha.

— Besoj do të rregullohet gjithçka... — tha Jadranka me buzgaz.

Fjala «besoj» m'i cingirisi nervat, por e përmbajta veten;

— Të besosh kotnasikoti, është si puna e fabulës së gomarit, të cilit ia kishte shqyer prapanicat ujku e ai thoshte: «Dhëntë zoti, jam ëndërr!»

Ndërkaq mbërriti Gurgureviçi bashkë me drejtorin e përgjithshëm të spitalit psikiatrik të Nishit. Këtë të fundit e shikova në dritë të syrit. Ai gremisi vështrimin përdhe. Ndoshta habitej për këmbët e mia aq të mëdha, ose pyeste veten ç'numër këpucësh mund t'i bëjnë këtij zdupi?!

«Gjendje të rëndë jetojnë të gjithë, secili lutet: Ruaj, zot, bythën time!» — mendova me vete.

— Profesor Abraham, Emrush Vushtrinë e kam mik të hershëm... — tha Gurgureviçi.

Mua nuk më pëlqeu fare ajo hyrje në bisedë: «Zagar si gjithë të tjerët edhe ky» — mendova me vete. — ndryshe nuk do të punonte në Marshalatë, kur shokët i dergjen burgjeve...»

— Të mos kishte ardhur doktoreshë Jadranka të më njoftonte në Kabinetin e Mareshalit, kushedi ç'do t'i ngjiste këtij luftëtari që i dha aq shumë luftës sonë, — vazhdoi Gurgureviçi.

«Sillogane hipokrite! — thashë me vete.



— Edhe përmbysja e bindjeve është sëmundje... —  
tha profesor Abrahami...

— Jo për psikiatri, por për komitetin e PKJ-ës, — ia  
priti Gurgureviçi.

— Shkresën e mjekëve ligjorë të Prizrenit e shikuat?  
— pyeti drejtori i përgjithshëm i spitalit psikiatrik të Ni-  
shit, — me diagnozë të përcaktuar na e kanë dërguar, ma-  
dje me pesë firma. Tashti gjendemi në procesin e ekzami-  
nimit. Për këtë kam ngarkuar psikoanaliste Jadrankën.

— Ekzaminimi parashikon biruca me tartabiqë dhe  
lakuriqë nate të tërbuar? — pyeta unë dhe kafshova gju-  
hën përse shqiptova «të tërbuar».

— Shumë urdhëra e udhëzime vijnë nga lart me kom-  
petenca të padiskutueshme, — tha profesor Abrahami, pa-  
staj shtoi si nëpër buzë: — Nganjëherë ajo që mund të  
dijë kapteri, është e ndaluar për majorin...

— I lejohet një psikiatrie të tillë të ketë biruca me gja-  
llesa molepsëse?! — pyeti Gurgureviçi i thartuar nga përg-  
jigjja e drejtorit.

— Kthina izolimi me të gjitha kushtet klinike që le-  
jon një spital i këtillë janë në funksion të gjendjes, shërimit  
të të sëmurit dhe të personelit mjekësor. Sa për biruca që  
përmendët, unë nuk di gjë. Pyetni Meleviçin. Ai është drej-  
tor special i klinikës së polisindromës, madje me vendim  
të posaçëm: me siglën «rreptësisht sekret» nga Ministria  
e Brendshme e Republikës së Sërbisë, — tha profesori  
dhe, siç m'u duk mua, i bezdisur nga vetja që u zgjat për  
gjëra që duhej t'i dinte nëpunësi i lartë i marshalatës.

— Ç'punë ka me spitalin Ministria e Punëve të Brend-  
shme?! — pyeti i nxehur Gurgureviçi.

Profesor Abrahami u bë grusht nga ajo shprehje që  
kanoste cilindo që e shqiptonte, edhe ata që e dëgjonin dhe  
nuk denonconin. Jadrankës i qeshi fytyra. Unë mendova  
dy gjëra njëherësh: Gurgureviçi do të jetë i plotfuqishëm  
përtej çdo caku për kohën, ose provokon, mbasi ai veprim  
kishte fituar të drejtën morale në sistemin ekzistues. Gur-  
gureviçi, duket e kuptoi që shkeli në kufijtë e një tabuje  
të pacënuar, shtoi në vijim:

— Për të burgosurit e sëmurë ka spitale të posaçme.  
Nuk besoj se ka ndonjë dokument të argumentuar se Em-  
rushin e kanë sjellë këtu prej burgu. Ky, me sa e di mirë-  
filli, ka shërbyer edhe si përkthyes midis mareshalit dhe kë-

shilltarit ushtarak britanik, birit të Çurçillit gjatë luftës...

Profesor Abrahami më vështroi gapërr, sikur përherë të parë piquej me mua. Ajo gjendje e hutuar e tij më kujtoi thënien: Asgjë nuk ia rrit vlerat një intelektual, sa lavdërimi i një njeriu me pushtet...

Profesori bërbeliti si me vete:

— Një tru intelektual jokrijues, në çdo qëllim është shërbëtor më i mirë i ambicies, se sa i dijeve që ka grumbulluar mekanikisht...

Atë thumb e mora për vete, ndaj nuk m'u durua pa i dhënë përgjigje:

— Ata që prodhojnë helme me tepri, jo rrallë mbyten vetë në 'to.

— Profesori nuk e pati me ty, — ma ktheu doktoreshë Jadranka, — atë shprehje latine e përdorë sa herë ndëshet me kryengjeshësinë e profesor Meleviçit.

Më erdhi të mjaullija si maçoku kur kafshon bishtin e vet që e ka pandehur për mi.

— Mora vesh shumëçka, — i tha Gurgureviçi, profesor Abrahamit dhe vijoi, — Ç'mund të bëni ju, si drejtor i përgjithshëm për Emrush Vushtrinë?

— Pas ekzaminimit të saktë e të shpejtë, e nisim për në vendlindje, — tha profesori, dhe si u mendua, shtoi: — Veçse ndihma juaj na duhet në çdo rast.

— Në ç'drejtim mend t'ju ndihmoj? — pyeti Gurgureviçi.

— Jua thashë, kjo klinikë varet prej Meleviçit.

— Mirë, — tha Gurgureviçi, — që sot Emrush Vushtrinë ta hiqni nga ky mjedis vetmitar!

— Kam edhe dy shokë në këtë spital, — thashë unë.

— Ata i pamë, as keq nuk janë, as ankesa nuk kanë, — tha doktoreshë Jadranka, dhe, pasi më ra lehtë-lehtë supeve, shtoi: — Gjynah, ky kolos të vuajë pa hak e pa shkak...

— Mëshira mund të ketë gjithçka brenda, neveria nuk i mungon kurrë, — thashë.

Jadranka më vështroi me sy të lëngëzuar. Unë u pendova për pamaturinë time. Gurgureviçi tha:

— Doktoreshë Jadranka nuk bën asgjë për mëshirë. Kjo i përgjigjët zemrës së vet fisnike e guximtare. Kur të tjerët mendonin se gjendej në Pula, kjo erdhi dhe grushtoi

tavolinat e Marshalatës për të të mbrojtur dhe për të çuar në vend drejtësinë njerëzore.

Doktoreshë Jadranka zgjati dorën, gjasmë të ma ulte mëngën e pizhamave paksa të përvjelur, ma mikloi dhe pickoi lehtë llërën. Gurgureviçi ngriti grilat e dritares, vështrroi përmes hekurave të kryqëzuara, pastaj me ata sytë e kaltër me një shkëlqim të kulluar vërejti çdo qoshk të dhomës. Pasi vëzhgoi edhe nën krevat, u kthye nga drejtori dhe pyeti:

- Keni ndonjë dhomë të posaçme për të biseduar?
- Vemi në zyrën time, — tha profesori.
- Jo. Dua të bisedoj sy ndër sy me Emrush Vushtrinë.

— Sigurisht që ka, — gjegji profesor Abrahami dhe na udhëhoqi në një zyrë të vogël pranë zyrës së vet.

Si mbetëm vetëm për vetëm, Gurgureviçi, i menduar, duke më zhbhiruar, nxori paketën, ma zgjati një cigare. Mbasi i thashë se nuk e pija, ai e ndezi për vete, nxori dy-tri shtëllunga prej buzëve të rrumbullakosura, treti vështrimin përmes rrathëve të tymit të cigares, tha:

— Mund të vinte ndonjë tjetër nga Marshalata. Unë ngula këmbë dhe erdha në krye të komisionit. Mirë bëra. Veç të tjerave, këtu mora vesh se ky spital iu nënshtroka urdhërave të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, duke qitur në mospërfillje Ministrinë e Shëndetësisë po se po, por edhe organin më të lartë federativ, siç është Kabineti i Mareshalit. Këto do t'ia raportoj pa ndërmjetësi druzhe Titos. Siç ma ke shpëtuar jetën, e ke për detyrë edhe të më dëgjosh. Bindju fjalës së urtë «Ndodh që e duam dhe e mbrojmë një-njeri për të mirat që ia kemi bërë...» Fundja unë nuk gjej rrugë tjetër, as e përfytyroj ndonjë rast kësaj për të ta shpërblyer të mirën që më ke bërë. Nuk di nëse e ke marrë vesh e, në qoftë se jo, po ta them: në prag të fitores ishe propozuar për t'u shpallur Hero i Luftës Nacionalçlirimtare, mbasi përveç kreshnikërive të panumërta, në sajë të ndërhyrjes tënde me batalionin special u ça rrethimi nazisto-drazhist në Betejën e Sutjeskës dhe Josip Broz Tito shpëtoi vetëm me një plagë në krah. E kam me vete kopjen e propozimit për dekoratën. Ajo u pezullua me shënimin «të verifikohet çështja!», sepse pas Plebishitit të Prizrenit, ti shkule spaletat e ma-

jorit, i shkëlqimave me këmbë duke thënë: «Ë gënjeshtërt lufta dhe premtimet e saj. Drazhistë Sërbia! Kurvë qeveria federative! Mashtrues mareshal Tito...» E di unë, e kanë të qartë të gjithë ata që njohin figurën tënde se je i rrëmbyeshem. Të tilla temperamente nuk mund të vlerësohen drejt në rastet e shpërthimit të papërmbajtshëm... Shkurt fjala, ty të jepet grada e kolonelit me një përsheptim jashtë kriterëve për t'u graduar gjeneral. Dhe të të rikthehen të gjitha atributet me një kusht të vetëm: Të bësh një vetëqortim në shtyp për rastin që përmenda dhe të japësh fjalën se do të shërbesh me besnikëri si edhe gjatë luftës.

— Kujt t'i shërbej? — mezi e nxora atë pyetje ngaqë po më zirej fryma. E ndieja veten aq të fyer e të poshtëruar nga ajo diplomaci e trashë prej njerit nga ata që ia kisha shpëtuar jetën.

— T'i shërbesh Shtatmadhorisë së Ushtrisë Federative dhe kryekomandantit të saj Josip Broz Titos, i cili më ka pajisur me atuje të posaçme për ty.

— Askush nuk duhet të harrojë ç'borxhe i kemi vetes. Në çdo moshë i japim hesap dikuj, mbi të gjitha ndërjegjësonë. Nuk i kam bërë keq kurrkujt, prandaj nuk ka të drejtë askush të më fyejë e poshtërojë. Unë, oficer, me dy akademi të kryera, iu përgjigja thirrjes së Partisë Komuniste, sepse në programin e saj, pas përfundimit me fitore të luftës, thuhej se do të merrnin fund padrejtësitë që u ishin bërë popujve nga klanet dhe regjimet antipopullore. Por në të ashtuquajturin Plebishit të Prizrenit, ngrehina ku ishin mbledhur përfaqësuesit shqiptarë ishte qerthulluar nga sigurimi serb, i cili deri në atë ditë kishte vrarë, masakruar dhe zhdukur mbi 70 mijë shqiptarë. Dhe kush u shpreh atje që Kosova të bashkohej me atdheun e përgjysmuar, Shqipërinë, u kap u zhduk, ose u mbajt në mjedise terrori deri sa u përpunua. Unë nuk luftova për grada, as për tituj, por se i shërbeja aspiratave të popullit tim, duke ia dashur të mirën dhe mbarësinë si fqinjëve ashtu edhe të gjithë popujve të tjerë.

— Jemi vend socialist. Ky sistem nuk njeh pushtim të një populli nga një tjetër. Nesër, e largëta pasnesër, vendet e Ballkanit do të bashkohen në një federatë shtetesh. Për kohën që fole, ti e di më mirë se askush, bashkimi i Kosovës me Shqipërinë nuk mund të bëhej mbasi ki-

shim dalë të shkatërruar nga lufta, Shqipëria e varfër nuk mund ta mëkëmbëte Kosovën e prapambetur. Së dyti reaksioni serb ishte i fuqishëm. Ai e kishte ushqyer popullin e vet me të qena e edhe të paqena historike mbi përkatësinë e Kosovës. Tashti që ndihet një lëvizje e nëndheshme për një Ballkan të të gjithë ballkanasve me kufinj simbolik midis shteteve, këmbëngulja jote mbetet një vuajtje pa shkak... tha Gurgureviçi.

— Më çoni në kthinën time! — thashë dhe u nisa drejt portës.

— Shoku Emrush, prisni. Kam ardhur të sqaroj keqkuptimet rreth personit tëpd...

— Kur virtyti shartohet me vesin, pjell bastardë. Me hibrid si ti nuk dua të bisedoj, — zgjodha fjalët unë, mbasi qëllimi i vetëm në atë rast ishte të mos më merrnin për të sëmurë psikik, ishte njolla më poshtëruese e dinjitetit që mos i rëntë kujt ta jetojë. Hapa portën. Tek po i avitesha kthinës sime, u dëgjuan hapat e ngutura të doktoreshë Jadrankës. Ajo më mbërtheu përkrahu dhe duke ecur krah meje, më pyeti:

— Të kujtohet se ditët e para në këtë spital më ke premtuar të më qerasësh me një limonadë kur të dalësh këndej? Gurgureviçi po shkruan urdhërin që të të lirojnë nga spitali. Një javë do të qëndrosh në banesën time. Nuk është fort larg prej spitalit. A do ta mbash fjalën që më ke dhënë?

U shkëputa prej saj, hyra në dhomë duke përplasur derën me forcë. Atë çast u dëgjuan shumë hapa burrash në korridor. Çelësi u rrotullua nga jashtë në bravë. Ç'bëni? pyeti Jadranka atë që kyçi derën. Ky nuk është i sëmurë dosido. Është më i rrezikshëm se çdo i çmendur! Iu përgjigj një zë burri, i ngjashëm me timbrin e fytyrëgjërit me faqe si brumi i ardhur...

## NË KUVLINË PREJ XHAMI

*Disa na kanë borxh aq gjak, sa na kanë shkaktuar lotë e brenga ndër vite e dhjetëvjeçarë.*

**E** pas tri ditëve të vizitës së Gurgureviçit nga Marshalata, më dërguan në një dhomë të vogël si kuvli. Tre muret e saj, ngjitur me pavionin e grave, përbeheshin prej xhamllëku të trashë por të tejdukshëm. Ndodhëse rrethoja dukej e mbyllur hermetikisht, zërat që vinin nga rrëmeti i të çmendurave dëgjohej kaq thekshëm sa të shurdhonte. Bezia shndërrohej në stërshqetësim, sepse të lëvizje edhe gishtin e vogël, dukej nga pavioni i grave. Nuk kishe nga të përplasje vështrimin, mbasi, ngado që të rrotulloheshe, t'i vrisnin sytë lëvizjet e të çmendurave dhe kacafytjet e grave. Siç m'u duk mua dhe këtë e vërtetova edhe më vonë, ardhja e një mashkulli në atë kuvli prej xhami trazoi në kulm marrëzinë e të sëmurave. Dy-tri syresh më dërgonin të puthura nga përtej xhamllëkut. Të tjera më kanoseshin me grushta. Të tretat, orvateshin t'i grisnin teshat e trupit për të më treguar pjesët më të turpshme. E ndieja veten të nëpërkëmbur përtej çdo mase. Më

e pakapërdishme ishte pështirosja deri në neveri që po më zgjohej për seksin e adhurueshëm. Tek shikoje ato krijesa me grimasa të paskrupullta, të çapëluara në tërë lakuriqësinë banale, të vinte turp të mendoje se ishte pjellë e një femre.

Në fillim u pajtova me mendimin se do të më mësoheshin sytë, kurse veshët i mbylla me shuka pambuku që gjeta në komodinë. Desha t'i kërkoja tableta gjumi doktorëshë Jadranskës poqese vinte për të më vizituar. Por ndërrova mendje, sepse e kisha humbur besimin edhe tek ajo. Ia lëshova frerët në dorë zemërimit me shpresën e vetme: Duke u inatosur, stimuloj urrejtjen kundrejt atyre që po përpiqeshin të më çmendnin. Duke urryer të këqinjtë, kalis vullnetin për durim.

Ca sanitare, që nuk i kisha parë më parë, më sollën ushqim të bollshëm si asnjëherë tjetër. Ato më buzëqeshën në një mënyrë të çuditshme. Mua m'u bë sikur më thoshin: «Ha, o damaz, se gjendesh në haremin më të përçudnuar në botë!»

Për ta ndezur edhe më tej inatosjen, solla nëpër mend drejtorin e psikopolisndromës, Meleviçin. Dhe sa nuk thirra me zë të lartë: Do t'ju pëlcas duke duruar çdo provë që do të bëni me mua!... Fjalët e fundit më kujtuan qentë e Pavllovit. Edhe më keq m'u ndez damari i urrejtjes. Ndërkohë u larguan sanitaret që më sollën ushqimin. Pyeta veten: Ç'kërkoni dhjetë sanitare të reja, për një pjatë gjellë që më sollën?! Duke ngrënë përballë xhamllëkut të tejdukshëm, vura re se një pjesë e femrave qëndronin në fund të asaj dhome me madhësinë e ndonjë salle. Ato, të nemitura dhe me fytyra të ngërçura nga pështirosja, shikonin shoqet e tyre që ishin vërsulur në murin prej xhami që i ndante me kuvlinë time. Sakaq bëri ballë njera prej të çmendurave me mantil të bardhë, filloi t'i qëllonte e t'i rrahte pikërisht ato që rrinin urtë. Në fillim pashë vetëm shpinën e torturueses. Kur filloi të godiste me shqetëma një vajzë që, siç m'u duk, nuk i kishte kapërcyer të shtatëmbëdhjetat, ia dallova açik fytyrën dhe shtanga me kafshatë në gojë. Ishte Zdravka. Ndihmësmjekja për të cilën më kishte thënë Balashja se ishte oficere e policisë së fshehtë e që pata flirtuar me të gati-gati në rrethana të detyrueshme. Fytyra aq e ëmbël gjatë epsheve dashurorë, tashti i ishte kthyer në një shembëlltyrë përbindshi. Buzët,

prej të cilave kishte derdhur afsh të përdezur dhe joshës, tashiti i ishin ngurosur në një çkërmitje sadisteje. Dikur, Zdravka la përdhe e të gjakosur viktimën shtatëmbëdhjetëvjeçare, hovi drejt xhamllëkut. Mblodhi gishtat grusht duke e lënë të gjatin të ngrirë në një nojmë që përbën sharrje. Atë gisht filloi ta trokiste në xhamllëkun kundruall meje. Një pjesë e mirë e femrave ndoqën shembullin e Zdravkës. Ec e thuaj pastaj se këto maskaresha janë të sëmura psikike! — thashë me vete. Zdravka më shau: Jebemti shiftarsku majku! U pasua në kor nga të tjerat. Mbasandaj duke cokatur në xham thirri: «Mbi ty, që ua more erzin shumë vajzave e grave e që të zuri ahti i tyre, do të bië hakmarrja e ne femrave! Do të ta shkulim atë katana që mban midis shalëve! Do të përdhunojmë, mbasandaj do të tredhim!...» Ato fjalë, sikur të ishin barut në zjarr, e ndezën aq keq rremetin e femrave që qëndronin puq xhamllëkut, sa, po të kishin ndonjë mjet metalik, do ta shkërmognin murin e xhamtë.

Ndërkohë u hap porta e pavionit të grave, hyri Meleviçi i pasuar nga një duzinë femrash me mantela të bardhë. U thirri të sëmurave të eksituara: «Ç'djall ju paska trazuar kështu?!...» Fill pas kësaj u shpjegoi diçka mantelebardhave duke shoqëruar fjalët me gjeste fodulli. Ndërkohë u dëgjua një klithmë nga turma e të çmendurave. «Duan të tridhet banditi shiftar i kuvlisë!» Doktor Meleviçi qeshi me shpirt dhe, si nxori një shami, pastroi gojën, bërtiti: «Dua qetësi! Ju kam thënë njëqind herë se ju pret ndëshkim i rëndë për çdo shkelje të rregullave të spitalit!» Dhe iku duke u gajasur. Mendova: «Nuk duhet të jetë aq idiot sa e pandeha në takimet e para...» Dhe falë vullnetit tim, arrita ta qitja në harresë me përdhunë mjedisin ku gjendesha. U hodha në gjirin e atyre kujtimeve që përbënin çaste të lumtura. Grave matanë xhamllëkut, meqë nuk pò reagoja ndaj grimasave e fytyrëve të tyre, iu squll zelli e iu ngjirën zërat. U tërhoqën në mesin e dhomës së tyre. Mua po më përkundçte gjumi i shenjtëruar. Tek-tuk dëgjohet ndonjë zë i veçuar si kuitje: «Rroftë Tito! Poshtë Rankoviçi!» Një tjetër zë më i lartë se i pari iu kundërvu: «Unë jam kraliça e Sërbisë. Brohorisni sipas meje: Poshtë Tito, rroftë Rankoviçi, shpirti i lavdisë jugoserbe!» Unë u krodhja në prehërin e ëndrrave të magjishme. Në mbrëmje vonë erdhi e më zgjoi ndihmësmjekja Balashe. Qysh kur kishte



vajtur me pushime në bregdet, nuk e kisha parë. Nxirja nga rrezet e diellit i kishte blatur një hijeshi magjepsëse. Tëk po përshëndeteshim u tërbua zallahia në pavionin e grave. Dhjetëra fytyra iu qepën katrorëve të xhamllëkut. Balashia bëri sikur do të më jepte një injeksion dhe më pëshpëriti: «Psikoterapiste Jadranka të bën të fala. Ajo, sapo të gjejë rastin, do të vijë të të vizitojë...»

— Këtu? — pyeta unë.

— Po. Ajo e ka rregulluar punën që ty të të ketë pacient të pandërmjetshëm. Prandaj të kanë prurë në këtë dhomëz...

— Jadranka më paska prurë në këtë ferr torturash?! — pyeta unë.

— Më mirë të të bezdisin lehjet e bushtrave, se sa të të kafshojnë qentë e Meleviçit, — gjegji Balashja.

Ai qëndrim i hapur kundër Meleviçit, i cili ishte i plotfuqishëm jo vetëm në psikiatri, por edhe në qytetin e madh të Nishit, m'u duk i dyshimtë. Për gjysmë fjale kundër të tillëve haje disa vjet burg. Prandaj ia ndërrova kahun bisedës:

— A gjetët ndonjë burrë në Plazhin e Ulqinit? — e pyeta.

— Për të kaluar pushimet mund të kisha gjetur, por nuk desha. Ne me origjinë kroate-italiane kemi shije të hollë. Vërtet jam seks, por nuk kam ndjenja të tepërta për t'i hedhur në baltë. Asisoji njeriu i shkakton vrraga vetes që të brengosin përjetë. — Balashja edhe nga zëri edhe nga shpengushmëria me të cilën i shprihte mendimet, u ngjante fëmijëve.

— Cili nga prindët tu ka origjinë italiane? — e pyeta.

— Paske harruar! Të pata thënë, Jadrankën e kam bijë tezeje. Mamaja ime dhe e saj janë italiane nga Dalmacia. Jemi rritur si dy motra. Por Jadranka është më e mirë se unë. — tha Balashja.

— Se është doktoreshë, apo?... e pyeta.

— Jo, si praktikë pune në spital unë kam pesë fishin e saj. Por unë jam më mendjelehtë, ajo është e thellë. Unë nis një punë me zell dhe e lë përgjysmë, kurse Jadranka çfarë synon, nuk i shqitet gjersa t'ia arrijë qëllimit.

Më shkrepri ta provokoja në një mënyrë tepër të trashë:

— A do të zemërohej Jadranka, të na shikonte kësisoj, duke folur gojë më gojë? — e pyeta.

— Jadranka është zemër njeriu. Shpesh herë, kur ndonjë djalë i është bërë bezdi duke iu vardisur; qoftë edhe bukurosh, ma ka kaluar mua. Ajo s'ka mend për qejfe. I është kushtuar psikoterapisë si piloti hapësirave qiellore.

Sakaq, matanë xhamllëkut, të çmendurat ia dhanë të klithurave uluritëse.

— Mos u shqetëso! — më tha Balashja, — janë të sëmuret nga histeria. Mallkuar qoftë lufta që i kullufiti djemtë e burrat. Ky edhe është shkaku që të sollën në këtë kuvli. Psikiatrët vëzhgojnë reagimet e secilës përballë një mashkulli dhe mbushin defterët me konstatime, — tha Balashja dhe filloi të ma mbështjellë ballin me fasho.

— Ç'po bën?! — pyeta unë i habitur.

— T'u japim pandehmën se je i plagosur e i pamundur dhe se nuk bëjmë dashuri; t'i qetësojmë shpirtërat e mëlcuar, — giegji Balashja dhe si zuri me trup pamjen nga ana e xhamllëkut më dha një puthje të përvëluar, duke thënë: — për këtë nuk duhet të dijë Jadranka.

— Ti the se Jadranka nuk çan kryet për të tilla...

— I pe sa femra ta prunë drekën? Po të kishin mundësi dhe t'i lejonin, do të vizitonte tërë personeli femër. Ti si bukurosh u zgjon kurreshtje, si mashkull ua ngin nepsin... — tha Balashja.

— Të pyeta për Jadrankën, — e ndërpreva unë.

— Për ty ka një interesim të vecantë. U desh të vije ti për ta zgjuar nga gjumi letargjik i beqares. Më në fund edhe Jadrankën po e zë fruthi i dashurisë, — tha Balashja dhe u ul në cep të krevatit. E bërë all në fytyrë, shtoi: — buzët të përvëluakan.

«Lele! Lele! — u dëgjua një klithje e thekshme përtej xhamllëkut.

Unë dhe Balashja vështruam andej. Një vajzë apo nuse e kishte nxjerrë sisen sa një ftua, e fërkonte mbi xham dhe thërriste me zërin e pshor: Lele! Lele! Lele!

— E quajnë Mileva! Studente në mjekësi. Kishte rënë në dashuri dhe ishte fejuar me një oficer të UDB-ës Qendrore. Mirëpo babai i Milevës u arrestua për propagandë kundër partisë. I fejuari e la mbasi parimi i luftës së klasave nuk lejon bashkëjetesën me bijat e atyre që dënohen. Ajo u çmend. Mbante në bark kërthinë e udbashit. Në këtë spital, me urdhër nga lart, i bënë abortin. Tashti vuan nga një histeri e rrallë. Shiko atë tjetrën që po derdh

lotë: Ajo, pra, në të djathtë të Milevës. E ka përdhunuar një titullar i lartë në Beograd. Ajo ngriti padi. Kur po shkonte në gjyq, e kapin në rrugë, e kredhin në një automobil, e prunë në këtë spital me fletë-shtrimin të firmosur nga tre psikiatër që mbajnë nga dy tituj përpara emrit.

— Dhe? — e pyeta.

— Këtu u çmend pas trajtimit «kurues» që i bëri Meleviçi. Tashti vetëm qan. Për një kohë nuk fuste gjësendi në gojë. E mbanim gjallë me serume tinëz drejtorisë së psikopolisindromës. Tashti ha, por ç'e do! Ka derdhur lumenj lotësh. Regjimi na ka borxh aq gjak, sa na ka shkaktuar lotë e brenga.

Duke mos harruar se asisoji ishte sjellë me mua edhe Zdravka dhe se tashti më shau me nënë dhe ngriti rrëmëtin e grave kundër meje, nuk mund ta merrja as Balashen për tjetër. veç si një provokatore të rëndomtë. E vështrova në dritë të syrit, pastaj e pyeta:

— Cfarë gjaku të ka borxh regjimi ty?!

— Babain dhe nënën m'i kanë vrarë. Mua më ka rritur te zja ime, nëna e Jadrankës, — gjegji Balashja, pastaj vijoi: — Ndoshta për këtë se bep babai i Jadrankës shërben sa më larg Kninit ku më njohin milicët...

«Të jetë kaq e djallëzuar kjo femër, që sillet si fëmijë, ndonëse 27-28 vjeç? — mendova me yete. — Nëse vërtet i janë vrarë prindërit, përse ma tregon këtë ngjarje pa më njohur, për ma tepër kur e di mirëfilli se unë kam drejtuar njësi speciale kundër pushtuesit dhe veglave të tij?! Përse Jadranka nuk më ka thënë se e ka bijë te zja Balashen. madje nuk ma ka zënë në gojë? As emrin nuk ia di. E thërres Balashe ngaqë ka një tufë të bardhë majë koke...»

Balashja vuri re që ia vështrova tufën e bardhë, përshkoi gishtat nëpër flokë dhe foli me timbër ngashëryes:

— Jetoja te te zja në Pulë. Ditën që u çlirua Knini, vajta për të vizituar gjyshen nga ana e babait. Kur mbërrita, mësova se ajo kishte vdekur. Hyra në shtëpinë e shkretuar dhe gjysmë të djegur nga çetnikët. Atje më kapi patrulla partizane dhe më dërgoi te komandanti. Kurrë s'do të më shkonte ndër mend se pikërisht ai kishte masakruar prindët e mi, dikur si komandant i një njësie drazhistësh. Tashti si i plotfuqishëm i garnizonit partizan të Kninit. Meqë ia pashë yllin në ballë, i tregova e bija e kujt isha dhe

si m'i kishin vrarë drazhistët prindët. Ai u nxi. Unë pa-  
ndeha se u prish në fytyrë nga dhimsuria për prindët e  
mi. Komandanti urdhëroi të më futnin në një kthinë të  
komandantës. mbasi, tha ai, për këtë vajzë do të kërkoj  
disa të dhëna... Nga mesnata erdhi me thikë në dorë, u  
përpoq të më dhunonte anise nuk i kisha kapërcyer katër-  
mbëdhjetë vjetët e moshës. M'i përdrodi flokët e gjatë  
dhe, për të më bërë zap, ma futi kokën midis gjunjëve.  
Më nduku bishërisht atje... Unë e kafshova në kofshë dhe  
përbirova midis këmbëve të tij. Komandanti më gjuajti  
me diçka metalike dhe ma lëndoi këtë pjesë të kokës ku  
më vonë më mbinë flokë të bardha.

— Si shpëtove, nuk të ndoqi ai farë komandanti? —  
pyeta unë.

— Dola nga komandatura e përgjakur. Pa guxuar të  
nxirrja zë, turravrap ngarenda përmes ca rrugicave dredha  
dredha të Kninit, gjeta një çezmë, sepse më ishte tharë  
aq tepër goja e fyti sa nuk merrja dot frymë. Atje njo-  
ma gurmazin. Pranë çezmës më kishte rënë të fikët. Fat-  
mirësisht atje kishte ardhur për të mbushur ujë një plakë  
kroate dhe më kishte strehuar në banesën e vet. Në xhe-  
pin e brendshëm të xhakaventës kishte gjetur certifikatën  
(pa dokument nuk lëvizei atëherë). Atje gjendej edhe adre-  
sa e burrit të tezës në Pulë. Plaka kishte njoftuar. Erdhi  
tezja e më mori. Më shtruan në spitalin e Pulës. Pas një  
operacioni plastik, u shërova por mbeta me balushë.

— Ç'u bë me komandantin e brigadës serbe? — pyeta  
unë i turbulluar, ngaqë i besova, sepse nuk ma merrte me-  
ndja të ishte aq e zonja Balashja sa të sajonte një histori  
të tillë.

— Ku nuk e ka kërkuar burri i tezës, — gjegji Ba-  
lashja, — Vonë morëm vesh se ai shërbente me cilësinë e  
sekretarit të parë të ambasadës diku në vendet arabe. ma-  
dje me emër të ndryshuar. Ndërkohë në arkivin e Kninit  
u gjend gjoja një dokument që vërtetonte se nëna dhe  
babai im janë vrarë si terrorist antiserb... Edhe sot e gji-  
thë ditën vrasësi radhitet si njëri ndër diplomatët me do-  
biprurës për Jugosllavinë Socialiste.

— Unë të thërres Balashe shqip, — i thashë, — më  
trego si të quajnë që të mos ta ngacmoj dregëzën e një  
plage që s'mbyllet lehtë...

— Më quajnë Horvatkë, — gjegji ajo, — por mua më

pëlqen emri i ri që më ke vënë. Më thirr ashtu, të lutem! — dhe u ngrit, fiku dritën, u shtri në krevat buzë meje, filloi të qajë me dënesë. Më përqafonte duke më njomur me lotë.

Në atë përqaftim kishte edhe epsh. Si ka mundësi që pas një rikuitimi të një historie aq të dhimbshme t'i zgjohen edhe ndjenja të tjera kësaj?! Tek m'u njomën buzët me lotët e krinura të Balashes, porifrazova me vete fjalët e saj, të thëna pak më parë: Regjimi na ka borxh aq gjak, sa na ka shkaktuar lotë e brenga...» Këtë frazë do t'ia ketë mësuar dikush, thashë me vete. Dhe dyshimi, që në raste të veçanta është mbrojtësi më i mirë i njeriut, më shpoi si me bizë. Prej kuit mori leië Balashja që erdhi pa droje dhe qëndron me mua për kaq kohë? Kjo ka vuajtur, është masakruar dhe përndjekur. Nuk mund të jetë aq budallaqe sa të mos kuptojë se kjo kuvlia ime përgjohet nga të gjitha anët! Mos po më përgatitet ndonjë kurth? Po lotët? Ja e ndiej si rrjedhin lotët e saj mbi fytyrën time. Ua dalloj edhe shijen e kripur, edhe përvëlimin. Mos i lvejtj svtë me ilaç lotëndiellës gjatë kohës që mbylli celësin elektrik? Përse e fiku dritën?...

Atë çast trupi i Balashes rëndoi mbi timin. Më mbuloi me puthje të prushitura. Unë brofa nga krevati dhe u gëzova me veten, mbasi më parë nuk lejoja të më ikte rasti nga dora, jo nga natyra epshore, por nga një lloj mentaliteti, sipas të cilit mashkulli njollosej me epitetin si i paburrë kur i vardiset një femër e bukur, e pastër dhe dinjitoze dhe ai mëdyshëson në kontaktin me të.

— Të lutem! Të lutem, mos më privo nga kjo kënaqësi e ëndërruar! — përgjërohej Balashja me timbër të ngashëruar dhe duke m'u kacavarur si mace nëpër këmbë.

Atë çast u hap dera, shkreni celësi elektrik. Në dhomë bëri ballë dokoreshë Jadranka. Balashja shtangu e hutuar me buzët ngiitur në pulpat e këmbëve të mia. Kurse unë, me shpinën kthyer asaj dhe me hapin e zgjatur drejt portës.

— Nuk ke turp Horvatkë, kushërirë, më e afërtë se çdo motër, të ma punosh kështu! — ia pati Jadranka.

Balashja u shtri përmbys mbi dysheme. Përmes të dënesurave ligjëroi ngatërrueshëm: «Jam më e mjera e fatit tim, ... Ky mashkull më ndez ngasje, më ndjell tundim...»

Ky nuk deshi... Unë, unë, unë...» Pastaj këmbadoras iu afrua Jadrankës. Iu përqall nëpër këmbë. I fliste me zë të ulët e rënkimtar. Nuk e dëgjova, por duket i tha ndonjë fjalë që nuk mund ta kapërdinte lehtë dhe psikoterapistja i dha dy flakaresha. U kthye dhe iku si plumb pushke. Balashja vrapoi prapa saj duke lënë derën hapakrah. Mbeta në këmbë duke përbluar atë gjendje të koklavitur me trysni episodesh. Kur ktheva kryet nga pavioni i grave, vëreja se të gjitha ishin shtrirë në pozicione ndër më të ndryshmet... Megjithëse flinin, ajo pamje më kujtoi kësaphanën me bagëti të therura që janë shtangur të çapëluara ashtu siç i ka zënë agonia.

Kush drejtin i vuri në gjumë të gjitha përnjëherësh? pyeta veten. Mbasandaj mendova: U kanë dhënë qetësues me doza të forta. Po përse i kanë vënë në gjumë? Siç e mësova në netët e ardhshme, çdo natë u jepnin tableta gjumi ose injeksione. U shtriva në krevat. Provova të gjitha mënyrat e njohura për të joshur gjumin, por mbresat e asaj dite kishin lënë vrragë të thella. Qe e pamundur të mbyllja sy. Fika dritën. Iu avita xhamllëkut, fillova të kundroj femrat. Të rralla ishin ato që i kishin kapërcyer të dyzetat. Më pllakosi një gjendje ndjeshmërie e dhimsurie tronditëse. Vrisja mendjen e nuk gjeja përgjigje përse ajo moshë të prekej nga sëmundjet psikike. Mos vallë edhe për këto qenë një zhgënjim i madh shpresat që ushqyen për lumturinë e premtuar pas luftës, sa u solli të tilla trauma? Por ato nuk janë të gjitha të çmendura, thashë gati me zë. Këto të fundit duhet të jenë më fatkëqija se të çmendurat, mbasi e kuptojnë se jeta e tyre është e nëpërkëmbur. Të jetosh në çmendinë, nëse nuk sëmuresh, jeton të tilla strese, sa të mbetesh me huqe që mos të t'i shlyejë një jetë e tërë.

U shtriva në krevat me duart prapa kokës. Tok po grindesha me veten, me mjedisin jetues dhe me gjumin, u hap dera ngadalë dhe me kujdes të vecantë. Hyri psikoterapistja Jadranka. Mbylla sytë, bëra sikur flija fare i patravajë. Doktoresha m'u avit dhe, si ndonjë nënë e dhemshur, m'i mbuloi llërët me batanie. Pastaj ma preku ballin (sidotot provoi mos kisha temperaturë). Dikur u mat të kthehej mbrapsht. Ua kam lakmi aktorëve, por kurrë nuk ia kam lejuar vetes të luaj ndonjëherë rol në jetën e përditshme. Atë rast bëra sikur u zgjova nga gjumi duke rënkuar mundimshëm. Jadranka u kthye, ndezi dritën. Ma

kapi dorën. Ma mati pulsën duke shikuar orën. Unë hapa qerpikët. M'u bë sikur e shikoja për herë të parë. Më shëmbëlleu çuditërisht me Xhokondën. Jo vetëm kaq, por pata një përfitim kryeneç sikur kisha përpara jo krijimin, por modelin e gjallë të Mikelangjelos. Doktoresha, më tepër e merakosur, sesa e habitur nga ai zhirim i përhumbur dhe kuturisës, ma përshkoi dorën e vogël rrathë qafës sime të trashë si të demit. M'i shtypi damanët. Pastaj cicëriu butë

— Emrush, më fal xhan, ta prisha giumin e ta lashë përgjysmë ndonjë ëndërr të këndëshme. Ç'më shikon ashtu?!

— Monalizë! — thirra unë fare i përpirë.

— Përse t'u paska shkrepur të luash rolin e të sëmurit? Nëse shakaritesh, të lutem ndërpreje këtë lojë tekanioze se nuk më pëlqen! — tha Jadranka me timbër pafshehtësisht të shqetësuar.

Ndoshta pyetia e psikoterapistes ishte e rastësishme, por mua që më ishte kthyer në shqetësim të madh nërplasia në psikiatri pa qenë i sëmurë, që kisha mbledhur të gjitha forcat fizike dhe shpirtërore për të dëshmuar të kundërtën, më shkundi nga ajo amëshiti diluzioni përpirës. I përcolla një vështrim, ku përmbledhej edhe kërkesa për ndjesë, edhe lutja të më kuptonte drejt. Në fund i thashë jo pa ngashërim:

— Më ndjeni, doktoreshë, por, nëqoftëse do të kishit një pasqyrë të madhe, ta vështronit vetveten, do të bindeshit se aq shumë shëmbëllemi me kryevenrën që përmenda, sa po të ishte gjallë Mikelangiolo, do t'ju merrte ju për model dhe jo Xhokondën. Binduni një herë e mirë se unë nuk jam i prirur për komplimente dhe këtë që po jua them, është rrjedhim i një përceptimi të shëndoshë dhe i pampleksur me ndonjë turbullirë që mund t'ju shkojë nëpër mend.

Doktoreshës ia përshkoi fytyrën një rrezatim i purt. Profi, pasi fërkoj duart me njëra tjetrën duke përthyer gishtrinitë, në mëdyshje të largohej, apo t'i bindej zërit të zemrës, bëri një grimasë foshniarake me duar të kryqëzuara si përpara kthinës së rrëfimit, më uthi në ballë. Pastaj dëgjova hanat e saj ritmike tek largohej nga kuvlia ime e xhamtë. Kur e mbvlli derën prapa votës, tha diçka nëpër dhëmbë. E rihapi derën dhe shtoi:

— Do të kthehem, sapo të kthjellohesh nga halucina-

cioni, kur të të dukem si Jadrankë dhe jo si Monalizë...

Ndonëse ai ligjërimit ishte i singërtë, trurin ma pickuan shumë pyetje. Zaten edhe njeriu me më karakter të fortë, në një mjedis të tillë, dyshimin do ta kishte prani kudo. Edhe fjalë të dala prej thelbit të shpirtit do t'i ktheheshin kokëposhtë. U shtriva në krevat dhe si zakonisht lidha duart prapa qafe. Po i merrja në analizë fjalët që ia kisha thënë Jadrankës. Të gjitha pa përjashtim u shkruanë në një idiotësi, apo kalamallëk qesharak. S'do mend, u dëshpërova. E gjykova veten rëndë me vetësharje: Vërtet ajo i ngjan Monalizës, po ç'të duhet ty, mor torrollak, mor mendjetrashë e tyryfyl që ia shpreh asaj! Ku e njeh ti atë?! Këto pyetje e mendime të tjera ma ngushtuan frymëmarrjen sa dyshova mos po jetoja fazën e parë të çmendurisë. Por deshi fati, u rikthye Jadranka. Unë u ngrita ultas dhe prapë në sytë e mi u shfaq shëmbëlltyra e Monalizës.

— Kotnasikoti e shuplakova Horvatkën. — tha ajo duke m'u afruar buzagaz, — paske një veti që vërtet i bëke për vete të tjerët. Komplimentet nuk i honeps, sepse gjithmonë bëhen për qëllime të caktuara, pa pasur në brendi gati-gati asnjë të vërtetë të qëndrueshme. Komplimentet mund të jenë edhe vecori e servilit, edhe si molepsje snobi, edhe kod i mirësjelljes moderne të salloneve. Megjithatë ti e the atë rastësisht edhe atë singërisht, sa në vend të neverisë, ma ndezi kureshtjen, ndonëse me vonesë...

Unë prapë humba shtegun nga duhej të më udhërrëfente arsyeja, ngaqë me gjithë mend më ngjante sikur të ishte kipiç i Xhokondës. Dhe duke u përpëlitur në hullinë midis asaj që përceptoja dhe asaj që duhej të gjykoja realisht, ia këputa për mozomakeq:

— Ylli i fatit tim nuk paska perënduar ngaqë më paska ruajtur rastin të shikoi një Monalizë të gjallë e të vërtetë, — dhe pa u ftohur fjala e fundit e dalë prej goje, u pendova.

Por ndodhi çudit se zonjusha u kënaq pa masë. domosdo si psikoterapiste, krahasoi qëndrimin e mëparshëm të porsazgjuar nga gjumi me gjendjen reale të atypëratyshme dhe u bind se ato që ia thashë nuk ishin kompliment, tha:

— Dashuria, edhe pse thonë se është e verbër, e gjetka rrugën pa ia treguar askush...

Unë, si skllav i rutinës, ia hodha dorën krahaqafë dhe



u mata ta puthja. Por Jadranka kërceu përpjetë sikur t'i ishte vërsulur qeni i tërbuar. Mua më ngacmuan dy mendime të kundërta njëherësh: Së pari, Jadranka qenka nga ato femra që e dinë se, sa më tepër t'i bësh naze mashkullit, aq më këmbëngulës bëhet; ose cilido që jepet sa më pak në dashuri, fiton epërsi. Së dyti, kjo edhe mund të jetë e virgjër, ndaj tmerrohet përballë një kokëkrisuri që, ndonëse i adhurueshëm, hidhet drejt e në mendjeshkrepje seksuale. I thashë:

— Një adhurim dhe nderim i tepëruar shprehkan të kundërtën e vet...

Doktoreshës iu zvogëluan dhe në çast iu zmadhuan bebët e syve. Ma nguli vështrimin turrielë, në mëdyshje të hidhej në përçafim, apo t'ia mbathte, lëshoi një ligjërimit disi filozofik:

— Të dallosh të bardhën nga e zeza, do të thotë të kesh shqisa të shëndosha. T'i shprehësh aq dallimet, do të thotë të gjykosh drejt, të thuash mendimin tënd troç dhe pa ekuivoke...

— Nuk është mjek vetëm ai që ka diplomuar, por edhe ai që ka hequr mbi kurriç vuajtjet e jetës. Por disa, si puna ime, lëngojnë nga hijet e mendimeve të tyre të mbrapshta... — thashë turbull.

Doktoresha më puthi në mënyrë familjare në faqe dhe ma ktheu.

— Ndonëse nuk jeni i sëmurë, psikoza e mjedisit ku jetoni ju ka bërë të dyshoni në vetvete dhe në ata që ju duan singerisht...

Vendosa ta kapërcej atë lloj kumtimi dhe u hodha në çfarë më interesonte:

— Ç'e keni Horvatkën së cilës ia kam vënë emrin Bala-she?

— E kam bijen e motrës së nënës, jemi rritur bashkë, — gjegji Jadranka.

— Ç'ju bashkon dhe ç'ju veçon prej Horvatkës si bije tezeje?

— Kushurira ime është ca si pipiruçe, por nuk druhet ta thotë troç ç'ndjen dhe ç'mendon pavarësisht nga mjedisit ku jeton. Është zhgënjyer nga jeta se e kanë përdhuanar pa i kapërcyer mirë të katërmbëdhjetat. Kërkon të përfitojë nga rasti, pa marrë parasysh me ç'pasoja mund të jetë i ngarkuar ky rast. Urren regjimin në fuqi dhe e

quan si shkaktar të të gjitha fátkeqësive që jeton shoqëria jonë sot. Urren masakruesin e prindërve dhe dhunuesin e saj, por nuk është konsekuente ku, kur dhe si të hakmerret. Dobësia e saj qëndron në atë se kurrë nuk gjen forca e zell në vetvete t'i shkojë deri në fund qëllimit të vet të pikësnyuar.

— Po Zdravkën si e njihni? — pyeta unë.

— Zdravaka është mjerane e fatit të vet, — gjegji Jadranka. — Asaj ia njohin ca veprime që përbëjnë faj, vetëm pse ka flirtuar qysh në moshën gjashtëmbëdhjetëvjeçare me një oficer fashist. Ndonëse është rrëfyer singërisht te partiakët, të cilët punojnë e veprojnë në praktikë porsifashistët, e mbajnë të robëruar për fajin në kohën e adoleshencës. Dhe e detyrojnë të kryejë punëra të kushtëzuara dhe veprime të ulëta siç ia do interesi klanit panserb, — gjegji Jadranka dhe shtoi: — Ti mund të kesh livadhisor si të është shkrepur në jetë, por nuk të falet që je lëshuar në krahët e Zdravkës. Ajo kur thotë të dua, duhet ta kesh parasysh se kryen një porosi të tjetërkujt...

— Ju flisni sikur të gjitha ato që ndodhin në këtë psikiatri kalojnë përmes duarve tuaja, — i thashë.

— Ndonëse si psikoterapiste duhej të mbikëqyrja çdo sjellje e dukuri këtu, mbasi ky është specialitet fillestar në spitalin tonë, nuk më jepet ajo e drejtë legjitime. Por e dhënë me pasion pas profesionit, edhe pse privohem në mënyrat më antishkencore, jam në dijeni të gjithçkaje që ndodh këtu, sepse kam ndërtuar marrëdhënie motrore me personelin femër.

— Po me meshkujt? — e pyeta.

— Me ndonjë përjashtim të vogël. Disa kanë mentalitet provincial. Disa janë të dhënë pas përive alkoolike dhe pas ryshfetit. Disa të tjerë nuk i shërbejnë shkencës humane, por vetëm rrogës që marrin. Për kategororitë e fundit s'po ju flas, mbasi i keni parë dhe provuar vetë...

— Janë si gardianë burgu, — ndërhyra unë.

— Krahasimi nuk është i qëlluar, — tha doktoresha. — Gardianët e burgut ruajnë keqëbërësit që paraqesin rrezikshmëri shoqërore, morale dhe ekonomike...

— Dhe politike, — shtova unë.

— Domosdo, — pohoi ajo, — veçse gardianët e këtu-shëm janë të paskrupull, të pamoralshëm, makiavelistë, sadistë. Më saktë nuk janë gardianë, por matrapazë politike

që mjekësinë, shkencën më humane në botë, e shpërdorojnë për qëllime inkuizicioni.

— Jam kureshtar të di si ia arritët të më keni mua nën kujdes? — pyeta.

— Së pari më ngarkoi doktor profesor Abrahami, të cilit qysh në ballafaqimin e parë i pëlqyet, — gjegji Jadranka. — Por profesor Meleviçi, që ka pushtet absolut mbi këtë klinikë, bëri çmos të merrej me ty. Unë e dija mirëfilli se kush ka kaluar përmes duarve të tij, ose është çmendur përfundimisht, ose është dënuar me burgim të përjetshëm, ose ka përfunduar në varr. Prandaj vajta në Beograd, Gurgureviçi, që ka një post të lakmueshëm në Marshalatë, anipse nuk ia arriti t'ju nxirrte nga ky spital, i detyroi ata të ministrisë nga varet Meleviçi, të dërgojnë një shkresë të posaçme për trajtim dinjitoz, madje edhe është nënvizuar: Të merret vetëm psikoterapiste Jadranka Zara me Emrush Vushtrinë.

— Dhe ju më prutë në këtë kuvli ngjitur me pavionin e grave?! — e pyeta unë.

— Unë, — pohoi Jadranka dhe vijoi: — Kam disa të sëmura të një natyre të komplikuar matanë. I mbaj në vëzhgim të përditshëm. Më duhet të zbuloj ç'shikallë historie vuajnë dhe të hulumtoj shkaqet e sëmundjes.

— Po unë ç'hyj në këtë mes, apo ju vjen ndorësh të më përdorni si Pavlovi gentë?

— Së pari, ju nuk jeni i sëmurë përkundrazi erudit e i shëndetshëm si rrallëkush, — tha Jadranka. — Së dyti, jeni i pashëm dhe kolos që ua zgjoni interesimin edhe femrave që mezi u feks afshi i seksit, lëre më atyre që vuajnë nga mbingarkesa e epsheve. Së treti, ju mund të më ndihmoni në shumë se një dyzinë psikiatrësh...

— Si ju ndihmuakam?

— Duke vëzhguar ato femra të sëmura për të cilat do t'ju them unë.

— Ndonjë arsye të katërt keni? — qesëndisa unë.

— Përveç ndjesës që mund t'ju kërkoj mbasi nuk ju pyeta përpara se t'ju sillnim në këtë dhomë, nuk kam gjë tjetër, — tha Jadranka.

Ndonëse u binda për qëllimin e saj human, nuk më erdhi mirë që më kishte zgjedhur pikërisht mua për të diagnostikuar të sëmurat psikike; veç kësaj u ndodha përpara njëloj zhgënjimi sepse kisha hamendësuar se ajo më

donte si mashkuil. U mata të shtrihesha në krevat duke ia kthyer shpinën doktoreshës. Mirëpo ajo qeshi gurgullueshëm dhe më gjithë shpirt ngaqë e psikologjisi drejt gjen-djen time. Hapi shishen e verës dhe tha:

— Ju vërtet nuk jeni i sëmurë, por jeni tekanjuz.

Unë heshta.

— Nuk besoj të më privoni nga kënaqësia për të pirë këtë verë së bashku, — vazhdoi doktoresha. . .

Unë nuk iu përgjigja. Qëndroja kokulur.

Jadranka ma vuri dorën nën mjekërr, ma ngriti kryet dhe, duke më vështruar thellë në sy, tha:

— Nuk është e hieshme që midis dy tekave gjithmonë ta zgjidhni tuajën. . .

Për herë të parë në jetë m'u zgjua një gulsh mendjeshkrepjeje ta mbërtheja e ta shtrija poshtë vetes. Por psikoterapistja ishte hem e zgjuar, hëm djallushe që ta lexonte mendimin dhe qëllimin fluturimthi, u zmbrafs duke qeshur gurgullueshëm.

— Natën e mirë! — ia pata unë.

— Po më dëboni? — pyeti qetë-qetë Jadranka.

— Ju thashë udhë e mbarë, meqë po zmbrafseni drejt portës. . .

— Nuk keni respekt për mua? — pyeti ajo me zë të ndryshuar: — Nuk më doni fare, fare?!

— Nëse nuk e dua një femër me gjithë shpirt, nuk e këmbej me gjënë më të shtrenjtë lirinë e beqarit, — m'u shpif kjo thënie e kohës së akademisë ushtarake kur bënim gara midis nesh për shprehje të zgjedhura që u duheshin thënë femrave.

— Domethënë nuk më doni? — pyeti doktoresha.

— Si mund t'ju dua kur ikni prej meje si prej lugatit, — ngacmova unë.

— T'ju them se jam e paprovuar në dashuri, nuk do ta besoni, ose do të mendoni se kam ndonjë të metë, — tha Jadranka me një zë që ta këpuste shpirtin: — Shoqet tallen me mua. Ndonjëra më quan edhe eunuke. Nuk kam asnjë mangësi qoftë nga ana shpirtërore, qoftë nga ana fiziologjike. Sa isha studente, u isha kushtuar vetëm mësimëve. U qëndroja larg argëtimeve të cilat u hanin shumë kohë dhe u shkaktonin ëndrralla shoqeve të mia. Tërë kohën e kaloj në psikiatri, vetëm gjumin e bëmë në shtëpi. Në

këtë spital nuk më ka hyrë asnjë mashkull në sy. Jo vetëm kaq, por vendin e punës e konsideroj të shenjtë. Bile jam e rreptë edhe ndaj vartëseve të mia. Puna është punë. Ajo duhet të respektohet. Ky është një parim që duhet t'i nënshtrohen të gjithë veçanërisht mjekët që kanë në dorë jetë njerëzish.

— Përse nuk thoni se qenkeni gjermankë?! — bëra hoka unë.

— Ju e dini se jam kroate, po rregullit dhe regjimit të punës i përmbahem përpikërisht si gjermane. Dy vjet isha për specializim pasuniversitar në Gjermani, kam mësuar më shumë se në shkollën e mesme dhe në fakultetin e këntushëm, — tha Jadranka.

— Në pjekjen e parë, kur ju pyeta, ju thatë se dinit vetëm italishten dhe rusishtën, — vëreja unë.

— E kisha studjuar dosjen tuaj. Atje shkruhej se dinit shumë gjuhë. Madje nënvizohej se gjermanishten e zotëronit si gjuhën e nënës. Prandaj pata frikë t'jua pohoja, — tha Jadranka dhe ma ofroi shishen me verë.

Për herë të parë po e ndieja veten inferior ndaj një femre. Jadranka, ngaqë i ishte kushtuar shkencës me një regjim asketi, ndonëse i njihte dhe i përfillte gëzimet e jetës, ishte e patundur në parimet e veta. Sundonte mbi veten, këmbëngulte ta shtrinte atë pushtet edhe mbi këdo rreth e rrotull. Unë edhe sikur të punoja këmbëngulësisht, nuk mund t'i nënshtrohesha askujt. Përfytyroni një njeri me vullnet të paepur, që ka ecur në jetë vetëm me forcat e veta, që nuk ka denjuar kurrnjëherë të veprojë sipas asnjë diktati, veçse ashtu qysh ia ka diktuar mendja dhe shpirti i vet! Mirëpo shorti më kishte vërvitur në rrethana të tilla, të cilat më detyronin të isha më elastik, madje të aklimatizohesha edhe me veçori diplomatike.

Ndërsa Jadranka kishte ngrirë me shishen e verës në dorë, unë qesha, më saktë përqesha vetveten si guak dhe u shtira i bindur ndaj një çupërlinë, e cila, ndonëse i shëmbëllente aq shumë Monalizës, për mentalitetin tim mbe-tej femër si çdo tjetër. Ia rrëmbeva shishen prej dore dhe e ngrita pa marrë frymë. Doktoresha ma shkëputi dhe e vuri në buzët e veta. Pa e hequr lëfytin nga goja, e piu-deri në fund.

«Dreq, o punë! — thashë me vete, kjo ka vendosur të më jepet dhe më vonë t'ia lër fajin të dehurit, ngaqë në-

përkëmb parimet vetiake. Virgjëreshat, të penduara se kanë agjëruar në qejfe, në një moment u nënshtrohen marrëzive të rastit dhe bëjnë budallallëqe pa marrë parasysh se më vonë mund të pendohen përjetësisht. Prandaj jo aq nga ngasja e epshit, sa nga vetëbesimi u mata ta puthja. Jadranka, sikur t'i ishte sulur nëpërka, nuk do të kërcente e të zmbropsej aq e tromaksur. Me duart përpara si mburojë, e mbështetur në murin e xhamtë, mezi foli me zë të dridhëruar e të shoqëruar me dihatje të shpeshta:

— Për ç'ke më të shtrenjtë, të përgjërohem, mos m'u afro. Të dua si askënd tjetër. Nuk më dhimset hiçkurr gjë për ty, por gjendem në krye të detyrës. Ky është vendi i punës, i shenjtë për mua. E shikon se po të drejtohem me ti. Sepse shënon një zgjim të moshës sime njëzetegjash-tëvjeçare. Megjithatë mos m'u afro!

Qëndrimi i saj ma ktheu tekanjositetin në tundim, sa u frikësova mos po shkelja në kufijtë e së ndaluarës që do të më prishte shumë punë, mbasi qenkësh dashur të provoja edhe psikiatrinë, për të kurdisur plane për të ardhmen. Të përmbushja ato detyra që i përkasin çdo patrioti, duke shlyer, aq sa të ishte e mundur, gabimet që kishim bërë në luftën e shkuar duke u besuar dofarë aleatëve mashtrues. Prandaj iu luta Jadrankës:

— Në jeni ajo që m'u zbrërthyer në tërë lakuriqësinë e së vërtetës njerëzore, largohuni nga kjo kuvli. Mund të mos e përmbaj veten. Më kuptoni drejt dhe ikni.

Ato fjalë të miat duket e frikësuan Jadrankën mos i thosha të ikte përgjithmonë, tha:

— Nëse të është tekur të shfrysh pa dëshirën dhe vullnetin tim, jam gati të të nënshtrohem, por jo këtu. Jo në vendin e punës.

— Jua përsëris, jetoj një çast kur nuk mund të frenoj pasionin, prandaj largohuni. Ju premtoj se ky rast nuk do të ndikojë në marrëdhëniet tona.

— M'u drejtoni me ti, siç po bëj unë, që t'ju besoj, — tha e ngashëryer Jadranka.

— Ti, Jadranka Zara, psikoterapiste e të famshmit spital psikiatrik të Nishit, mund të ikësh nga kjo kuvli të pamendësh, pa u shqetësuar se Emrush Vushtrija mund të të mbajë mëri për qëndrimin tënd asket, ngurosur në rregullin gjermanik të parimit dhe të ndalimit të argëtimeve në

vendin e punës, — ai ironizim ishte pjellë e tekanjozi, tim dhe jo e vetëdijës.

Jadranka, gati përvaishëm dhe e mjeruar u sul drejt meje, më përqafoi me afsh dhe tha:

— Bëj ç'të duash me mua, veç dije se kjo do të lër vrragë në të ardhmen time!...

Fjalët e saj më prekën. Dhe m'u bë sikur kisha në dorë një adoleshentë me veti miturake. E putha për t'i treguar se e doja. E shtyva lehtë deri te porta. Atje m'u kacavar në qafë duke belbëzuar:

— Bëj ç'të duash me mua, por jo këtu! Të lutem, eja jashtë spitalit!

Megjithëse fjalët «eja jashtë spitalit» më ndollën dyshim, nuk kundërshtova për atë sebeb, por për tjetër arsye. Kjo, mendova, e ka ruajtur vajzërinë deri në këtë moshë... dhe i thashë:

— Jadrankë, ti je e pastër, e sjellshme, e zonja, humane, mbi të gjitha je virgjëreshë. Nuk dua të shfrytëzoj një dobësi të rastit, e cila do të më rëndojë si gur pendese tërë jetën.

— Eja, eja të lutem, — më tërhoqi Jadranka, — nuk vuaj nga komplekset. Ruajtjen e virgjërisë e konsideroj si mbeturinë atavike patriarkale, sepse ndalon vetëm seksin femër. Tamam ti dua të bësh ç'të duash me mua. Por jo këtu. Vendi i punës është si tryeza e ngrënies. Në sofër nuk kryhen nevoja të tjera... Eja! E di unë si të të nxjerr jashtë spitalit. Banesën e kam afër. Eja, të lutem, sonte m'u mbush mendja për të parën herë. Eja! Eja sonte, se kam frikë, do të më ndryshojë mendja...

E putha gjatë dhe e përcolla deri te porta. Ajo iku me vrap, pa e mbyllur derën nga jashtë.

Trilli u ngjaka stuhive të verbëra. Më erdhi mirë edhe u dëshpërova për rastin e kapërcyer. Tërë jetën ia kam pasur frikën vetes. Gjithmonë e kam parandjerë se nuk mund të jetoj vetëm me një grua. Prandaj edhe nuk më është mbushur mendja të martohem. Sa mbeta vetëm, e fika dritën. Të bërëhaturat e femrave matanë më ndollën bezdi. E rindeza, sërish e fika dritën. Vendosa t'ia bëj një lloj gjyqi vetvetes. Njolla më e pashlyeshme e lëndimit të vetëdijës bëri që të kujtoja Martë Gjinadardën. Mirë të më bëhet që gjendem këtu. Unë paraqes rrezik për shoqërinë. Isha kthyer në parazit që je-

ton me lavdet e shkuara, nuk mendon asgjë për të ardhmen. Përse qenkam gatuar kësisoji?! Kush mban faj për karakterin tim kaq kompleks e të ndërlikuar? A mbërrihet gjë duke sharë vetveten? Sa për femrat, vetë më ngasin. Çfaj mban ti, Emrush Vushtrija që të ngjiten femrat si bleta lules? Jo, jo, — thashë me zë, — Jadrankën e katandisa në atë hall nga mania ime se kërkoj të nënshtroj këdo. Pra unë mbetem i pandreqshëm. «Po, mbetesh i pandreqshëm», çërriti një zë i mefshët në një cep të trurit, sikur të më fliste dikush mbi llapën e veshit, «i pandreqshëm dhe mjerran. Rifillo atë që e lë në gjysmë të udhës. Gabimet nuk ndreqen as duke pirë, as duke vajtuar zhgënjimin dhe dëshitimet në luftën që shkoi. Rifillo jetën nga e para!...» Por atë çast m'u ndez nepsi për të pirë. Një shishe raki nuk do ta ndërroja me gjënë më të shtrenjtë. E pra prej ditës që më kishin sjellë në psikiatri, as në ëndërr nuk më ishte shtënë rakia. Sa u përmend kjo fjalë, m'u kujtuan Kasapi dhe Këpucari. Pyeta: Si e kanë hallin ata të ngratë?! Janë viktimat e mia. Për sebpin tim vuajnë. Ishin zotër të zanateve të tyre. Të martuar dhe të kënaqur nga jeta bashkëshortore. Ua zgjova ndjenjën e luftës dhe të përgjegjësisë për truallin duke u premtuar se do të fitonim. Me luftën tonë, me gjakun tonë do të bashkonim Atdheun e përgjysmuar. Ata u bashkuan me mua. Edhe pse shpresat dështuan, ata më qëndruan besnikë ngaqë u zhgënjem të gjithë dhe në gotën e rakisë e kërkuam zbutjen e kafshimit të dështimit. Për shkaku tim ata të dy iu bënë barrë familjeve të tyre. Gratë e tyre u kthyen në gjini, sepse pijaneci i rëndon edhe kalldrëmit e jo më shtëpisë së vet. U rrejtëm. Mohuam edhe zotin për hir të idealeve. Ç'arritëm? Mirë thotë Volter penëprehti. «Edhe nëse nuk ka perëndi, shkruan ai, njerëzimit i duhet krijuar një zot, ku të besojë dhe të mësojë ç'është e lejuar dhe ç'është e ndaluar për të mirën e shoqërisë». Ah, Volter, Volter, mor babush. Të kishe jetuar më gjatë dhe t'i ggykoje pasardhësit e tu politikanë të një gjaku... Pikërisht pasardhësve të tu u lindi mendimi i mbrapshtë për të krijuar një shtet sllavë të jugut me emrin Jugosllavi. E keqja myket duke u rritur. Do të rrjedhin vitet, ajo krijesë artificiale do të kthehet në mallkim edhe për brezat e vet, edhe për brezat francezë të kulturuar e demokratë, edhe për mbarë Evropën, sepse prapësitë lindin nga vepër e panatyrshme. Sherri lind sherrin, po ç'kusur



ka njerëzimi të jetojë ëndrralla nga ky shëranjuz.

U ktheva në krahun tjetër duke i bëzajt vetvetes: Em-rush Vushtrija, më duket po e gjen shtegun nga duhet të rravgosh, sepse pendimi shënon fillimin e ndreqjes së ga-bimeve. Me këto mendime m'u rënduan qerpikët. Erdhi gjumi, të cilin përherë e kam cilësuar të shenjtëruar. Mirëpo nuk zgjati dhe zbardhi dita. Pavioni i femrave që ishte shtrullosur nga tabletat e gjumit, u ngrit me aq rrëmet sa edhe të vdekurin do ta zgjonin nga varri. Mbi tërë zalla-hinë, dëgjoheshin të çirurat e Zdravkës. Paska fjetur me të çmendurat, thashë dhe vështrova me kërshtëri përtej xha-mllëkut. Ndhmësmjekja e veshur si edhe të sëmurat hi-dhte valle, shkundëtc dhe qëllonte ato që nuk ishin zgjuar ende, gërvallej. Dikur u turr te xhamllëku. Më shau me një «jetemi shiftarsku majku!» Pastaj futi gishtin e madh midis dy gishtave të tjerë në mënyrë të turpëshme dhe ma bëri «Na, na, na,!» Të jetë çmendur? pyeta unë. Apo e kanë kredhur midis të sëmurve si spiune? Sakaq erdhën sanitaret dhe i nxorën nga pavioni. Me sa duket i dërguan në sallën e ngrënies.

Në dhomën time erdhi Jadranka. Fill pas saj Balashja ma solli mëngjesin. Si i vendosi pjatat mbi komodinë, ajo u mat të largohej, por doktoresha i tha:

— Qëndro, — pastaj mua: — ke parë ëndrra sonte?

— Nuk kam mbyllur sy tërë natën, — ia ktheva unë.

— Kush brengoset kot, vjedh vetveten, — tha buzagaz Jadranka, pastaj pyeti me zërin e ëmbël e melodioz: — ke ndonjë shqetësim?

Iu përgjigj Balashja:

— Padyshim e ka shqetësuar Zdravka, — dhe, siç, m'u duk, nënqeshi me kopili.

— Mirë që ma kujtove, — i thashë Balashes, pastaj pyeta doktoreshën: — Përse Zdravka flet me të sëmuret?

— Është çmendur. — u përgjigj Balashja.

— Vërtet? — pyeta unë.

Deshi të përgjigjej Balashja, por Jadranka e qortoi:

— Horvatkë, mos u bëj piper në çdo gjellë, — pastaj mua: — thonë se ka pasur kriza.

— Melevici ty të quan fajtor për krizat e Zdravkës, — nuk iu durua pa folur Balashes.

— Horvatkë, motër, përse je bërë kaq llafazane, — e qortoi psikoterapistja dhe, duke ma vënë dorën miqësisht

mbi shpatulla, tha: Sa të jem unë këtu, Emrush Vushtrisë s'ka për t'i hyrë ferrë në këmbë. Ha mëngjezin se kemi punë...

Nisa të micërroj, por mendja më punonte furishëm. Shumë pyetje zëvendësonin njëra tjetrën: Ç'kurdis Meleviçi? Si të sëmure e kanë shtruar Zdravkën apo?... Përse Jadranka më tha ha se kemi punë?

Ndërkohë u kthyen të sëmurat nga tërpezaria në pavion. Unë përfundova ngrënien.

— Mbrëmë t'u luta të më ndihmosh, — ma pati Jadranka. — Duhet të diagnostikoj disa, pastaj të shikoj ç'mund të bëj për to...

Ndërkaq vajza apo nusja që pati fërkuar gjoksin disa ditë më parë, iu afrua xhamit, u mat të nxirrte sisën, por kur pa se gjendesha midis dy femrave, ma nxori gjuhën. Filloi të qajë duke goditur kokën e vet.

— Bravo! E parandjeja se kështu do të ndodhte. — foli e përhumbur dhe e gëzuar doktoreshë Jadranka dhe, si shënoi shpejt e shpejt diçka në blok, tha: — Horvatkë, futja krahun zotit Emrush, shëtisni rrëzë xhamllëkut!

Mënyra e shpenguar e të shprehurit, zëri i ëmbël dhe gëzimi i saj se zbuloi diçka që e kishte pritur me padurim, më magjepsën. U ngrita pa kundërshtimin më të vogël. Balashja ma futi krahun sikur të ishim bashkëshortorë. Ai gjest i saj m'i trazoi xhindet dhe filloi të më punojë truri përsëprapëthi: Mos po më marrin për kloun cirku këto, apo kufomë kadavër për provëza?! Ç'pandehin këto pipiruet se jam unë?! Dhe në çast m'u shkrep t'ia jepja një flakareshë Balashes. Mirëpo vështrimi im ndeshi me të Jadrankës. Ajo sikur të zgjidhte dhjetëra fjalë, nuk mund të thoshte ato që shprehu me sy dhe me mimikën aq ëngjëllore. E frenova shpërthimin.

Disa nga të sëmurat në pavionin e femrave, sa na panë ashtu çift që shëtisnim si në lazën e parë të muajit të mjalitit, u shkrehen në vaje ngashëruese. Jadranka mbante shënim. Zdravka u turr te xhamllëku dhe thirri me zë të prishur: «Hej: ti, ëzhdërha, që të ka pjellur djalli për t'ua prishur mendjen femrave, mos pandeh se do të të notojë gjatë kungulli mbi ujë! Ti na përdhunove, ne do të ta shkulim atë katana që e mban midis shalëve! Do të të tredhim, të të kthejmë në shyt, të barabitesh me ne...» U mata ta pyes Balashen përse ishte aq e eksituar Zdravka, mirë-

po rrëmeti i të sëmurave që e pasuan Zdravkën u bë aq shurdhues e shkundullues, sa nuk më dha rast të hapja gojë. Jadranka shkruante ngutshëm dhe e përpushur. Balashja ma shtrëngonte krahun dhe kënaqej me gungat e muskujve të mi. Një zë i thekshëm femre thirri nga përtej:

— «Na e lejoni atë damazin bukurosh të vijë në pavionin tonë. Së paku t'i tregojmë se ishim bashkëshorte të atyre madhorëve, të cilët udhëheqin dhe drejtojnë ideologjinë dhe politkën e federatës sonë socialiste...»

— Ajo që po flet, — tha Balashja, — ishte bashkëshortja e një funksionari të lartë partiak e shtetëror. Për luftën që ka bërë, është dekoruar. E quajnë Gordana. Pas luftës, i shoqi i saj flirtonte me një vajzë të re. Gordana shkruan një pamflet me titullin «Atij që e tradhton gruan e vet, dashnorja s'ka përse t'i besojë» dhe e botoi në një gazetë duke demaskuar me emër e mbiemër burrin e vet. Ta burgosnin për fyerje publike të personalitetit të lartë, do të gumëzhinin thashethemet. Pas njëfarë kohe u shkruajt vetëm një njoftim i vogël «Drugarica G. e dekoruar me Urdhërin e Trimërisë të Klasit të Parë, u shtrua në spitalin psikiatrik, mbasi vuan nga neuroza...» Dhe me një deklaratë të psikiatërve të MPB. e sollën këtu. Në fillim ishte e heshtur, por dinjitoze. Tashti, se i ka dhënë Meleviçi ndonjë ilaç eksitues, apo i janë prishur nervat nga padrejtësia, ka filluar të shfryjë pa e kontrolluar veten.

— Nuk u solla si e do mirësjellja me ty, megjithatë dua të të bëj një pyetje si më të afërmes time. — i thashë Balashes. — Si arritët të shtinit në dorë autorizimin për të më pasur nën kujdestari?

— Për këtë duhet ta pyesnit simotrën time Jadrankë, — gjegji Balashja. — Megjithatë, meqë kërkuat ndjesë në një farë mënyre për sjelljen tuaj arrogante dhe hiç kavalereske ndaj meje: po ju shpjegoj: Meleviçi, me urdhër të pandërmjetshëm të mareshal Titos, u transferua në një spital ushtarak. Jadranka me ndihmën e Gurgureviçit që punon në Marshalatë...

Unë e ndërpreva qëllimisht:

— Çuditë me Jadrankën. Tërë natën ka qëndruar në krye të detyrës. Edhe sot vazhdon shërbimin. Si e përballon këtë stërngarkesë?!

— Është si mushkë, — tha Balashja. — E dua shkuar motrës, prandaj më dhimbset. Kur është puna për të për-

caktuar një diagnozë, është e gatshme të qëndrojë edhe një javë pa gjumë. Megjithatë më tha se pas kësaj ekspertizës së paraditës, do të shkojë të pushojë. E ndjen veten të dërrmuar.

— Po ti, ku do të jesh pasdite? — e pyeta unë.

— Dihet, do të zëvendësoj doktoreshë Jadrankën, — gjegji Balashja dhe shtoi: — nëse s'ke kundërshtim, do të vij edhe në këtë kuvli.

— Duku kërndejsa, se pasditet më janë shumë të mër-zitshme, — i thashë.

Balashja më vështrroi me sy të perënduar. Pastaj më puthi në sy të Jadrankës dhe të sëmurëve që shikonin ma-tanë xhamllëkut.

— T'u paska mbushur mendja se nuk jam aq e pavle-rë si femër, prandaj të putha, — tha Balashja.

— Më pëlqen se je e sigurtë, edhe si femër nuk je dosido, sidomos kjo balusha ta shton fisnikërinë, — thashë unë.

Ajo u shkri në një gaz të brendshëm. U binda se ia arrita qëllimit, prandaj u hodha në pyetje të tjera:

— E cilit funksionar ishte Gordana që e sollën këtu për shkak se e demaskoi burrin e vet në gazetë?

— Oi, oi. — ia pati Balashja, — fatin e saj e vuajnë çereku i femrave matanë.

— Po më duket e pabesueshme, — thashë, — burrat e tyre, që kanë luftuar për kauzën komuniste, kanë predi-kuar një drejtësi të tillë shoqërore, sa asnjë sistem tjetër gjer më sot s'ka pasur guximin ta bëjë një premtim të tillë.

— Shtiresh si naiv, apo qenke budalla, — ma pati Ba-lashja. — Barazinë që premtuan këta udhëheqësit tanë gja-të luftës, po e provojmë në jetë si mashtrimin më të madh të epokave. Sa për idealet komuniste, që na i zbërthen babai i Jadrankës, të vjen të besosh se vetëm në komuni-zëm njerëzimi do të arrijë kulmin e lumturisë. Por thuhet se socializmi është faza e parë, pa të cilën nuk shkohet në komunizëm. Helmin e kësaj faze po e provojnë të gjithë, prandaj edhe ajo tjetra fazë është ëndërr në diell....

Mbeta gojëhapur nga thjeshtësia dhe logjika e pakun-dërshtueshme me të cilat Balashja shpjegonte probleme të tilla. Kurse unë kisha pasur përshtypjen se ajo mishëronte prototipin e mendjelahtës....

— Ajo flokëpraruara ta ka qepur keq vështrimin, — tha Balashja.

— Cila? — pyeta unë.

— Ajo belkëputura me flokë të praruara, ja atje; në cepin e djathtë të xhamllëkut që po të përpin me shikim të ndezur, — shpjegoi Balashja. — Sa e sjellshme dhe e moralshme ishte. Nuk ma merrte mendja se vuaka «sëmundjen» e Zdravkës tënde...

— Kur qenka bërë e imja Zdravka?! — pyeta unë.

— Vëri kapak këtij muhabeti, — ma pati Balashja. — relatat e tua me të kanë marrë dhenë. Një pjesë e personelit mjekësor dyshon se Zdravka lojti prej fiqiri nga sevdaja për ty.

— Nëse thonë të tilla fjalë edhe për flokëpruarën belkëputur, do të gëzohesha, nuk paskam parë herë tjetër bondje më të bukur. — thashë unë.

— Unë të them se të dya kryejnë detyra policore në atë pavion, për Rozikën flokëpruar me të vërtetë më vjen keq, bile po habitem. Ç'kërkon laborantja në pavionin e të çmendurave, — tha Balashja.

— Cfarë mund të zbulojë policia sekrete në një pavion të sëmurësh psikikë? — pyeta unë.

— Ti je oficer i lartë me dy akademi, di dhe lexon në gjithë ato gjuhë të botës, — vërejti Balashja, — përse bën pyetje të tilla?!

— Nuk e honeps asnjë logjikë e shëndoshë thënien tënde, sepse s'ka ç'zbulon policia sekrete në çmendinë. Të pamendët as merren me politikë, as paraqesin rrezikshmëri për asnjë regjim, apo sistem, — thashë unë.

— Do të ishte mirë të të sqaronte Jadranka, — tha Balashja, — por ajo nuk flet se e ndalon sekretin profesional. Mëso prej meje. Në këtë psikiatri ka pesë kategori të shtruarish. Në grupin e parë hyjnë të sëmurët psikikë: në të dytin, ata që shtihen si të sëmurë për t'u shpëtuar burgjeve e kampeve të skëtërrshme. Të tretët janë ata kundërshtarë politikë me autoritet në opinion si puna jote që i kanë sjellë për t'i denigruar. Të katërtët janë gratë, të fejuarat, ose dashnoret e braktisura të udhëheqësve të Beogradit të cilët, për të kullotur në grazhde të tjerë, i kanë përplasur të parat këtu sepse «normat e moralit proletar» nuk lejojnë të kenë hareme. Të pestët janë agjentët e UDB-ës që shtiren si të çmendur.

— Kush e ka bërë këtë klasifikim? — pyeta.

— Ime kushurirë, Jadranka, — gjegji Balashja, — Banojmë në një apartament.

— Ndarja është interesante, veçse për kategorinë e pestë nuk më mbushet mendja. Për të njëqintën herë maund të pyes: Ç'mund të zbulojë sigurimi në çmendinë?!

— Një aparat shtetëror e partiak diktatorial si yni nuk mund të mbahet në këmbë pa një regjim përgjimi në të gjitha qelizat e kësaj shoqërie, — gjegji Balashja.

— Ç'arsim ke kryer? — e pyeta unë i habitur.

— Gjimnazin dhe dy vjet për ndihmës mjekë, — gjegji Balashja dhe, duket vuri re se e vështroja me sy të shqyer shtoi: — Politikane na ka bërë babai i Jadrankës, koloneli. Qysh në fëmijëri ai e kishte kthyer bancesën e vet, kuptohet, për Jadrankën, Dalmatinin (vëllain e Jadrankës) dhe për mua, në një mikroskollë politike. Pastaj duhet të dini se lexoj shumë dhe jetoj me Jadrankën që është një gjeni e seksit femër. Mbi të gjitha jam bijë e viktimeve dhe e përndjekur që nga lindja. Ju pyetët ç'mund të zbulojë UDB-a në psikiatri. Marrim kategorinë e katërt, gratë, të fejuarat dhe të dashurat e velikanëve<sup>1</sup>. Për to përbën delikt edhe përgojimi i ish burrave të tyre. Nuk duhet të zënë në gojë as emrin e tyre. Ato që nuk i kanë vënë dry gojës, si puna e Gordanës, për të cilën të fola pak më parë, janë dërguar në izolim. Atje dy injeksione dhe firmohet certifikata e vdekjes prej drejtorit të psikopolisindromës dhe prej ndihmësave të tij. Meleviçi ishte vetëm një doktor-xhandar. Ka grupe ekspertësh këtu që merren me studimin se si çmendet njeriu detyrimisht... Ka pasur mjaft raste, qoftë nga gratë e velikanëve, qoftë nga njerëzit si puna juaj, që nuk u kanë rezistuar «metodave paradiagnostike» (ti i ke provuar ato) tani janë më të çmendurit në këtë psikiatri. UDB-a përgjon dhe gjurmon sidomos ata kundërshtarë politikë që shtiren si të çmendur. Atyre ua kam zili se janë aktorë të vërtetë. Artistë dhe të paepur.

— More, për muhabetë ju shtyva të shëtisni rrëzë xhamllëkut të femrave, — vërejti psikoterapiste Jadranka duke na u futur në frymë: — Vështroni ç'bëhet andej.

---

1) Velikan (serbisht): madhor, titullar shtetëror apo partiak.

Ktheva kryet. Ç'të shikoj. Disa femra ishin çapëluar, të tjera kishin përvjelur fustanët. Katër-pesë kishin nxjerrë siset dhe i fërkonin mbi xhamllëk. Disa të tjera bënin dashuri lezbike. Turma më e madhe qëndronte në skajin tjetër të pavionit. Bënin sehir me pamje të mjeruar. Kurse Zdravka dhe një stërhellë e gjatë gati dy metro i binin varravinga zallahisë. Bukuroshja flokëpruar u shkonte mbrapa dhe më vështronte me një kërshtë të habitshme. Zdravka dhe stërhellja bënin çmos ta kridhnin në ngasje orgjinë.

— Horvatkë, — tha Jadranka me zë të ulët, — tregoja Emrushit ato që i kam si objekt vëzhgimi!

— Po, ia pati Balashja, pastaj mua: — I vështro mirë ato që po i gudulisin siset mbi xhamllëk. I pe. Nguli në kujtesë. Ti ua trazon epshe. Jadranka zbulon aq sa të jetë e mundur fazën e sëmundjes dhe përcakton mjetin kurues.

Ndërhyri Jadranka:

— Vëzhgo, regjistro në mendje dhe për çdo ditë më njofto! Të mos isha e bindur se je i gatshëm t'i ndihmosh shkencës dhe njerëzimit, nuk do t'ia lejoja vetes të të futja në këtë garramet. Tashti po shkoj se e ndiej veten të lodhur. Nesër në mëngjes më ke këtu. Mirupashim!

«E çuditshme kjo psikoterapistja! E paska qitur në haresë ngjarjen e mbrëmshme! — mendova me vete.

Edhe Balashja vajti mbrapa doktoreshës. Unë u shtriva në krevat dhe ia ktheva shpinën pavionit të femrave. Atë çast shpërthyen klithma të thekshme matanë. Ktheva kokën ngadalë. Vajzat, apo nuset që kishin fërkuar siset pak më parë, tregonin me gisht nga unë dhe klithnin: «Vdiq! Vdiq! E helmuan!» Megjithëse më pikoï në shpirt ngashërimi çmenduror i tyre, nuk guxova të ngrihesha për t'i qetësuar duke u treguar se as kisha vdekur, as më kishin helmuar. E futa kokën nën përkrese dhe shqiptova fjalët që më gufuan nga thelbi i shpirtit: «Lufta e mallkuar i ka fajet që gllabëroi lulen e djalërisë. Dhjetë herë e nëmur qoftë ajo luftë që zhgënjeu edhe të gjallët, edhe kujtimin e të rënëve!» Dhe pjesa e fundit e frazës më bëri të thellohem. Fola me vete:

«Nuk mund të jetë fajtorë vetëm lufta. Kryefajtorë është tradhtia ndaj saj. Këto vajza të njoma duhet të kenë lindur gjatë, ose pas luftës. Secilën e ka joshur dikush, pastaj e ka braktisur, kjo vjen nga varfëria morale që mbo-

llën rezultatet e luftës. Kur gënjen, mashtron, kusëron, kurvëron një aparat shtetëror dhe partiak, kur një sistem politik, ideologjik e arsimor është ngritur mbi themelet e gënjeshtëtrës, dhunës, spiunllëkut e të mashtrimit, ç'edukatë e moral mund të kërkosh poshtë...»

Për herë të parë qyshse më kishin prurë në psikiatri, tërhoqa sirtarin e komodinës dhe piva një qetësues. Ndoshta pse kurrë nuk kisha përdorur të tillë, ndjeva një si fëshfëritje të lehtë, një puih dehëse. U shtrijua. M'u hap goja dy tri herë dhe më zuri gjumi.

Ndërkohë Balashja më kishte sjellë drekën. Më kishte përkëdhelur e shkundur, siç më tha më vonë, dhe nuk isha zgjuar.

Kishte ardhur mbrëmja dhe kishte rënë errësira, unë top në gjumë.

Një ëndërr jo vetëm që m'i nderu të gjithë telat e shpirtit, por një kënaqësi të tillë shpirtërore e fizike rrallë herë e kisha përjetuar. Hapa sytë, vërej mugët një njeri lakuriq sipër meje. Dihatte dhe mezi mbytte ca ofshama jo dhimbjeje, por lezeti. U mata të mbyllja sytë për të mos e ndërprerë atë ëndërr të çuditshme. Por m'u ngjiten buzët e prushitura të Balashes. E ngrita dorën, ia përshkova trupin. Ishte lakuriq dhe kryente punën e vet. Nuk m'u bë ta tregoja veten se isha zgjuar, mbasi më vinte ëmbël ashtu gjysmë në gjumë gjysmë zgjuar.

Balashja rënkoj lehtë, pastaj, me një zë ku pleksej ngashërim e ngazëllim, tha:

— Qenke më tepër se çdo burrë! I jashtëzakonshëm qenke!

U dëfrega për të gjitha motet e humbura! — dhe më mbuloi me puthje.

Vegimi ma solli të gjallë Marë Gjinadardën. Ajo ma tundte gishtin qortueshëm. Sakaq m'u zgjua sedra patriarkale që jetonte diku në nënvetëdijen time. E rrëkëlleva poshtë vetes Balashen.

— Oi, oi — ia bëri ajo, — paske ndër mend të m'i tretësh edhe eshtrat, — dhe përsëriti refrenin: Qenke më tepër se çdo burrë...

Mua m'u kujtua se tamam asisoji kishte thirrur edhe Zdravka. Dyshimi më përmendi mundësinë e hapjes së portës papritur, ashtu siç kishte ndodhur me Zdravkën kur



pat hyrë Meleviçi me turmën e sanitaroboksierëve. U ma-  
ta të brofja, Balashja më çuçuriti në vrimë të veshit:

— Gjithë shqiptarët posedojnë të tillë temperament?!  
— Unë mund të vijë në fund të listës në krahasim me

bashkëkombasit e mi, — ia pata.

— Çohu! Nuk ke ngrënë qysh në mëngjes, — tha Ba-  
lashja, pastaj u ngrit. Megjithëse errësirë, dëgjoja fëshfë-  
ritjen e teshave tek vishej.

Edhe unë u ngrita. Balashja ndezi dritën. Fillova të  
darkoj me një uri argati. Tek përtypesha me shije, Bala-  
shja më tha:

— Jadrankës i është shkrepur të të jepet me çdo kusht...

## NË PAVIONIN E POLISINDROMES SË DISIDENTËVE

*Padrejtësia më e pakapërdishme shënon momentin kur virtyti detyrohet t'i kërkojë ndjesë vesit ...*

**P**askësh ardhur një urdhër për ndryshime thelbësore në spitalin psikiatrik të Nishit. Dr. Prof. Abrahami u shkarkua nga detyra e drejtorit të përgjithshëm. U tha se vajti si profesor në universitetin e Zagrebit. Disa fytyra psikiatrësh nuk i pashë më. Ata që i zëvendësuan të parët, vërtet qerpikëpërmbysur, por dukeshin më të përzemërt. Sanitaroboksierët nuk i lëvizën. Mua më kaluan nga kuvlia e xhamtë në pavionin e polisindromës, të cilin Meleviçi e kishte pagëzuar «Pavioni vizitonin. Njëditëzaj, tek po kryhej një vizitë e përgjithshme mjekësore në pavionin tonë, doktoreshë Jadranka më telektualë me shkolla të larta.» Ia bëra me dije se njihesha me disa prej tyre.

— Marko i ka halë në sy intelektualët, — më pëshpëriti Jadranka.

Unë e dija se Marko ishte pseudonim i Aleksandër Rankoviçit, ministrit të punëve të brendshme të Jugosllavisë ndaj përmendjen nga doktoresha e mora si këshillë për të pasur kujdes. Qysh ditën kur më kishin përplasur në çmendenin e Nishit, sidomos kur pashë se atje provoheshin metoda më antinjerëzore për t'i sëmurë psikikisht të shëndoshët, vendosa të aklimatizohesha me gjendjen për të zbuluar kundër cilës përkatësi kombëtare ishte prekur tehu helmatus nga partia në pushtet që e quante veten komuniste. Prandaj pyeta Jadrankën:

— Përse e lamë përgjysmë vëzhgimin e të sëmurëve nga histeria?

— Nuk mendon kush për shërimin e të sëmurëve. Në Beograd është ndezur rivaliteti i luftës për pushtet, — tha Jadranka dhe vijoi: — Ky riorganizim i spitalit, mesa duket, po bëhet për qëllime politike. Si drejtor kanë sjellë kryemjekun e kampit të Goliotokut famëkeq. Mjekët tjerë janë të panjohur në fushën e psikiatrisë. Poqese ia mbush mendjen babait, do të kërkoj transferim në një nga spitallet e Zagabit.

— Dashke të na lësh hijen, — ia pata unë.

— Pa të nxjerrë ty prej spitalit dhe pa e pirë atë limonadën e premtuar në banesën time, nuk largohem, — tha buzagaz Jadranka.

Për pak ditë në pavionin e polisindromës njoha plot oficerë të UDB-së, të cilët kishin bërë kërdrinë duke vrarë e asgjësuar në Kosovë. Për t'i ruajtur për kohëra të tjera, me nga një certifikatë mjekoligjore nga Beogradi, i kishin futur në atë pavion me detyrë speciale. Ata përbënin pjesën më provokatore të neveritshme të spitalit.

Mbas një jave në pavionin e psikopolisindromës së disidentëve mezi e bëra të flasë një gjykatës me të cilin më lidhnin shumë kujtime gjatë luftës. E quanin Dragomir Nishlia. Qëndronte i veçuar, herë-herë fliste me vete, më saktë lëvizte buzët. Bezdisëj prej cilitdo që i avitej. Me një fjalë kishte ngritur mbretërinë e vet të heshtjes dhe të izolimit, ku gjente qetësinë shpirtërore. Do ta quaja veten batakiç, nëse do t'ia thyeja atë guaskë vetmitare, po të mos më nxishte me ngulm një shok i akademisë ushtarake, i cili, dy-tre vjet pas përfundimit të luftës si oficer i gardës së

Marshalatës, ishte graduar gjeneral dhe ishte emëruar komandant divizioni në Shkup. Sharanoviçi, ashtu e quanin oficerin madhor, ndonëse me dojçkulturë, pati qenë aq gazmor e i hedhur sa më vonë kishte rënë viktimë e karakterit të vet. Si qejfli femrash ishte ngatërruar me një artiste kinomatografie që ishte bashkëshortja e një ministri dhe dashnorja e njërit prej anëtarëve më me peshë të Byrosë Politike të Partisë Komuniste Jugosllave. Relatat e gjeneralit me artisten kishin rënë në sy. Ishin njoftuar burri i saj, ministri dhe dashnori i saj, anëtari i Byrosë Politike. Ky i fundit kishte urdhëruar të ndërpritej filmi që po xhirohej në Shkup dhe me avion të posaçëm e kishin dërguar artisten në Beograd. Ndoshta për t'u mbrojtur dhe për të mos e humbur karrieren, apo ishte detyruar me dhunë, artistja kishte ngritur padi sikur e kishte përdhunuar Sharanoviçi, të cilin pas një jave e kishin arrestuar. Gjatë procesit hetimor e kishin ballafaquar me ca dëshmitarë që nuk i kishte parë kurrë. Ata kishin deponuar me fakte të fabrikua se Sharanoviçi kishte qenë agjent i shërbimit sekret hitlerian dhe tashti punonte për CIA-n amerikane. Atë kohë, shoku im i luftës, Dragomir Nishlia shërbente si kryetar i gjyqit ushtarak në Shkup. Sa kishte përfunduar procesi hetimor i Sharanoviçit dhe materiali i ishte dorëzuar gjyqit ushtarak, Dragomir Nishlia pas një studimi të imtësishëm, jashtë çdo praktike procedurale (mbasi të akuzuarit dënoheshin sipas diktatit të UDB-së) kishte kërkuar dhe ishte takuar me dëshmitarët e akuzës. Kishte arritur në përfundimin e prerë se të gjithë ishin të rremë, bile kishte urdhëruar të ndaleshin shpifarakët dhe të dënoheshin për dëshmi të gënjeshtërtë. Organeve të hetuesisë Dragomiri u kishte thënë:

— Kundër gjeneral Sharanoviçit mbetet vetëm padia e artistes për përdhunim...

Mirëpo anëtari i Byrosë Politike të PKJ, që mbahej në dijeni të përditshme për atë proces gjyqësor, nuk mund të lejonte të përlyhej emri i dashnores, e cila vërtet kishte talent të spikatur. Urdhëron që gjeneral Sharanoviçin t'ia kalonin gjykatës civile të qarkut të Shkupit. Kurse për Dragomir Nishlien të hapej dosja dhe të mbahej në përgjim të përhershëm.

Gjyqi i qarkut të Shkupit e kishte dënuar Sharanoviçin me burgim të përjetshëm si ish agjent hitlerian dhe si

spiun në veprim i CIA-s. Por Sharanoviçi mu në sallën e gjyqit, ende pa përfunduar pretencën prokurori, kishte vënë duart mbi kokë dhe kishte thirrur:

— Këto janë shpifje banale. Kërkoj gjyq të hapur. Atje do ta them fjalën time edhe për moralin e anëtarëve të Byrosë Politike, mbasi i njoh mirë, se kam shërbyer si oficer me përgjegjësi i gardës së Marshalatës, — pastaj kishte luajtur rolin e të sëmurit nga epilepsia.

Megjithëqë gjeneralin e kishin dërguar në spitalin e burgut, gjyqi e kishte dënuar në mungesë me burgim të përjetshëm.

— Ata që ua dinë të fshehtat pushtetmbajtësve, — më tha Sharanoviçi, — zhduken në mënyrat më të mistershme, poqese merret vesh se ata i dinë ato të fshehta. Në qeverinë tonë ku vepron vetëm ligji i paligjshëm i policisë sekrete, elimini i disidentëve është një veprim fare i rëndomtë. Unë nga «epileptik» fillova të luaj rolin e të çmendurit. Gllavarët e Kalemegdanit të Beogradit, duket e dinin se kam shumë shokë e miq që punojnë në poste me peshë në qeveri, në armatë dhe në forumet tjera partiake, e mirëpritën këtë «çmendjen» time. Asisoji nuk i nxirrnin telashe vetes të përndiqnin e të zhduknin shokët e mi që i shërbejnë me besnikëri partisë në pushtet. Prandaj përhapen fjalë gjithandej: U çmend i gjori gjeneral Sharanoviçi, madje shtonin edhe furçe: Pak çapkën, por burrë i zoti ka qenë. Kështu u qit në harresë burgimi dhe denimi i përjetshëm. Më përplasen në këtë psikiatri. Jemi një grup shokësh besnikë e të fortë. E kemi organizuar jetën për mrekulli. Do ta shikosh vetë. Por më është kthyer në enigmë çështja e gjykatës Dragomir Nishlias. Nuk marr vesh është i çmendur, shtiret si i tillë, apo e kanë vërvitur këtu siç të kanë prurë edhe ty. Dua t'ia shpërblej bamirësinë. Prandaj të lutem iu afro, se me ne nuk hap gojë.

Në fillim refuzova. Por kur gjeneral Sharanoviçi më tha:

— Ani pse ju shqiptarët pandehni se ne, serbët, jemi të pabesë e mosmirënjohës unë dua ta ndihmoj, t'ia kthej të mirën me të mirë dhe kam shumë mundësi. Nuk duroj dot kur e shikoj Dragomirin duke e munduar veten si asket i rrjedhur nga trutë. Nëse nuk është i çmendur dhe jeton nën ankthin e frikës se mos e zbulojnë, binde se dora jonë

i ka marrë të gjitha masat. Këtu hahet ryshfeti me grush-ta. E kemi korruptuar pjesën dërrmuese të psikiatërve, sa për shtabin e UDB-ës që bën ligjin këtu, as bëhet fjalë. I kemi blerë deri edhe milicët dhe rojat e thjeshtë. Edhe një gjë, këtu ka edhe të tillë psikiatër që janë më disidentë se ne. Futju punës me Dragomirin për hatrin tim!

Pranova atë barrë ndonëse çartaqejfas. Ditën e parë e përshëndeta:

— Tungatjeta, Dragomir Nishlia!

Tjetri iku prej meje si prej ndonjë të sëmuri nga mur-taja. Nuk iu ndava sepse u binda deri diku se ai nuk ishte i sëmurë, paçka se e luante rolin e të çmendurit në një mënyrë fort origjinale.

Një mbrëmje e ngacmuan keq dy «të çmendur», për të cilët kishte të dhëna grupi i gjeneralit se ishin agjentë të UDB-ës. Unë u shtira si i çmendur në kulmin e krizave, i kapa dy kalecat ngucakëqinj, ua përplasa kokat njerin mbi tjetrin, pastaj i rraha pa mëshirë. E vodha me bisht të syrit Dragomirin. Ai i strukur në qoshen e pavionit, fërkonte gjoksin dhe qeshej. Iu afrova:

— Dragomir, — i thashë, — sot e tutje më ke mua. Nuk do të guxojë askush të të ngacmojë. Mos u mërzit, do të shërohem.

Dragomiri shtrembëroi buzën sikur t'ia kishte mbër-thyer paraliza. Ma zgjati dorën që i dridnej, sa dyshova mos vërtet kishte luajtur menç.

— Dragomir, ti po më falenderon kësisoji, por s'ka ne-vojë, kemi qenë shokë lufte, ia kemi borxh njeri-tjetrit t'i gjendemi në ditë të vështira. A të kujtohet ngjarja në ma-let e Shumadisë, kur kapëm kapobandën drazhiste?... — Dragomiri e tundi shpejt e shpejt kokën lart poshtë si kali kur e ngacmojnë mizat. Unë vijova: — Ti ishe kryetar i gjyqit partizan dhe e pyesje ku gjendej batalioni i tij. Ai heshte si peshku. A të kujtohet kur e ngjita dhe e lidha për gjuhëzën brendë këmbanes së madhe të kishës, pastaj shtiva me armë mbi këmbanen metalike. Ai, ndonëse brenda në këmbanë, pande hu se e kapën plumbat dhe filloi të ulë-rinte i lëmërisur...

E ndërpreva rrëfimin sepse vura re: Dragomirit i ule-shin dhe i ngriheshin supet sikur ta kishte zënë rryma elek-trike. Ia hoqa pëllëmbet me të cilët e kishte mbuluar fyty-

rën. Sytë i nxirrnin lotë nga të qeshurit që përpiqej ta frenonte përbrenda.

— Ç'ke?! — e pyeta i shqetësuar.

— Hi, hi, hi, — vazhdoi të qeshej Dragomiri, pastaj vijoi: — m'u shfaq i gjallë oficeri drazhist. Kur ti i the se do të vras, poqese nuk tregon ku është dislokuar batalioni drazhist dhe qëllave edhe tri herë mbi trupin e këmbanës së madhe, nënkoloneli drazhist, sikur të ishte një plënc i mbushur me pagërë që shpërthehet papritur, rrodhi i tëri. Hi, hi, hi! Kur e zgjidhë nga gjuhëza e këmbanës dhe e zbritte poshtë, jo vetëm që tregoi ku ishte dislokuar batalioni, por zhveshi edhe pantallonat dhe tregoi të mbathurat që ia kishte rrëmbyer femres ku kishte fjetur atë natë e të cilat i kishte mbushur përplot... Ke qenë i tmerrshëm. I tmerrshëm dhe i paepur në luftime. Në arkivin e Shkupit lexova historikun e batalionit tënd «Hakmarrja». Gjeta një episod për ty...

E ndërpreva:

— Ç'episod gjete?

— Historiku i batalionit partizan «Hakmarrja» duhej të fillonte dhe të mbaronte me ty, — gjegji Dragomiri, — por nejse, bleta mbledh nektarin, grenjëzat hanë mjaltin... Megjithatë në një episod shkruhej për ty. Tregohej se si i vetëm dhe me mjete rrethanore, me disa shishe të mbushura benzinë ku kishe futur grimca sapuni, kishe sulmuar burgun e kuesturës. Karabinierë e policë, të lëmërisur nga krismat dhe flakët që kishin shkaktuar shishet e benzines, duke pandehur se ishin sulmuar nga forca të shumta partizane, kishin ikur dhe ti kishe tërhequr shokët prej burgu.

— Po, — i thashë, — që atëherë më mbeti nofka «Major Bumja». Pastaj qeshëm së bashku. Por papritmas Dragomiri u mblodh kutullaq si pula kur e ka zënë dergja.

— Ç'pate? — e pyeta.

— Të kam shok e vëlla, më shpëto prej atyre dy karagjozëve! Tërë natën më ngacmojnë.

— Si të ngacmojnë? — e pyeta.

— Krevatit im është vendosur midis dy krevatëve të tyre. Ata...

— Qysh sonte do të flësh pranë meje. Po ua mbajti, le të aviten, — i thashë unë.

— Të besoj. Ti je trim i krisur. Të falem nderit, — tha Dragomir Nishlia.

Û ndava prej tij. Gjenerali Sharanoviçi më priste më kureshtje të nderur. I rrëfeva për bisedën dhe për gjendjen e gjykatësit. Gjenerali hipi mbi një krevat dhe thirri:

— Mblidhuni rreth meje. Me vullnet të çmendurve të lirë më keni zgjedhur kujdestar pavioni. Unë, gjenerali i forcave të armatosura të të gjithë eksiqëve, udhëroj... — pastaj ia dha një të qeshure frymëmarrëse, sa t'ia kishte zili edhe më i sëmuri nga neuroza. Vazhdoi: — Urdhëroj, krevati i të përkorshmit gjykatës, të të pamendit Dragomir Nishlia, i cili i ka ra ndesh ligjit të matrapazëve politikë, pra krevati i këtij heretiku të transportohet pranë krevatit të oficerit të lartë të aviacionit, pra pranë Major Bumjes, i cili komandon me forcat ajrore të më të çmendurve të federatës sonë.

Dy veta, që siç mësova më vonë, njeri filozof dhe tjetri sociolog, me një frymë e ngritën krevatin e gjykatës Dragomirit dhe e vendosën pranë timit.

— Jeni të lirë të të zbaviteni me frytet e marrëzisë suaj! — thirri gjenerali.

Sakaq një rrapazhyt, i ngjashëm me Sançon e Servantesit, iu afrua gjeneral Sharanoviçit, mbasi shtangu në qëndrimin gatitu dhe përshëndeti ushtarakisht me pëllëmbën në qoshe të ballit, tha:

— Zoti gjeneral, i fyer në dinjitetin e dritësisë sime, protestoj: Përse nuk e zutë ngojë emrin dhe fronin tim!

— Ti je kral, — ia ktheu gjenerali, — je sovran që komandon mbi forcat gjitharmëshe të më budallenjve botëror. Mendermethanë, kralit nuk i përmendet emri faqe kësaj harbutërie.

— Të falem nderit, — tha rrapazhyti, — jam i kënaqur me ju. Ma vutë nderin në vend, — bëri një prapaktheu dhe me hap ushtarak vajti pranë krevatit të vet.

— Është biri i xhelatit të oborrit të kralevinës, vuan nga deliri i madhështisë, — më tha Sharanoviçi.

Natën e parë gjykatës Dragomiri vërtet nuk foli, por s'dinte si të ma shprehte bamirësinë me vështrime aq të sinqerta e mirënjohëse. Natën tjetër, kur u bind se të gjithë flinin, nisi të më pëshpëriste:

— Major Bumja e merr me mend cili më solli këtu?

— Cili? — e pyeta unë.

— Koka ime, — gjegji Dragomiri.

— E ke gabim, — i thashë.



— Jo, hiç, fare nuk e kam gabim, — pëshpëriti ai. — Kjo kërkim ime që i përmbahet maksimes: Padrejtësia më e pakapërdishme shënon momentin kur virtyti detyrohet t'i kërkojë ndjesë vesit. . .

— E ç'do të thuash me këtë? — e ndërpreva.

— T'u nënshtroheshia padrejtësive, të zbatoja urdhërat e timonierëve të regjimit që kërkojnë të dënohen të pafajshmit e të gëzojnë të drejta qytetare të pakufishme maskarenjtë, sahanlëpirësit vetëm pse u shërbejnë verbtazi, unë nuk do të gjendesha në psikiatri. Këtu do të çmendesha, poqese ylli i fatit tim nuk do të sillte ty, — tha Dragomiri.

— Falendero gjeneral Sharanoviçin, të mos më nxiste ai, unë nuk do të avitesha ngaqë bezdiseshë edhe prej meje.

— Ah, mor vëlla, në situatat që jetojmë, njeriu nuk mund t'i besojë as edhe këmishës së vet, — tha Dragomiri, — Rri i heshtur dhe përbluaj në vetvete. Kur e shkoj nëpër mend për ç'ideale luftuam dhe u katandisëm në këtë batak më vjen të pëlças. Kujto si i zbërthenim parimet e rendit socialist: Fabrikat punëtorëve, toka fshatarëve, liri, drejtësi, barazi, shpërndarja e të mirave materiale në bazë të mundit e të djersës. Sa të punosh, aq do të marrësh. Socializmi e gropos një herë e përgjithmonë shtypjen e njeriut prej njeriut. Në socializëm do të mbretërojë vetëm drejtësia e pastër njerëzore. Duke punuar natë e ditë, do të ndërtojë socializmin që është kapërcyelli për në komunizëm... Pse me dallaverexhinj, me kodosh moralë e politikë, me teknokratë e hilexhinj që kullufitin ç'ka prodhon punëtori e fshatari u shkoka në komunizëm!...

U bezdisa nga ato filozofime që i kisha kaluar kushedi sa herë nëpër mend, prandaj ndërhyra:

— Je penduar pse nuk iu nënshtrove kësaj kaste që var në kanxhë lëkurën e qingjit dhe shet mish qeni? Ose më saktë, ke hequr dorë nga fjala e mençur: Padrejtësia më e pakapërdishme shënon momentin kur virtyti detyrohet t'i kërkojë ndjesë vesit?

— Po, kam hequr dorë, — gjegji Dragomiri, — megjithatë e pësova siç i thonë asaj fjale: Jep një pare, hyn në valle; jep njëqind e nuk del dot....

— Po më vjen keq që nuk i ngjake më vetvetes.

— Po ti, je ai që ishe? — pyeti Dragomiri.

një herezi tek ne. Për vajtjen time në kishë u thurën aq thashëtheme, sa më akuzuan si spiun i klerit bullgar. UDB-a, që ka më shumë bashkëpunëtorë, sesa uzinat punëtorë, nëse merr urdhër nga Beogradi, edhe perendinë mund ta gozhdojë në bankën e të akuzuarit duke i nxjerrë dëshmitarë të fabrikuar e papagallë...

— Si agjent të klerit bullgar të dënuan?

— Jo. Së pari më përjashtuan nga partia si besimtar. Pastaj më pushuan nga puna. Isha i fejuar. Ajo, nën presionin e UDB-ës, u nda duke shpifur sikur qenkësja impotent. Më ndiqnin çdo hap. Më dërgonin spiunë, të cilët shtirreshin si miq dhe më propozonin të arratisesha në Bullgari. Në rrugë më gjuanin me gur njerëz anonimë. U mbylla në shtëpi. Jetoja strese të tmerrshme. Për t'i shpëtuar sëmundjes nervore, u shtrova në spital. I bindur se do të më arrestonin, bëra atë që bëra dhe më sollën në këtë psikiatri.

— Flejmë tani. Natën e mirë! — i thashë.

— Mos ma merr për keq, nëse të kujtoj një këshillë leniniste «Beso, kontrollo!», — ma pati Dragomiri.

— Edhe ti, mos m'u zemëro që po ta përmend parullën në vargje me të cilën hidheshin në flakat e betejave: «Lenin, Stalin/Pa ju bota s'ka shpëtim...» — ironizova unë.

Dragomiri qeshi me lotë. Mua m'u rënduan qerpikët.

Të nesërmen në mëngjes i thashë gjeneralit se Dragomirin e kishin persekutuar aq keq psikologjikisht, sa ai mund të kthehet në një të sëmurë nga fiksacionet. Gjenerali kërkoi shpjegime, unë i kallëzova vetëm një diçka:

— Dragomiri ka qenë i fejuar. UDB-a e ka manipuluar vajzën. ajo është ndarë nën pretekstin se ai ishte impotent. Kjo gjë, me sa hetova unë, e rëndon përsëtepërmi gjykatësin tonë.

— Ia fashitim ne këtë brengë, — tha gjenerali dhe këmbënguli të organizonim një bisedë me Dragomirin.

Të tre u takuam tek ish garderoba, një kthinë në hyrje të pavionit. Gjenerali na ofroi pije. Unë piva, Dragomiri nuk e afroi te buza. Gjeneral Sharanoviçi filloi nga qyfyret e akademisë ushtarake. Pastaj iu drejtua gjykatësit:

— Dragomir, ti pijeve nuk ua thënke. Nuk besoj të mërzitësh me bisedat tona. Ne, si ushtarakë, kur s'ka luftë, duhet të merremi me diçka, meqë i kemi qejf femrat, merremi me to. Do të të njoh me një ndihmës mjeke, të cilën, po e puthe, të ulet në prehër. Se, që ta dish ti, ky divi ma

kalon mua në njohjen e femrave. Ka femra që ngjasojnë me hijen. Hija, kur e ndjek, ikën. Kur ia kthen shpinën, të ndjek. Ka të tjera, të cilave po ua tregove portofolin e fryrë, të tërheqin përdore drejt shtratit. Janë disa, që po i preke drejt e në vendin më delikat, ndizen flakë dhe të jepen në vend. Ndonjëra gjen kënaqësi vetëm nga puthjet. Ka të atilla që pa zhvilluar paralojë gati dy orë, kurrë nuk mbeten të kënaqura...

Atë çast trokiti lehtë dera, doli gjenerali. Pas pak u kthye, më thirri:

— Major, me ne të dy kanë një punë filozofi dhe sociologu, — pastaj iu kthye gjykatësit, — na prit këtu. Kthehemi shpejt!

Dhe, sapo u larguam, ktheva kokën, vëreja se në ish garderobën u fut një femër. E njoha. Ishte Zdravka. Më erdhi shumë keq që gjenerali kishte zgjedhur pikërisht atë për ta dëfryer Dragomirin. Pastaj më shkoi mendja për keq:

«Mos ajo bushtër ia nxjerr ndonjë fjalë gjykatësit të gjorë... E njeh gjenerali cila është Zdravka, po sikur...»

— Emrush Vushtrija të vijë për vizitë! — thirri Balashja nga pragu, i pavionit.

U ndava me gjeneralin me këto fjalë:

— Kur të kthehem, do të bisedojmë shtruar. Dragomir Nishlia nuk e ka hak t'ia punosh asisoji...

— Ç'ia punova, mor tuhaf! — ma pati gjenerali i habitur.

Tek po ecja drejt daljes, e pashë Dragomirin që doli vrrik nga kthina.

«Nuk ia hedh lehtë gjykatësit. — thashë i kënaqur unë dhe u takova me Balashen. Ecëm përgjatë koridorit. Ajo, gjoja më mbante për krahu, ma pickoi disa herë llerën. Dhe, duke më vështruar me sy të perënduar, tha: «Kush shtrohet një orë në krevat me ty, e ka të vështirë t'ia hedhë sytë ndonjë mashkulli tjetër...» Kushedi ç'do të më përalliste, po të mos kishim mbërritur përpara portës së zyrës së Jadrankës. Balashja hapi portën dhe më la vetëm për vetëm me Jadrankën.

— A e di përse të thirra? — pyeti psikoterapistja pasi u ngjatjetuam.

— Për të më treguar se vendi i punës i ngjan tryezës së ngrënies. Ku ahahet, nuk kryhen nevoja të tjera., — ia kujtova parimën të cilit i përmbahej ajo.

- Jadranka qeshi gurgullueshëm, pastaj tha:
- Të thirra se më mori malli.
  - Vetëm kaq? — e pyeta.
  - Pak të duket?!
  - Pemë pa kokrra... — thashë unë.
  - Më ka dërguar letër Gurgureviçi, nga Marshalata,
  - tha Jadranka dhe nxori letrën nga sirtari.
  - Kërkon të më bësh xheloz? — pyeta unë. —
  - Ku të vete mendja, — ma ktheu doktoresha, — ai është burrë i martuar, ka tre fëmijë.
  - Më i rrezikshëm i provuari, sesa i dëshëruari, — bëra hoka unë.

Jadranka filloi ta lexojë letrën në heshtje, fytyra iu mbulua me një hije serioziteti mpleksur me shqetësim. Vuri gishtin mbi një pasazh dhe lexoi:

«...Letrën tënde e lexova me vëmendje, — më shkruan mua, sqaroi doktoresha dhe vijoi: — Për transferimin tënd në njërin nga spitalet e Zagrebit, do të bëj çmos të të ndihmoj. Por ti më kishe vënë një kusht për të ndërhyrë që të lirohet nga spitali Emrush Vushtrija. O e bija e mi-  
kut tim të ngushtë, përpiqu të më kuptosh drejt. Në Kosovë po përgatiten ngjarje që nuk mund t'i evitohj kushdo. Emrushi është mirë në spitalin e Nishit. Po të kthehet në Prizren në këtë situatë, kushedi ç'mund t'i kurdisin. Janë probleme që, edhe sikur të përpiqesha, nuk do të arrija të bëja asgjë, veçse të merrja më qafë veten. Atij ia kam borxh jetën. Prandaj pyete, nëse pranon të vijë me ty në Zagrab. Këtë mund ta rregulloj. Ndryshe të qëndrojë atje ku është, sa të kalojë rrebeshi në Kosovë...» Jadranka ndërpreu leximin, më vështroi në dritë të syrit dhe më pyeti: — Ç'i thua kësaj?

Pas një heshtjeje të zymtë e të menduar, ia ktheva:

— Sikur ta priste një tragjedi Kroacinë tënde, ç'do të bëje, ti, doktoreshë?

— Nëse prania ime atje do ta evitonte tragjedinë, nuk do të arrinte të më pengonte as plumbi i pushkës, — gjegji Jadranka.

— Pamja përputhet me shpirtin dhe me karakterin tënd, — i thashë.

— Mirë, Emrush. Mendohu! Veç ta kesh parasysh një gjë, unë nuk do të lejoj të lëshohet fletë-lirimi për ty. Edhe

vetë nuk do të lëviz nga ky spital, pa u pjekur kushtet që të kthehesh në Kosovën tënde, — tha Jadranka dhe, dukët, nga që lexoi pezmë në fytyrën time, shtoi: — Pa e pirë limonadën e premtuar në banesën time dhe vetëm për vetëm, nuk ndahemi bashkë.

— A mund të kthehem në pavion? — pyeta, sepse njoftimi i Gurgureviçit më goditi si bombë. «Eh, Kosovë, — mendoja me vete, — luftuam, u gjakosëm, të çliruam, të dorëzuam në duart e një qeverie më terroriste në botë. Ti ke të drejtë të na mallkosh. Dhe mos na e falë kurrë!»

— Nuk mund të të lë të kthehesh në pavion kështu të ngashëryer, — tha doktoresha me timbër dridhërues. — Prit. Do të shkojmë në banesën time. Kam verë të mirë.

— Falem nderit! Në kushte të tjera, do ta ndjeja veten të lumtur dhe krenar për ftesën e një njeriu që ka zemër të madhe e fisnike. por sot jo. Dua të kthehem në pavion, — thashë dhe u nisa.

Jadranka më përcolli deri te porta e pavionit, atje më përqafoi dhe u ndamë.

Tërë ditën qëndrova shtrirë mbi krevat, i kredhur në dëshpërimin tim.

— Mos të ndëshkuan për rrahjen e atyre dy karagjozave? Më pyeti dy-tri herë Radomiri dhe, si e pa që nuk kisha dëshirë të flisja, u kthye përmbys mbi krevatin e vet. Ndërkohë erdhi gjenerali, u ul pranë meje. Koleg, tha ai, eja t'i derdhim brengat në gëzime! Dhe nxori një shishe petashuqe nga xhepi i pizhamave. Qenka e thënë ta ujis helmën me helm, mendova unë dhe ndjeva ngasje për të pirë. E ngrita shishen. Ishte shlivë e pjekur dy herë. Kur e mbaruam, gjenerali tha:

— Eja në shtabin e disidencës, — dhe më çoi në atë-farë kthine që dikur kishte shërbyer si garderobë e pavionit. U hutova. Atje kishte me shumicë nga të gjitha llojet e pijeve. Pas pak erdhën filozofi, sociologu dhe një historian. Ia shtruam me pije. Dikur trokiti lehtë dera.

— Kanë nuhatje të stërvitur bushtrat, — tha gjenerali dhe e hapi derën. Hynë dy infermiere. Gjenerali i qëlloi në prapanica dhe u tha: — Nuk e shikoni që jemi pesë veta! Zhdukuni! Pa i gjetur edhe tri shoqe nga ato që ia thonë edhe pijes, edhe mikut, mos t'ua shoh syfetin! Hajt, shikoni në vilën e ishullit dhe na i përgatisni të gjitha!

— Katër ju mjaftojnë, — ndërhyra, — unë nuk kam disponim të mirë sot.

— Don Zhuani i paska kaluar me sukses provat e ri-  
edukimit, — u hokarit gjenerali duke shoqëruar fjalët me  
atë të qeshurën e vet bubulluese, pastaj u tha tre shokëve  
të vet: — Ka qenë kampion për grabitjen e zemrave të  
femrave.

— E kam me gjithë mend gjeneral, — i thashë unë  
hundë e buzë, — sot më është prishur humori.

— More, që s'ie në të sot, e shikoi. — tha gjenerali.  
— qëparë desha të të nves, nërse të thirrën në drejtori?  
I trego vëllait tënd ti! Nëse të kanë qortuar për atë zën-  
kën e niëditëzajt, mos çaj krye. Për ty hedh në erë psikia-  
trinë. Pi! — pastaj ua zgjati një shishe verë infermiereve,  
i nduku nëpër vithe dhe i tha njerës që ngiante me mulate  
fort të bukur e të këndëshme: — Ti cigania ime, vetë e  
nesta të shkosh e të na përgatitësh tryezën në vilën e ishul-  
llit! Kuides në zgjedhjen e së pestës, se ky zhdërhaja është  
qejfli, por saimatar!

— Si urdhëron, zoti gjeneral, — përshëndetën ushta-  
rakisht dy femrat dhe u larguan.

— Çoje me fund, — më tha gjenerali duke ma zgja-  
tur një gotë të madhe, pastaj rrëfëhu përpara shtabit ma-  
dhor të pavionit të disidentëve! — dhe si u krekos si ush-  
taraku përpara mësymjes, shtoi: — Major Bumja, qysh kë-  
të minut zgjidhesh anëtar me cilësinë e komandantit të  
gardës së shtabit tonë suprem.

Filozofi, sociologu, historiani aprovuan me ngritjen e  
duarve. Më jehoi thënia e Dragomir Nishlies i cili për gje-  
neralin më kishte thënë: «... është problem me shumë të  
panjohura...» Pas një heshtjeje përvluese, ua hodha një sy  
shisheve. Sociologu e kapi atë vështrim pyetës, sqaroi:

— Gjeneral Sharanoviçi, veç postit të komandantit,  
është edhe investuesi i kësaj begatie për ne «eksiqët» që  
po bëjmë jetë kralësh në këtë institucion të pamendësh.  
Mua s'më mbetet gjë tjetër, veçse të studioj dhe të fiksoj  
në letër dukurinë që e karakterizon këtë grup pjestarët e  
të cilit regjimi i përndjek dhe i përgjon si të rrezikshëm.  
Ne bëjmë pallë duke korruptuar më besnikët e këtij aparati  
policor me ndihmën e bankës së gjeneral Sharanoviçit.

— Gjenerali më ka treguar qysh kur ishim studentë në

akademinë ushtarake në Gjermani se rridhte nga një familje e pasur, por jo bankierësh... — thashë me qëllim të caktuar.

— Pasuritë e babait të gjeneralit janë hiçkurrë në krahasim me ato që ka sot Sharanoviçi, — tha sociologu.

— Ndoshta jam i trullësuar nga lajmi që mora sot prej familjes, ndaj s'po kuptoj nga i pikoi kjo kamje gjeneralit? — thashë unë.

— Çojë edhe një gotë, — tha gjenerali dhe vazhdoi: — Ti Vushtrija, apo Major Bumja, ishe numri një për t'ua grabitur zemrën femrave, por vetëm nga pamja jote prej bukuroshi dhe nga trupi prej kolosi. Kurse unë qysh si student, si bir tregtari gjurmoja dhe zgjidhja dashnorët sipas leverdisë së xhepit....

Unë ngrita supet. Filozofi shprehu bezdinë përse humbim kohën duke u marrë me historinë e së shkuarës, për më tepër kur na priste një mbrëmje e cila do të flakte në mospërfillje hallet e jetës. Megjithatë, sociologu me atë vështrimin e prehtë, nuhati se unë kërkoja sqarime, ndaj shpjegoi:

— Pajtohem me profesorin e filozofisë, zotin Nedelko, megjithatë ju kërkoj ndjesë, do t'i tregoj Major Bumjes vetëm ca hollësira: Gjeneral Sharanoviçi, si student në akademinë ushtarake në Gjermani, ia fiton zemrën së bijës së një industrialisti të madh që prodhonte armë për ushtrinë hitleriane. Pas katastrofës së Rajhut të Tretë, industrialisti që kishte depozituar paratë në bankat e Zvicrës, u arratis bashkë me familjen në Amerikë. Tërhoqi depozitat nga Zvicra. Sot është miliardë. Vajza e industrialistit, së cilës i la mbresë të pashlyeshme gjenerali ynë, nuk i shkëputi lidhjet. Beson se Sharanoviçin do ta ketë bashkëshort të nesërm. Gjenerali nuk është tuhaf që të mos mirëpresë një martesë të tillë. Prandaj ajo për çdo muaj i dërgon shuma të mira dollarësh.

— Paskan pasur njëfarë argumenti ata që të akuzuan si agjent në veprim të CIA-s, — i thashë gjeneralit.

— Pallavra! — ma bëri gjeneral Sharanoviçi duke prerë ajrin me dorë. — Gjithçka mund të bëhem, spiun jo. Të pijmë! Gjatë kësaj kohe na trego përse të thirrën në drejtori.

— Më erdhi për vizitë një bashkëfshatar dhe më solli lajme fort të hidhura, — gënjeva unë.

— Pa hë, çfarë lajmesh? — pyeti filozof Nedelko.  
— Për Kosovën përgatitet një terror, — thashë unë.  
— Domsodo, e kam parashikuar një konflikt të mundshëm, — tha historiani gjashtëdhjetëvjeçar, — Kosovarët kërkojnë të pamundurën. Vërtet gjallojnë dokumente të lashta që vërtetojnë se shqiptarët janë autoktonë në trojet e tyre, madje si pasardhës të fisit Ilir të Dardanëve; por ka edhe kundërtënie me peshë. Ende nuk i është dhënë përgjigje pyetjes nëse dardanët ishin ilir, apo dakë. I rëndësishëm është fakti se në Kosovë gjallojnë tërë ato manastire pravosllave serbe. Kosova është edhe djepi i mitologjisë së popullit serb. Kujtoni epopenë në vargje aq të gdhendura të Betejës së Kosovës të 1389...

— Sa u përket kishave e manastireve pravosllave serbe në Kosovë, — ndërhyra unë, — ato i ngjajnë gozhdës së Nastradinit që e nguli në murin e shtëpisë së tjetërkujt, vari qyrkun dhe e nxori pronarin në gjuq duke thënë: Po të mos ishte imja shtëpia, ç'kërkonte kjo gozhdë dhe qyrku im varur në këtë mur? Sa i përket epopesë në vargje për Betejën e Kosovës, në visaret e folklorit shqiptar, te lahutarët tanë brez pas brezi këndohet ajo rapsodi. Ne jse për këto është folur dhe është shkruar e do të shkruhet. Të vijmë te fakti: Prej kujt banohet Kosova. T'i hëdhim një sy Luftës Nacionalçlirimtare. Promotorët më të mëdhenj të saj gjatë luftës, nëpër fjalime, tubime e konferenca u shprehen se pas dëbimit të okupatorit, secili popull do të vetëvendosë me vullnet të lirë. Se socializmi nuk njih shtypje të një populli nga një popull tjetër...

— Më mirë se ia kemi pirë lëngun ne të pestë këtij farë socializmi jugosllav specifik, nuk ia ka shijuar askush tjetër, — ndërhyri filozof Nedelko, — Fill pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Stalini, kryekreu i kampit socialist, u tha udhëheqësve rumunë: Bashkimi Sovjetik ndërton socializmin, edhe ju gjithashtu, por Moldavia i përket shtetit Sovjetik dhe e uzurpoi ...

— Por ne e pamë cili ishte Stalini dhe i treguam vendin, — ironizova unë, — tashti nuk duhet të ndjekim politika antinjerëzore dhe antikombëtare kundër popujve të tjerë. «Ndërtojmë socializmin e vërtetë», prandaj e quajmë specifik....

— Ah ne, — më ndërpreu filozof Nedelko — kush na pyet ne! — Kam kryer studimet në shkollën e lartë



«V.I. Lenin», në Bashkimin Sovjetik. Jo vetëm si student tepër i zellshëm, por edhe si adhurues i kuturisë kisha bindje prej fanatiku se vetëm komunizmi do ta shpëtonte shoqërinë njerëzore...

— Pikërisht ky profesor Nedelko, sa ra ndesh me fazën e parë të komunizmit, domethënë me socializmin, — tha gjenerali — filozofi ideator u kthye në dezertor...

— Të lexosh teorinë marksiste-leniniste, — ndërhyra unë, — krijon bindje se i vetmi shpëtimtar nga shfrytëzimi i shoqërisë njerëzore është rendi socialist. Zatën, të hipnotizuar nga ajo teori, gati mbi gjysma e botës u përfshi nga flakët e revolucioneve socialiste. Por një fjalë e urtë thotë: Me të thënë e me të bërë, shkon përmes një lum i tërë... Kisha krijuar një çetë patriotësh të viseve të mia dhe jetonim maleve duke luftuar kundër pushtuesve, — vazhdova pas pak. — M'u afruan komunistët. Njëri sy-rësh më tha: «Komunizëm do të thotë të zbulosh të gjitha të mirat e natyrës dhe t'i vësh ato në dobi të shoqërisë njerëzore. Komunizëm do të thotë të zbulosh njeriun, mundësitë e tij të mëdha për të prodhuar, shpërndarë dhe jetuar me barabarësi e në harmoni shoqërore...» Ai shok më la edhe disa libra. U binda dhe bashkë me çetën u bashkova me nacionalçlirimtaren. Tashti po e kuptoj mirë ku na katandisi ky farë sllavokomunizmi...

— Politika më është neveritur dhe m'i ngre nervat, — ndërhyri Sharanoviçi, — sonte kërkoj të pijmë e të dë-frehemi.

U ndërpre në fjalët. Pimë në heshtje.

Nga ora dhjetë e natës erdhi infermierja që ishte më e këndëshme se çdo mulate, njoftoi:

— Darka në vilën e ishullit është gati sipas porosisë...

E vështrova me vëmendje. Të përpiqeshe t'i gjeje goftë edhe një cen sa për kontrast me bukurinë e saj, do të të shkonte munda kot... Mbi të gjitha, kishte një vështrim që, siç i thonë fjalës, edhe në shtratin e agonisë të zgjonte lakmi.

— Hej ti, pirat i zemrave, — m'u drejtua gjenerali me nofkën, siç më thërriste në Gjermani, — për ty i bëj fli të gjitha vajzat e psikiatrisë, ciganen e kam për vete.

Sociologu u ngrit, doli nga kthina. Pas pak u kthye dhe i tha gjeneralit:

— Sharanoviçi, gjithëcka në rregull për ta filluar «festimin».

Gjenerali hapi një valixhe. Mbasi shpalosi dy-tre kostume, njërin e ndau dhe ma zgjati duke thënë:

— Vetëm ky bën për ty, div, që je rritur duke qitur në harresë shekullin e krizës...

E veshja, më binte tamam. Por këpuçë nuk mund të gjendeshin për këmbët e mia të mëdha. Gjenerali m'i zgjati një palë galloshe. I mbatha. Ndërkohë, të gjithë prisnin të veshur e të gatshëm për nisje. Përgjatë koridoreve asnjë mjek, asnjë sanitaroboksier, apo infermiere. Te porta kryesore gjenerali i dha rojes së armatosur një pesë dollarësh. Tjetri e puti bankënotën me lakmi trullësese, u përkul sa nuk iu ngjesh hunda krute mbi dhe. Pas temenasë, na e hapi portën dhe na shoqëroi deri te automobili «Shevrolet» që na priste në rrugën prapa spitalit. M'u shfaq vegimi i Marës. Tërë kohën në çmendinë e Nishit, shëmbëlltyra e saj më shfaqej zgjuar dhe në gjumë, ajo më kthehej në aktpadi. Duke ngritur gishtin kërcënueshëm, sikur më thoshte: «Vetëm lulja e truallit të mëkon me lëng jete...».

Automobili rrëshqiti rrugës gati pa asnjë zhurmë. Pas pak u gjendëm jashtë qytetit, pastaj hymë në një park, apo pyll, nuk e përcaktoja dot. Në të dy anët e rrugës lartësoheshin drunj degëharlisur me një gjelbërim të mbyllur. Nga larg pashë drita që rrezatonin nga dritaret dhe spërkatnin si me purpur gjethet e lisave rreth e qark. Sa mbërritëm, mora vesh cila quhej vila në ishull. Ishte një shtëpi e vetmuar tip vile, jo midis detit, as midis ndonjë liqeni, por e qerthulluar nga lisa të gjatë. Vila kishte shumë dhoma, të gjitha llamburisnin nga llambadarë me drita të llojllojshme. Vajza të cilën gjenerali e quante Cigane, na priti dhe na shoqëroi për në sallonin e ndritshëm. Atje na prisnin edhe katër vajza të tjera. Midis tyre një flokëpruar, belëkëputur. E pashë me sy të çakërritur. Në fillim m'u duk si kipc i asaj që kisha parë nga kuvlia e xhamtë. Pikërisht për flokëpruarën më kishte thënë Balashja se ishte spiune si edhe Zdravka dhe ajo stërhellja gati dy metro e gjatë që joshnin të sëmurat në orgji në pavionin e femrave. «Sa i ngjaka, thashë me vete.»

Bukuroshja flokëpruar hetoi zhbirimim tim, iu ravijëzua një buzëqeshje timide, pastaj, e bezdisur ngaqë nuk ia ndaja vështrimin, bëri një lëvizje padurimi, fustani i saj dekolte u valvit. Dolën në pah këmbët ftillake,

gjoksi dhe qafa e lëmuar dhe e bardhë si e mjellmës.

Gjenerali më prezantoi, për secilën prapashtonte nga një epitete. Kur arriti te bukuroshja flokëpruar, tha:

— E quajnë Rozika Farkash, hungareze, njëzetekatër-veçe. Perëndia ia ka dhuruar dy cilësi të kundërta njëhënjësh: bukurinë, që po e shikoni vetë, dhe mendjemadhësinë që nuk e fshihka dot. — Pastaj më çuquriti në vesh: «Këto të dhëna i kam nga Amada, ndryshe, për herë të parë po e shikoj. Kush është Amada? — e pyeta unë. Cigania, gjegji gjenerali.»

Zumë vend rreth një tryeze rumbullake midis atij salloni të madh. Rrëzë mureve të sallonit ishin vendosur kanape të veshura me cohë bojëroze.

Gjenerali u tha vajzave që prisnin në këmbë:

— Ti, Cigania ime, ulu pranë meje! Ju të tjerat zgjidhni kavalierët sipas dëshirës!

Siç turret shqerra e dashuruar pas dashit, ngarendi bukuroshja flokëpruar dhe zuri vend pranë meje. Vura re se nuk ishte kipc i asaj që kisha parë në pavionin e grave, por shoqja e Zdravkës, dora vetë». Ky aheng qenka me avaze, — mendova me vete.»

Gjenerali qeshi bubullueshëm dhe tha:

— Major Bumja, ta kam zili, — pastaj të tjerëve: — Edhe si student në akademi, shorti ia ruante kafshatën më të mirë... Prandaj u nguta dhe timen e ula pranë vetes. Ky është i vetmi që ia kam frikën sepse më sfidon dhe e ka të sigurt fitoren.

Secila prej tri vajzave të tjera zgjodhën partnerët e tyre, por më vështronin mua. Gjeneralit nuk iu durua pa i pyetur vajzat:

— Bukuroshe, më tregoni, përse ia keni qepur vështrimet Major Bumjes. Jua gudulisen kureshtjen fjalët që thashë për të, sepse është sefte në shoqërinë tonë, apo ju magjepsi me shikimin e parë?

Katër të tjerat u kakarisën me naze, bukuroshja flokëpruar tha:

— Unë e kam parë edhe herë tjetër Majorin. Ky ka përndezur gratë e një pavioni, — dhe ma vuri dorën mbi gju.

Cigania i tha gjeneralit:

— Sipas porosisë suaj desha të zgjidhja një vajzë nga dora jonë, por Rozika, kur mësoi se midis nesh gjendej

edhe Majori, me ngulmim kërkoi dhe erdhi. Mua nuk ma priste mendja se edhe ajo...

— Çudi, — tha filozofi, — kushedi sa herë e kemi kërkuar, i jemi lutur, madje edhe kundrejt një shpërblimi jo dosido, kjo nuk ka denjuar....

— Siç duket, Rozika u nënshtrohet vetëm urdhërave të padronëve të vet.... — thumbova unë, ngaqë m'u faneps shembëlltyra e Marës dhe krahasimi ishte aq i shpërpjes-tuar sa askush nuk mund të barabitej me prizrenasen e dëlirë.

— Ah! E dija... Pikërisht këtij pickimi iu druajta, kur iu luta Amadës të vija në këtë mbrëmje, — tha (e bërë all në faqe) bukuroshja flokëpruarar.

Unë u binda përfundimisht se ajo ishte hungareze, jo aq nga ndonjë shqiptim i mangët i serbokrotishtes, sa nga nuancat melodike në ligjerim, që është veçori e gjuhës së atij populli.

Ndërsa gjenerali na përshëndeste me dollari në dorë, historiani, paçka se plakarec, njerën dorë e kishte futur midis shalëve të topolakës simpatike që i kishte rënë për hise, me dorën tjetër çante kofshën e patës si halldup.

U ngritën dollitë e para, u pinë edhe të dytat, katër çiftet tjerë, ngaqë kishin kaluar orgji të tilla gati në çdo tri net dhe ia njihnin dëshirat dhe huqet e njëri-tjetrit; putheshin, çuçuritniñ gojë më gojë, përmendnin mbresat e netëve të mëparshme. Vetëm unë dhe flokëpruara Rozikë qëndronim si dy zogj që stuhia i ka përplasur mbi drekun e ndonjë anije në oqeanin e dallgëzuar. Edhe sikur të më përvëlonte dëshira për ta ulur në prehër atë bukuri të rrallë, nuk mund të veproja në sy të të tjerëve. Menermekon njeri nga prapa, kapsallitem në vend. Dashuria për njerëzit, përveç nevojë fiziologjike, është ndjenja më sipërcejnë femrave të tyre në mes të tufës, në sy të të tjerëve. Katër shokët e pavionit tim, sidomos historiani plakarec, me ofshet e tyre të harlisura, më kujtuan derrat kur ndicej në dosave.

Faqet e flokëpruarës Rozikë i ishin bërë prush, sytë e kaltër i shkrepëtinin. Ajo përpushje shpirtërore e saj më ofronte dy hamendje: Hungarezja kishte respekt për vet-

veten dhe e dinte sa e lakmuëshme kishte qenë për të tjerët; Së dyti, ajo ishte aq dinjitoze sa zor të duronte më tej mospërfilljen time.

Pas një mëdyshjeje të ndrydhur, ajo më pëshpëriti:

— A më lejoni t'u marr lejë zotrinjve të kthehem në pavion?

Ato fjalë, të shoqëruara me frymëmarrje të çrregulltë dhe aritmike, duhej të më bënë më të mirësjellshëm dhe më të dhemshur. Mirëpo dyshimi se ajo ishte bashkëpunëtoresh e UDB-së si edhe Zdravka më kishin bërë naks dhe zemërgur, ndaj iu përgjigja në mënyrën më mospërfillëse:

— S'ka nevojë t'i kërkonti lejë kurrkujt. Nuk më mbetet hatri të largoheni nga kjo mbrëmje, që duket e huaj si për ju, ashtu edhe për mua.

— Do t'ju lutem të më plotësoni një kërkesë, qoftë edhe sa për kortezi, — tha flokëpruaruara Rozikë.

— Ma thoni kërkesën, për hir të respektit që kam për popullin hungarez, do të përpiqem t'ju ndihmoj, — i thashë.

— Të më përcillni jashtë kësaj vile, — tha Rozika flokëpruar, pastaj shtoi e menduar: — Nuk më bëhet vonë ç'mund të thonë për mua këta kavalerë të harbuar, mbase këmbëngula dhe erdha këtu me vullnetin tim. Puna është se dua t'i këmbëj dy-tri fjalë me ju.

Brofa duke ia futur krahun. Të tjerët, mbytur në ofshet trullësese, as morën vesh kur u larguam nga salloni.

Sa u gjendem në oborrin e vilës midis lisave degësh-kapërderdhur, vura re se Rozika po qante mbyturazi. E mbërtheva prej supesh dhe e ktheva drejt vetes. Megjithëse midis meje dhe Rozikës u fut vegimi i Marës, unë e shtrëngova ethëshëm.

— Jo, jo, të lutem jo. Kjo ma lëndon edhe më keq pezmin, — tha Rozika dhe mbuloi fytyrën me pëllëmbë, ashtu siç veprojnë vajzat e reja kur duan të mbrohen nga puthja e ndonjë çapkëni.

— Mos u druani për asgjë, — i thashë, — të ktheva drejt vetes se nuk duroj ngashërimita.

— Mirë, — tha ajo dhe eci përpara duke fshirë lotët. U ul në një bankë pranë shatërvanit që nxirrte currila nga sqepi i një figurine orrli me flatra të kreshpëruara. Zura vend pranë saj.

— Siç tha gjenerali, jam hungareze nga Subotica... — Nuk më pëlqeu që Rozika e filloi me biografi, megjithatë e dëgjova me vëmendje, — Jam e bija e një tregtari të madh të para luftës. Si mbaroi lufta, babai u arrestua dhe u pushkatua nga organet e diktaturës së proletariatit, i akuzuar si «ratni bogatash» (paskanik i luftës), anise pikërisht lufta ia kishte sjellë dëmet më të mëdha financiare. Nënë e kam gjermane, nga ato të Vojvodinës. Ajo e kishte mësuar mirë sërbshten mbasi i shërbente babait edhe si përkthyes në allishverishet afariste. Kur mbetëm vetëm ne të dyja (unë isha fare e vogël) nëna e ndërroi emrin nga Gertrudë në Gordana. Pasurinë na e kishin konfiskuar, por nëna kishte para dhe nuk kishte pak. U transferuam nga Subotica në Novi Sad. Mirëpo atje na njihnin, prandaj lamë Vojvodinën dhe u vendosëm në Beograd. Nëna, megjithëse ka kryer dy fakultete, e zotëron disa gjuhë, nuk gjeti dot punë deri vonë. Me pasurinë në para që kishte e rregulluam disi jetën. Synimi im ishte të arratiseshim në atdheun e babait në Hungari. Mirëpo nëna kundërshtonte duke thënë se Hungaria sundohet nga Rusia. Kështu mbarova shkollën e mesme dhe të lartën për laborante farmaceutike. Më emruan në këtë psikiatri. Nëna nuk pranoi të vinte, sepse i ka alergji qytetet që kufizohen me krahinë josllave, kundër të cilave Beogradi përgatit plane terrori, dëbimi ose asimilimi. Më tha: Shko ti. Do t'i shes edhe stolitë e çmueshme, të të tërheq në Beograd. Pastaj shohim e bëjmë. Mendja i rreh për në Gjermaninë Perëndimore. Thotë se atje do të zhvillojmë një afarizëm dobiprurës. Ja, në këtë spital bëj analizat e gjakut dhe përgatis qetësues sipas diagnozave të të sëmurëve psikikë. Farmak më pikon shpirti, sepse nga drejtorja e pavionit të psikopolisindromës më sjellin receta antinjerëzore. Jo për t'i shëruar të sëmurët, por për t'i çmendur të shëndoshët. I tillë paska qenë fati i fëmijëve që e jetuan Luftën e Dytë Botërore në këtë bashkësi dobiçe të Jugosllavisë Federative. — Dhe si u mbush frymë si notari kur del nga ndonjë zhytje e thellë, tha: — Këtë hyrje të gjatë e bëra, për të ardhur të thelbësorja, për të cilën ju luta të më shoqëronit. Femrat do të qëndronin ku e ku më lart se meshkujt, poqese nuk do të ishin më tepër se sa duhet llafazane. Qysh se keni ardhur ju në psikiatri, gumëzhinte spitali, vetëm emri juaj mbahej në gojë. Sidomos kur ju dërguan në

kuvlinë e xhamtë, u tha se kanë sjellë një burrë, përballë të cilit Gregori Peku mbetet një hiçkurgjë. Flisnin ndih-mësmjeket, infermieret, doktoreshat, të gjitha. Të isha edhe prototipja më sterile e flegmatikut, zor t'u shpëtoja ngasjeve që më ndillnin ato biseda. U përpoqa të gjeja ndonjë mundësi për të vajtur në pavionin e femrave, nga dukej si në pëllëmbë kuvlia e xhamtë, siç thoshin shoqet e shërbimit; mirëpo atje shkohej vetëm me vizën e drejtor Meleviçit. Atë ditë, e mallkuar qoftë, kur psikoterapiste Jadranka mblodhi tërë personelin dhe na tha se kërkonte më të bukurën, madje u shpreh kështu: Dua një mis të personelit të psikiatrisë, mbasi rrekem të përcaktoj disa diagnostikime.... pastaj shtoi: Funkzioni i dyfishtë i kësaj përçapjes time është: të ndez tundimin tek të sëmurrat nga histeria dhe të përcaktoj drejt nëse një mashkull e kanë sjellë në këtë spital gabimisht. Emrin e mashkullit e dini, sepse tërë ditën e ditës këtu flitet për të. E quajnë Emrush Vushtrija...» Sa u përmend emri juaj, desha të paraqitesha vullnetarisht. Por mendimi se do të më merrnin si shoqet e mia për budallaqe që nëpërkëmbja virgjërinë për një trill (ndonëse unë nuk di në jam virgjëresha apo jo), më bëri të stepem. Jadranka, pas një vështrimi të përgjithshëm, drejtoi gishtin tregues dhe tha:

— Ju, bukuroshja flokëpruar... — unë bëra sikur nuk e kuptoja që po më drejtohej mua, — Me ju e kam, Rozika Farkash, — përsëriti Jadranka, — do t'i dalësh për zot këtij roli?

Atë çast thirrën femrat:

— Unë, unë, unë! — Jadranka m'u afrua. Unë pranova. Pa ditur se ato dy të tjerat ishin me funksione të dyfishta në këtë psikiatri. Erdha. Në atë maskaradë për të shuajtur kureshtjen e femrës tekanjoze sepse ju pashë. Nuk mund të mohoni, se edhe ju nuk ma ndatë vështrimin. Por, kur mora vesh më vonë cila ishte Zdravka dhe ajo stërhellja e gjatë që quhej Sllavica, më erdhi për t'i shkullur flokët...

— Falem nderit! — i thashë sinqerisht dhe pa asnjë prapamendim, — ma fashitët dhembjen e një shqetësimi. U binda jo nga fjalët, por nga mënyra si i shprehet ato, — dhe bëra përçapje ta puthja.

Rozika m'u shmang. Kapi çantën, e hapi, nxori diçka dhe tha:

— Gjithë ato pije e meze na kanë lënë aromë dhe shije jo të mirë në gojë, më lejo t'i avitem shatërvanit, — dhe me furçën e dhëmbëve në dorë iu afrua shatërvanit.

Mua m'u kujtua një hungareze që studionte për ndërlidhje në akademinë ushtarake në Gjermani, me të cilën pata relata dashurie. Ajo përpara çdo flirti dhe pas tij, kryente një profilaksi të rregulltë. Mbante peshqirë të posaçëm, dizifektant dhe gjithësa lypseshin për të tilla raste. «Eh, — thashë me vete, — e paskan traditë. Duhet të kesh respekt për të tillë popuj. Pastërtia trupore është mbi gjithçka për një femër...»

Flokëpraruara Rozikë, pasi pastroi dhëmbët, kontrolloi trupin dhe u bind se ishte adapte për kontakt dashuror, u kthye. Në vend të më hidhej në krah, pyeti:

— A je i bindur në vetvete se mund të shkëmbesh me meritë një ndjenjë të ëmbël me mua?

— Më së i bindur, — i thashë, jo me hipokrizi, por me bindje.

Më puthi në buzë. Pa e provuar puthjen gjermane dhe hungareze, njeriu, cilidoqoftë ai, do të gabonte, po të shkruante për një akt të tillë. Ato dijnë të të magjepsin.

Rozika më ndezi trupërisht dhe shpirtërisht. E rrëkëlleva mbi bankën ndanë shatërvanit. Kur e preka në pikën më delikate Rozika pshërëtiu:

— Jo, mos, jam me ato... jam me të zakonshmet. Rruaje këtë moment për një çast tjetër!

Ndonëse i njihja rregullat aq sterile, nuk mund të më ndalonte asnjë pengesë në gjenajen që jetoja. Vetëm kur e provova në akt, aegjova kintjen e lente të Rozikës, mora vesh se ajo më kishte gënjyer kur më kishte thënë se nuk dinte nëse ishte apo nuk ishte virgjëreshë. Paçka se ndodhesha në kapërcyellin midis ekstazes dhe parimeve vetjake të mosprishjes së virgjërisë, kur nuk kisha ndër mend të lidhja jetë bashkëshortore, Rozika ma ndezi epshin në atë farë feje, sa harrova parimet...

— Oh, oh, i dashur, — rënkoj Rozika, — e përfytyroja si gjënë më therëse .... Oh, oh... përcëllim dhe lumturi... oh, oh... dhimbje dhe kënaqësi.... oh, oh..:

Pas një ore u veshëm dhe u nisëm për në sallonin e orgjisë. Ç'të shihnim Katër çiftet, të zhveshur lakuriq, të kapërthyer, ta çapëluar nëpër kanapetë rrzë mureve, pu-



theshin, rënkonin dhe sërish putheshin symbyllur e të trullosur nga pija.

Rozikë flokëpraruara më tërhoqi në fund ' të sallonit. Atje gjendej një kthinë, e futur në errësirë. U shtrimë krah njëri-tjetrit. Rozika më puthi dhe më tha:

— Të lutem mos e provo veprimin e mëparshëm se më shkakton dhimbje. Kam dëshirë të më puthësh pafundësisht...

## MË VIZITON MARË GJINADARDA NË PSIKIATRI

*Vdekja do të ishte shumëfish më e shëmtuar, nëse nuk lëmë asnjë vepër, fëmijë, të afërm apo të dashur, të cilët nuk lejojnë të na e mbulojnë emrin ndryshku i harresës.*

**P**rej asaj nate të paharruar, Rozikën e thërrisja Flokëpraruara. Asaj i pëlqeu pa masë ai pagëzim, sapo ia mësoi kuptimin. Një natë, mu pranë shatërvanit në oborrin e «vilës së ishullit» më tha: «Dhëntë zoti, ia arrin nëna të më tërheq nga kjo vorbull lukunish, unë do ta zëvendësoj emrin Rozika me Flokëpruarar.

Aq fort më bëri për vete hungarezja, sa nuk më hyn-te në sy më asnjë femër tjetër, përveç Marës e cila më ishte kthyer në torturë, mes haresh të përditshme. Atë ftohtësi të papritur kundrejt femrave të tjera e kuptoi edhe psikoterapiste Jadranka gojëmbël, e sjellshme dhe e aftë për ta bërë për vete cilindo. Por çuditësha me të. Çështjet subjektive kurrë nuk ia errësonin arsyen sa të ndryshonte qëndrim ndaj njerëzve që nuk silleshin më si

dikur me të. Ishte aq e ekuilibruar, aq e zellshme në punën e vet studimore kuruese, sa të mendoje se nuk çante kryet për mospërmbushjen e dëshirave të veta. Unë për mirësjellje dhe për respekt, përpiqesha të sillesha si edhe më parë. Megjithëse intuitës së saj nuk i shpëtonte kurrëgjë, dukej më e kënaqur.

Të paktën çdo fund jave e kalonim në «vilën e ishullit» me grupin «skandaloz», siç e quaja unë pesëshën tonë. Flokëpraruara nuk kishte asnjë simpati për katër shokët e mi.

« Një mbrëmje, kur ishin dehur «skandalozët», historiani, i bërë tapë, i fliste topolakes simpatike: «Më kanë dënuar sepse u parapriva planeve të lavdisë serbe. Pas dënimit me burgim të përjetshëm, ngahera më vjen për vizitë një kolegu im nga akademia e shkencave të Beogradit. Në një rast më tha: «Ke të fala personalisht nga Marko. Më porositi të të qortoj dhe të të them se për pak u bëre varrimihës i planeve tona që i përkasin së ardhshmes së shpejtë: Duke shkruar dhe folur hapur mbi ato që do të realizojmë kur ta kemi situatën në dorë, ti paraqitje rrezik. Ndaj lypsej të të izolonim. Kësisoj i vumë në gjumë kundërshtarët. Ashtu vepruam edhe me oficerët e UDB-s që bënë kërdinë në Kosovë. Shumica e tyre gjenden në këtë psikiatri, por me detyra të caktuara. Do të vijë koha t'ju dekorojmë. Ju presin poste me rëndësi në të ardhmen e afërme...». Këto ishin fjalët e Markos. Kur të jem i madh, do të ndahem me gruan. Do të marthohem me ty... Akademiku që më viziton tashti për çdo javë, më erdhi edhe në burg. fill pas dënimit. Ai ma mësoi mënyrën si të vija në psikiatri...»

Flokëpraruara që e dëgjoi me vëmendje, më pëshpëriti:

- Vetëm dashuria për ty më sjell këtu, ndryshe...
- Përsë bezdisesh. — e ndërpreva unë.
- Nuk e dëgjove ç'fliste shtrigu?! Edhe të tjerët janë

si ky....

- Si janë të tjerët? — e pyeta.
- Gjenerali është mafioz. Filozofi, ngaqë ka dështuar, është kthyer në sahanlëpirës. Sociologu enigmatik... Kurse historianin po e dëgjon vetë.
- Ky dhe plejada e tij përbëjnë një mallkim për popullin e tyre, — shtova unë.

Skandalozët nisën të zhvisheshin lakuriq, Flokëpruarë me tha:

— Shkojmë te banka e jonë e natës së parë!

Dhe vajtëm atje, bëmë dashuri. Paçka se atë natë ishin trazuar galat. Ato përbëjnë një rrëmet në qytetin e Nishit. Krrakitjet e galave ndillnin kob. Por, kur dy të dashuruar hidhen në krahët e njëri-tjetrit, edhe paralajmërimi më mortar e humb trishtimin e vet. Shtrëngoja Rozikën symbyllur, më bëhej se në atë përqaftim kisha në krah Marë Gjinadardën.

Pa e shkuar nëpër mend se ishte nata e fundit e dashurisë sonë, të nemitur nga një lektisje na kishte zënë gjumi të puthur si dy plagë nga e njëjta thikë...

Gjeneral Sharanoviçi, ndonëse harlisej, pinte, dëfrehej dhe dehej, ishte aq i kujdesshëm, sa të mos shkelte në kufijtë e së ndaluarës. Ende nuk kishte zbardhur dita. Galat kishin mbërritur kulmin e alarmimit dhe mbushnin hapësirën me krrakitjet shurdhuese, shoferi i «Shevroletit» i binte borisë, gjenerali thërriste:

— Major Bumja, Emrush Vushtrija!

Në buzët e mija u ngjitën ato të Flokëpruarës. Zgjimi që i këndshëm, por dita që erdhi solli lajme e ngjarrje që paralajmëronin furtunë...

Sa vajtëm në pavion, mësuam se kishte rënë në sy mungesa jonë. Gjykatës Dragomir Nishlia m'u afrua duke u dridhur dhe më pëshpëriti:

— Ju kanë kërkuar qysh në mesnatë. Nën batanijet e krevatit tënd futa tesha. I rregullova në atë mënyrë, sa dukej sikur flije kokëmbuluar. Mungesa jote nuk ra në sy. Kurse për të tjerët u konstatua largimi. Bubu ç'zhurmë kanë bërë mjekët e rojës dhe disa të panjohur me mantela të bardhë. Thuhet se Rankoviçi dhe Jovanka, e shoqja e mareshalit, kanë përgaditur puç shteti kundër Titos...

Ndërkohë, gjeneralin e thirrën në drejtori. Pas pak erdhi Balashja dhe, si zakonisht, thirri nga pragu i pavionit:

— Qytetari Emrush Vushtrija, të paraqitet për vizitë te psikoterapiste Jadranka!

Eca përgjatë koridorit krah Balashes. Ajo ma miklonte llërën. Unë bezdisështa ngaqë askurrkush përveç Marë Gji-

nadardës nuk barabitej me hungarezogjermankën flokë-pruar.

Psikoterapiste Jadranka për herë të parë më priti me njëfarë zyrtarizmi të tepruar. Tha:

— E di se natën e ke kaluar atje... si edhe shumë net të tjera. Për mua kjo ka pak rëndësi. Të thirra sepse e shikoj të nevojshme të vizitosh edhe morgun e kësaj psikiatrie...

— Edhe psikiatria paska morg? — munda të pyes përpara tërë asaj habie nga qëndrim i ftohtë dhe aq zyrtar i dokoreshës.

— Eja pas meje. — tha dokoresha, pastaj, në udhëtim e sipër, iu përgjigj pyetjes sime: — Psikiatria e Nishit është e veçantë dhe më e madhja e këtij lloji në federatë. Ku do të bënin praktikën mjekësore studentët, nëse nuk do të kishte morg...

Eca krah Jadrankës i nemitur. Për habi as e vrisja mendjen përse duhej të vizitoja morgun, as pse Jadranka ishte aq e prerë dhe e ftohtë me mua, as për pëshpërimet ugruzeza të Dragomir Nishlies. Mund të betohem në ç'kam më të shtrenjtë, se e ndieja kokën si dritharë të zbratur. Vetëm një gjë më ishte ngulur si thumb në tru të regjistronja çdo dukuri në atë spital të përcudnuar.

Jadranka ecte puq me mua me hapin ritmik dhe më vidhte me bisht të syrit. E pikasa dhe më lindi një mendim në kryet bosh:

«Më në fund edhe kjo anije që s'donte t'ua dinte dallgëve, u trazua nga xhelozia...»

Në morg kishte shumë kufoma. Jadranka më shpuri në rreshtin e fundit të kadavrave. Atje filloi të më fliste:

— Vëzhgo me vëmendje dhe dëgjomë me kujdes! Këtu nuk lejohen pyetjet! Ato çfarë do të kuptosh nga shpjegimi im telegrafik, mos i harro! Në të kundërtën, të rroftë lufta që ke bërë dhe pac veten në qafë! Mbi çdo borxh të tjerë, me peshë mbetet vetëm ai që ia kemi tokës që na e ka bërë kokën. Fillojmë:

Ky këtu quhej Ramë Llapi. U soll nga burgu i Podujevës, me diagnozën «i sëmurë psikik tepër i rrezikshëm». Vdiq këtu. Ky tjetri quhej Dem Gollaku. U soll nga burgu i Kamenicës, me diagnozën «i sëmurë psikik tepër i rrezikshëm». Vdiq këtu. Ky quhej Fatosh Drenica. U soll këtu nga burgu i Vushtrisë, me diagnozën «i sëmurë psikik re-

bel dhe i rrezikshëm»: Vdiq këtu. Ky quhej Kresht Karada-ku. U soll këtu nga burgu i Gjilanit me diagnozën «i sëmurë psikik trashëgues». Vdiq këtu. Ky quhej Lis Bajgora. U soll këtu nga burgu i Mitrovicës me diagnozën «i sëmurë psikik i pandreqshëm», Vdiq këtu. Ky quhej Sef Babush Muhaxheri. U soll këtu nga burgu i Ferizajt me diagnozën «i sëmurë psikik me virus tërbimi». Vdiq këtu. Ky quhej Dai Presheva. U soll këtu nga burgu i Preshevës me diagnozën «i sëmurë psikik skajor i rrezikshëm». Vdiq këtu. Ky quhej Kalesh Bujanoci. U soll nga burgu i Bujanocit me diagnozën «i sëmurë psikik skajor i rrezikshëm». Vdiq këtu. Ky quhej Teki Medvegja. U soll nga burgu i Medvegjes me diagnozën «i sëmurë psikik skajor i rrezikshëm». Vdiq këtu. Ky quhej Dritan Shkupi. U soll nga burgu i Idrizovës me diagnozën «i sëmurë psikik me tendenca shpërthimi». Vdiq këtu. Ky quhej Ali Poguri. U soll nga burgu i Istogut me diagnozën «i sëmurë psikik rebel i rrezikshëm». Vdiq këtu. Ky tjetri quhej Bali Rugova, edhe ky tjetri quhej Kolë Peja. Të dy u sollën nga burgu i Pejës me diagnozën «të sëmurë psikik me delire bashkimi të të cmendurve». Vdiqën këtu. Ky quhej Dalip Reka. U soll nga burgu i Deçanit me diagnozën «i sëmurë psikik skajësisht i rrezikshëm». Vdiq këtu. Ky quhej Zijni Pregorupa. U soll këtu nga burgu i Malishevës me diagnozën «i sëmurë psikik me veçori kryengritësi». Vdiq këtu. Ky quhej Gjeto Bukoshi. U soll këtu nga burgu i Lumthetit me diagnozën «i sëmurë psikik molepsës». Vdiq këtu. Ky quhej Gjon Prizreni. U soll këtu nga burgu i Prizrenit me diagnozën «i sëmurë psikik agresiv». Vdiq këtu. Ky dhe ky quheshin përkatësisht Bylbyl Çabrati dhe Sokol Gjnamadhi. U sollën nga burgu i Gjakovës me diagnozën «të sëmurë psikik me fikside tepër të rrezikshme». Vdiqën këtu. Ky quhej Dan Përdrinia. U soll këtu nga burgu i Ravecit me diagnozën «i sëmurë psikik kryeneç dhe terrorist». Vdiq këtu. Ky quhej Gjergj Hoti, ky tjetri Lazër Gruda, ky Bec Ulqinaku, ky Gjok Kraja, ky Sali Shpuza, ky Shykri Gucia, ky Etem Vuthaj, që të shtatë u sollën nga burgu i Podgoricës me diagnozën e përbashkët «të sëmurë psikik turbullues të rrëganit Tetova, ky Esheref Gostivari, ky Adem Kërçova, Ky Fehim Dibra, ky Vehip Struga, ky Teki Manastiri, ky Shahin Kumanova, që të gjithë u sollën nga burgu i Shkupit

me diagnozën «të sëmurë psikik me tendenca bashkimi kundër Federatës.» Vdiqën këtu. Këta të pesëmbëdhjetë janë Anonimët e Kaçanikut. U sollën këtu nga CZ-ja, domethënë nga Burgu Qëndror i Beogradit me diagnozën «të sëmurë psikik tepër të rrezikshëm kundër bashkësisë tonë Federative». Vdiqën këtu.

Nëse nuk mjaftojnë këta, kemi edhe kufoma të tjera,  
— përfundoi psikoterapiste Jadranka:

— Pyes: përse më sollët këtu?! — thashë unë dhe e zhburova me qëllim të lexoja në fytyrë më shumë se ç'do të më thoshte ajo.

— Të kam thënë të më drejtohesh me ti. Nejsë, kjo është puna jote, — gjegji Jadranka, — ta thashë kur hymë këtu, po ta përsëris; mbi të gjitha borxhet që mund t'i kemi ndokujt, më i madhi është borxhi ndaj vetvetes...

— Më thërçin prapa qafe nëse të kuptova ku kërkon të dalësh me këto fjalë, — i thashë, me dyfytirësi paçka se Jadranka nuk e kishte hak atë sjellje.

— Torrollak nuk je. Kadavrat i pe. Ishin njerëz të ngjashëm me ty. Ndryshonin sepse nuk e humbnin qëllimin e jetës duke u hedhur në krahët e qejfeve të rëndomtë... — gjegji psikoterapiste Jadranka.

— Mirë ma bëre! — i thashë unë me zë të lartë.

Porsa mbërrita në pavionin e psikopolisindromës së disidentëve, Dragomir Nishlia m'u fut në frymë duke pëshpëritur:

— Shyqyr që u ktheve! U shqetësova pa masë. Këtu po ndodhin ngjarje skandaloze. Gjeneral Sharanoviçi u arratis. Filozofin dhe sociologun i arrestuan si mafioz të shitjes së drogës. Historianit i lëshuan fletë-lirimin nga psikiatria. Emrin tënd, falë i qofshim perëndisë, nuk e përmendi njeri. Unë vërtet jetoj nën trysninë e streseve, prapëseprapë nuk heq dorë nga ajo që të kam thënë, beso-kontrolo!

Më erdhi t'ia ktheja: Lenin, stalin; pa ju bota s'ka shpëtim, por, ato që më kumtoi, vërtet përbënin një shqetësim të madh ndaj nuk ishte koha për shaka.

Tek po përpiquesha t'i gjeja përgjigje pyetjes: «A ka mundësi që shokët e orgjive të cilët i kisha konsideruar si të dyshimtë të jenë pleksur edhe në tregtinë e drogës, Dragomiri, që më vështronte me sytë gapërr tha:

— Jo milicia jonë, por policia ndërkombëtare kundër drogës i arrestoi sociologun dhe filozofin.

— Po historianin përse e liruan? — pyeta unë.

— Historiani mund të jetë bashkëpunëtor i të gjitha policive të botës, — gjegji Dragomir Nishlia.

«Ky do të ishte gjëni, të mos vuante nga streset dhe fiksacionet... — mendova me vete. Atë çast, në hyrje të pavionit, thirri ndihmës mjeke Balashja:

— Qytetari Emrush Vushtrija të paraqitet në drejtori; i kanë ardhur për vizitë njerëzit e vet nga Prizreni.

Ngarenda si i ndërkryer. Në koridor priste Jadranka. Ajo më tha:

— Të ka ardhur motra. Kam caktuar dhomën e takimit. Pasi të çmalleh, i thuaj të të presë atje. Kthehu e më tako. Kam një punë të ngutshme me ty.

Gati sa nuk thirra: «Ç'motër më kërkuaka?! Unë kam nëntë vëllezër të cilët më kanë braktisur sepse i futa në vallen e luftës për vëllazërim bashkimin dhe i breu mashtrimi... Unë nuk kam motër...» Por shyqyr zotit që nuk fola.

Balashja më përcolli deri te dhoma e caktuar për takime.

Ç'të shikoj! Një vajzë e bukur e veshur në të zeza. Ishte Marë Gjinadarda. Ajo u ngjatjetua me mua tamam siç takohet motra me vëllain. E merrte me mend e mençura nga Prizreni se dhjetra sy përgjonin takimin tonë.

Si u futëm në dhomë, e mbylla portën me çelës. E përqafova dhe ndjeva mall për truallin, i cili për ne shqiptarët, qoftë edhe për më moskokërçarësit, është i shtrenjtë. i shenjtëruar, i bekuar. Dhe, nëse do të zberthehej miti i lidhjes së Anteut me tokën, pa mallin e shqiptarit për dheun që i ka bërë kokën, nuk mund të gjendej kuptimi i saktë dhe i vërtetë.

Tek ia shpushpuritja flokët hirëmadhes Marë, më bëhej sikur mikloja fushat, zabelet, lirishtet e Kosovës. Ndjeja aromën e rreshkur të grunajave, puhinë e bjeshkëve të Nemura, flladin e ahishteve të Sharrit, erën e hardhive në lulzim të Përdrinit, zambakun e Prizrenit, luledardhën e fshatit tim në jug të Vushtrisë.

Mara, e veshur në të zeza, e freskët në fytyrë, në qëndrim si plakë. Ajo mbante një zarf në dorë. E dora i lëkundej, e buza i dridhej, e sytë, oh ata sy aq të kthjellët e me vështrim të thellë, përmes të cilëve mund të vështroje tërë Shqipërinë nga Preveza në Pazar, nga Tivari në Kavadar. Ata sy tajitnin lotë malli e brengje.



Unë e përqafoja, e puthja, e merrja ngrykë, e shtrëngoja. Ajo qëndronte si shtatore.

— Mos m'u zemëro që erdha! — foli ajo siç dijnë të flasin vajzat prizrenase, — ndoshta nuk do të zemërohesh. Por, ja.... — dhe më lëshoi në dorë zarfin.

Nxora letrën. Kërkohej prej saj të vinte për të shoqëruar qytetarin Emrush Vushtrija. Shkruhej atje se qytetari është dërguar gabimisht në psikiatri. Se ai është me aftësi mendore e fizike të përsosura, me horizont dijesh dhe erudit i rrallë. Se ajo thirrje e të afërmëve për ta shoqëruar, bëhej për hir të njohjes së opinionit me personalitetin e Emrush Vushtrisë... Letra firmohej nga psikoterapisti Jadranka Zara dhe nga katër firma psikiatresh të tjerë që nuk i njihja.

— Po pse me të zeza?! — u kujtova ta pyesja Marën.

— Nënë Lajden e shtypi një kamion tek po shkante në gjyq....

— Ç'kërkonte nënë Lajdja në gjyq? — pyeta unë.

— Kishte ngritur padi se të kishin përplasur ty në çmendinë pa qenë i sëmurë. Ekspertët mjeko-ligjor përcaktuan se shoferi kishte qenë i dehur dhe u dënua me njëzet vjet burg. Shoferi që u dënua ishte shqiptar pavarësisht se ditën e ngjarjes ai nuk i kishte grahur kamionit. Madje kishte një muaj që ndodhej te halla e vet në Shkup. Shkuan, papritur e pa pandehur, e arrestuan, bile ia përmenden edhe në pretencë «...për ta mbuluar krimin e bërë shoferi është larguar për në Shkup, ku i ranë në gjurmë orgaanet tona dhe e kapën... «Shoferi i kamionit që shtypi nënën ishte serb, nga ata terroristë që i sjellin nga burgjet e Beogradit për ta shlyer fajin duke vrarë shqiptarë. Unë kam mbetur pa kërkënd. E mjerë, e pangushëlluar dhe e përmalluar. Prapëseprapë erdha sipas kërkesës së psikiatrisë së Nishit. Po nuk më deshe, nuk do të bëhem barrë në jetë. Nëse më do për grua, të jesh, i bindur se do të të bëj të lumtur. Je ylli, i fatit tim, je i dashuri im i pazëvendësueshëm me askënd dhe përgjithmonë.

E putha duke qarë. Me lotë e vulosa vendosmërisht fatin tim.

— Ka kohë që janë liruar Këpucari dhe Kasapi. — tha Mara, — jetojnë paqësisht pranë familjeve të tyre. Nuk dijnë kurrëgjë për këtë letër dhe për ardhjen time këtu.

Ata shoqëruan arkivolin e nënës në varrim. Ata të duan dhe s'të harrojnë. Por u përgjohet edhe hapi kur e shtrijnë. Prandaj nuk u kallëzova për këtë udhëtimin tim.

Edhe përsëdyti e putha dhe e përqafova, jo vetëm si bashkëshorten e ardhshme, por edhe si shok jete dhe shok armësh. Me zarfin në dorë, sapo hapa portën për të vajtur në drejtorinë e spitalit për formalitetet e rastit, u gjenda i befasuar sepse psikoterapiste Jadranka dhe Balashja po më prisnin në paradhomë. Jadranka kishte përgatitur fletë-lirim nga spitali dhe një dhuratë simbolike. Si më veçoi, më tha:

— Transferimin për në Zagreb e kam vonuar gjer më sot jo për ty, por për njeriun, njërezimin, të cilit do t'i shërbej gjer sa të më rrahë qoftë edhe një damar jete. E shpejtova lirim tënd nga spitali, mbasi këtu do të bëhen arrestime në masë, Janë përplasur keq rivalët për pushtet në Beograd, secili nga të dy palët vret njerëzit e kundërshtarit. I kupton vetë këto gjëra. Më falë që kam hulumtuar edhe për jetën tënde intime në Prizren. Lavdi zotit që gjurmimet u kurorëzuan me sukses. Të isha mashkull, do të bija në dashuri me këtë lule, dhëntë perëndia e meriton ta kesh për grua, ti, harrakat e akademik i pagdhen-dur.. Sis felix, Emrush Vushtrija. Qofshë i lumtur Emrush Vushtrija! — më tha latinisht psikoterapiste Jadranka të cilën s'do ta harroj kurrë.

Balashja më puti në faqe duke qarë dhe më dorëzoi rrobat vetjake.

U veshë në dhomën e vizitave. U përshëndosha edhe një herë me Jadrankën e Balashën.

Ia futa krahun Marë Gjinadardës dhe, duke shkuar për në stacionin e trenit, i thashë:

— Edhe pse nuk isha i çmendur, e paskan pasur të domosdoshme këtë shtrim në spital; ndonëse më sollën këtu për qëllime poshtruese e denigruese. Sot e tutje kurrë nuk do të luftoj për ideale të rrejshme që të mos më brejë më kriza e mashtrimit. Do të të dua si grua, si bashkluftëtare, si shoqe të jetës e të lëvizjes për liri.

Mara tha:

— Vdekja do të ishte shumëfish më e shëmtuar, nëse njeriu nuk lë asnjë vepër, fëmijë, të afërm, apo të dashur, të cilët nuk lejojnë ta mbulojë emrin ndryshku i harresës, — dhe sytë i lotonin. Oh, ata sy!

Në lotët e saj unë pashë shpresën dhe gëzimin e së ardhmes.

Lokomotiva shfryu.

Ne ecnim drejt stacionit. Ku shkonim e dinim. Ç'na priste nuk mund ta merrnim me mend.

Për një gjë ishim të bindur: Do të lindnim shumë fëmijë dhe në udhën tonë s'do të kishte forcë të na pengonte.

Tiranë, 1992-1993